



ALBANIAN
Geography and History

July 1971

DEFENSE LANGUAGE INSTITUTE
FOREIGN LANGUAGE CENTER



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PREFACE

This volume of Geography and History has been designed with the following aims:

a. to review grammar and vocabulary of Lessons 1-120 of the Basic Course.

b. to increase, with practice and the help of new words and idioms, the student's fluency and scope of expression.

c. to provide basic historical, political, cultural and geographic information about Albania and certain areas in which Albanian is spoken, with emphasis on the comtemporary scene.

Because of the review and development aspects of the volume, it is introduced in the final phase of the course (beginning with the 34th week) for one hour a day, approximately one page at a time. The student's task is to read the homework assignment and be familiarized with the content; through appropriate questions and answers, the instructor will lead the student to free conversation.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

TABLE OF CONTENTS

	Page
A SUMMARY OF GEOGRAPHY OF ALBANIA	
Size and borders	1
Topography: mountains, plains, rivers, lakes	3
Climate	11
Agriculture and sheep farming	13
Mines and industry	15
Trade	18
Administrative apportionment of P.R.A.	21
District of Gjirokastër	23
District of Sarandë	26
District of Tepelenë	28
District of Përmet	29
District of Kolonjë	30
District of Skrapar	31
District of Korçë	32
District of Pogradec	36
District of Vlorë	37
District of Fier	40
District of Berat	42
District of Lushnjë	46
District of Elbasan	48

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

	Page
District of Gramsh	51
District of Librazhd	52
City of Tiranë	53
District of Tiranë	56
District of Durrës	58
District of Krujë	63
District of Mat	66
District of Dibër	67
District of Kukës	68
District of Tropojë	71
District of Shkodër	73
District of Pukë	77
District of Mirditë	78
District of Lezhë	80
Statistic data	81
A SUMMARY OF HISTORY OF ALBANIA	
The Illyrians	90
Scanderbeg	93
Movements of the 18th Century	110
League of Prizren	117
Ethnic Albania	120
Albanian Independence	123

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

	Page
The New State (1920-1939)	125
The Albanian Communist Party	129
The National Front (Ballli Kombëtar)	132
The Second World War and the Albanian underground	137
Communist takeover:	
executions, reforms, elections, socialism, unions, education, russification, youth, religion, forced labor	138
The Sino-Soviet Rift	154
Alliance with P.R. of China	163

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

NJË PËRMBLEDHJE E GJEOGRAFISË SË SHQIPËRISË

Shqipëria ndodhet në pjesën perëndimore të gadishullit ballkanik, i cili përbëhet nga këto shtete: Jugosllavia, Greqia, Bullgaria, Rumania, Shqipëria dhe një pjesë e Turqisë Europiane.

Nga madhësia, Shqipëria është sa shteti i Maryland-it; në përgjithësi malet e saj i përgjajnë natyrës malore të Kentucky-t, kurse faunën, florën, bregdetin dhe klimën i ka pak a shumë si ato të Kalifornisë Qendrore.

MADHËSIA E KUFITË. Shqipëria shtrihet në bregun lindor të Adriatikut dhe të Jonit, ndërmjet shkallëve të gjatësisë lindore $19^{o}.20'$ - $21^{o}.3'$ dhe të gjerësisë veriore $39^{o}.30'$ - $42^{o}.40'$ dhe ka një sipërfaqe prej 28.748 kilometrash katrorë (11.100 mila katrore). Fqinjët e Shqipërisë janë: Jugosllavia në veri dhe në lindje dhe Greqia në lindje dhe në jug; nga perëndimi kufizohet me detin Adriatik dhe me detin Jon.

Brenda këtyre shkallëve ndodhet Shqipëria e sotme, kufitë e së cilës u caktuan padrejtësisht nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër, më 1913; por Shqipëria e vërtetë, Shqipëria etnike ose Shqipëria e Robëruar -siç është zakon të quhet- është edhe një herë më e madhe dhe shtrihet ndërmjet shkallëve të gjatësisë lindore $19^{o}.20'$ - $20^{o}.50'$ dhe të gjerësisë veriore $39^{o}.0'$ - $43^{o}.0'$.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Gjatësia tokësore e vijës së kufirit është 577 km., nga të cilët 347 km. me Jugosllavi dhe 230 km. me Greqi, kurse gjatësia e bregdetit është 472 km.

I vetmi ishull i Shqipërisë është Sazani që gjendet kundrejt gjirit të Vlorës.

TRAJTA E SIPËRFAQES. Drejtimet që marrin lumenjtë na japin një kuptim të plotë të sipërfaqes së tokave të saja. Lumenjtë rrjedhin nga lindja në perëndim dhe kjo do të thotë se krahinat e Shqipërisë nga lindja janë të larta dhe gradualisht më të ulta gjer në breg të detit; Shqipëria ka, pra, male në lindje dhe fusha në perëndim.

MALET. Malet mbulojnë tri të katërtat e Shqipërisë. Vargjet e maleve, sipas drejtimeve që marrin, ndahen në pesë grupe:

(1) Alpet e Shqipërisë së Veriut janë vazhdimi i Alpeve Dinarike të Bregdetit të Dalmacisë së Jugosllavisë Perëndimore. Alpet e Shqipërisë formojnë blokun e maleve më të lartë të Shqipërisë dhe nuk krijojnë një varg të rregullt. Ato shtrihen në veri të Drinit të bashkuar dhe mbulojnë një vend prej 50 km. gjatësi dhe 20 km. gjerësi. Fare në veri gjenden Bjeshkët e Namuna, më të lartat e këtij grumbulli, me malin Jezerçë (2693 m.); këto kanë në jug-perëndim malet e Hotit dhe të Grudës me majën e Vilës (2100 m.); në perëndim të këtyre gjenden bjeshkët madhështore

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

të Malësisë së Madhe, me malin e Veleçikut (1726 m.) dhe malin e Radohinës (2650 m.). Të dyja këto grupe mbahen si qendra kullotash e stanesh dhe janë të përshkuara nga një sëri përrenjsh e lumenjsh të vegjël. Më në jug, në veri-lindje të Shkodrës, vijnë vendet malore të Cukalit, me malin Cukal (1722 m.). Në veri dhe veri-lindje të këtyre vijnë një grumbull malesh të ndarë prej shumë lumenjsh me dy male të larta: Maja e Hekurave (2600 m.) dhe Shkëlzeni (2460 m.).

(2) Vargu Lindor, që s'është gjë tjatër veçse një pjesë e Vargut të Sharit, nis në Shqipërinë e Robëruar. Përmbledh nga veriu në jug: malin Koritnik (2400 m.) në lindje të Kukësit, Gjalicën e Lumës (2486 m.) në jug të Koritnikut dhe Korabin, që është mali më i lartë i Shqipërisë (2751 m.), në veri të Peshkopisë. Korabi vazhdon me Malet e Deshatit, të cilat futen në Shqipërinë e Robëruar; këto futen përsëri në kufirin shqiptar, në mes të Liqenit të Ohrit dhe të Liqenit të Prespës, me Malin e Thatë dhe me malin Galiçiça (1740 m.). Vargu Lindor, që fillon në Kukës, mbaron në Fushën e Korçës me Qafën e Zvezdës.

(3) Vargu i Maleve Qendrorë shtrihet paralel me Vargun Lindor, nga Dukagjini gjer në malet e Mokrës afër Korçës, me një gjatësi prej 170 km. Përmbledh nga veriu në jug: Malet e Mirditës me majën e Runës (1856 m.) në jug-lindje të Dukagjinit; Malet e Çermenikës në veri-lindje të Elbasanit dhe Malet e

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Jabllanicës në jug të Dibrës. Malet e Mokrës, që shtrihen gjatë Liqenit të Ohrit gjer afër Korçës, përbëjnë fundin e këtij vargu.

(4) Vargmalet Detarë, jo fort të lartë, shtrihen pothuaj paralel me bregun e detit. Fillojnë në veri të Lezhës me Malin e Rençit, vazhdojnë me Malin e Skënderbeut në veri-lindje të Krujës, me Dajtin 1612 m. në lindje të Tiranës, me Krrabën në veri-perëndim të Elbasanit, që i ep fund këtij grupi.

(5) Grumbulli i maleve Jugorë përmbledh një grup malesh të çrregullt; këto janë: Malet e Moravës në jug të Korçës, Malet e Ostrovicës në perëndim të Korçës, Tomori në lindje të Beratit 2416 m. i lartë, Trebeshina në veri të Tepelenës, Griba në perëndim të Tepelenës, Malet e Mallakastrës me Shpiragun në jug-perëndim të Beratit, Malet e Nemërçkës në lindje të Gjirokastrës dhe Malet e Lunxhërisë në veri të Gjirokastrës.

FUSHAT. Fushat e Shqipërisë gjenden pothuaj të tëra gjatë bregut të detit. Duke filluar nga veriu fushat e Shqipërisë janë: Fusha e Shtoit në veri të Shkodrës, Fusha e Zadrimës në jug të Shkodrës dhe Fusha e Bregut të Bunës në jug-perëndim të Shkodrës: të tria këto fusha janë të përmendura për rritjen e mirë të duhanit dhe të drithërave. Më poshtë vjen Fusha e Krujës në perëndim të Krujës. Fusha e Tiranës në veri-perëndim të Tiranës, Fusha e Shijakut në lindje të Durrësit, Fusha e Kavajës që arrin gjer tek lumi Shkumbin, Fusha e Dumresë, në

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

jug-perëndim të Elbasanit. Nga Shkumbini fillon fusha më e madhe e Shqipërisë, Fusha e Myzeqesë, që arrin gjer në Luginën e Vjosës. Fusha e Myzeqesë konsiderohet grunari i Shqipërisë dhe është nja 50 km. e gjatë nga veriu në jug dhe 20 gjer në 25 km. e gjerë nga lindja në perëndim. Fushat tjera janë: Fusha e Korçës në veri të Korçës, Fusha e Dropullit në veri të Gjirokastrës dhe Fusha e Delvinës, që shtrihet gjatë bregut të detit nga Himara në Sarandë. Fusha e Korçës është fusha më e lartë e Shqipërisë, 800 m. mbi nivelin e detit.

LUMENJTË. Shumica e lumenjve të Shqipërisë derdhen në Adriatik; lumenjtë Pavlo dhe Kalasa derdhen në Detin Jon. Shtretërit e tyre janë të thellë dhe nën sipërfaqen e arave, për këtë arësye nuk i shërbejnë shumë bujqësisë. Lumenjtë kryesorë janë: Drini, më i gjati i Shqipërisë. Drini ka dy degë: Drinin e Zi dhe Drinin e Bardhë. Drini i Zi buron nga Liqeni i Ohrit, merr drejtim nga veriu dhe afër Kukësit bashkohet me Drinin e Bardhë, që buron nga malet e Pejës (qytet i Shqipërisë së Robëruar). Pasi bashkohen të dy Drinat marrin emrin Drin, i cili rrjedh nga perëndimi në jug të Alpeve gjer në Fushën e Zadrimës; këtu, te Vau i Dejës, ndahet përsëri në dy degë: njëra degë mban gjithënjë emrin Drin, zbret nga jugu dhe derdhet në Adriatik afër Lezhës; tjetra quhet Drinas dhe pasi përshkon Fushën e Zadrimës, në jug të Shkodrës bashkohet me Bunën.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Buna, më i shkurtëri, por më i gjeri i të tërëve, është i vetmi lumë i lundrueshëm. Buron nga Liqeni i Shkodrës dhe pasi bashkohet me Drinasin, vazhdon të zbresë në jug, dhe derdhet në Adriatik.

Lumi i Matit buron nga Malet e Martaneshit, në perëndim të Maleve të Jabllanicës, ngjitet në veri-perëndim dhe në krahinën e Mirditës bashkohet me Fanin, që ka edhe ky dy degë: Fanin e Madh e Fanin e Vogël. Lumi i Matit derdhet në det pak më poshtë Drinit.

Ishmi ushqehet nga tre lumenj, që burojnë nga Malet Skënderbej: nga Zeza, nga Zallì i Herrit dhe nga Lumi i Tiranës. Derdhet në det pak më poshtë Lumit të Matit.

Erzeni buron nga Malet e Shëngjergjit, në jug të Maleve Skënderbej, kalon afër Tiranës, përshkon Shijakun dhe derdhet në Gjirin e Lalzit.

Shkumbini, është lumi që e ndan Shqipërinë e Veriut nga ajo e Jugut, duke përbërë kufirin e dy dialekteve kryesore të shqipes: të Toskërishtes dhe të Gegërishtes. Buron nga Malet e Mokrës, afër Pogradecit, kalon në jug të Elbasanit, përshkon Peqinin dhe derdhet, si të tjerët, në Adriatik.

Semani përbëhet nga dy lumenj: nga Devollì, që buron në perëndim të maleve të Moravës, dhe nga Osumi, që buron në krahinën e Kolonjës. Derdhet në det pak më poshtë Shkumbinit.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Vjosa buron në Greqi; afër Tepelenës bashkohet me lumin Drino dhe në veri të Vlorës me lumin Shushicë, e pastaj derdhet në Adriatik.

LIQENËT. Duke filluar nga veriu, liqenët e Shqipërisë janë: Liqeni i Shkodrës, më i madhi i Ballkanit (360 km^2), i pasur me shumë lloje peshqish.

Liqeni i Ohrit (311 km^2), vjen i dyti për madhësi, por i pari për thellësi; është gjithashtu një nga më të këthjelltit e botës. Është i pasur me peshk, sidomos me koran, belushkë etj.

Liqeni i Prespës gjendet në jug-lindje të Liqenit të Ohrit.

Të tjerët më të vegjël janë: Liqeni i Nartës në veri të Vlorës, Liqeni i Vivarit (quhet edhe Liqeni i Butrintit) në jug të Sarandës dhe Liqeni i Rizës në jug të Liqenit të Vivarit.

Përveç këtyre, Shqipëria ka edhe një numër kënetash, më e madhja e së cilave është ajo e Karavastasë, në breg të detit, në perëndim të Fushës së Myzeqesë.

KLIMA. Trajtat e ndryshme të sipërfaqes shkaktojnë klimë të ndryshme në Shqipëri; kështu, bregu i detit dhe krahinat fushore kanë një klimë detare dhe pjesa e lartë ka klimë tokësore; me fjalë tjera, në perëndim dimri është i butë dhe vera jo shumë e nxehtë, kurse në lindje dimri është i rreptë dhe vera e nxehtë.

Shirat janë të bollshëm në Shqipërinë perëndimore gjatë

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

stinës së dimrit dhe të vjeshtës, por verës klima është jashtëzakonisht e thatë; ngjet e kundërta ndër vendet malore. (Shih: (1) "Hartën e Klimës së Shqipërisë", dhe (2) "Mesataren e reshjeve vjetore", f. 79).

BUJQËSIA. Shqipëria është kryesisht një vend bujqësor; tri të katërtat e tokave të Shqipërisë janë të përshtatshme për mbjellïjen e shumë llloj bimësh. Prodhimi kryesor i bujqësisë së Shqipërisë është misri; vijnë me radhë: gruri, duhani (sidomos në fushat rreth Shkodrës dhe Elbasanit), ulliri (në rrethet e Tiranës, Elbasanit, Beratit dhe Vlorës), hardhitë dhe portokallat (në breg të detït), fasulja, pambuku dhe panxhari i sheqerit (në fushën e Korçës), si dhe shumë llloj prodhimesh tjera. Zarzavatet rriten kudo në Shqipëri. Këto kohët e fundit po i jepet rëndësi e posaçme rritjes së patates për plotësimin e nevojave të bukës.

BLEGTORIA. Blegtoria vete paralel me bujqësinë; vijnë me radhë: delet, lopët, derrat, kuajt dhe shpendët me pula dhe gjela deti në krye. Gjithashtu, prodhimet e bagëtive, si p.sh. lëkurat, leshi dhe prodhimet bulmetore—në radhë të parë gjalpi dhe djathi—përbëjnë të ardhura të konsiderueshme për ekonominë e vendit.

Shqipëria është e varfër me kafshë të egra; kaprojt, dhitë e egra dhe dhelpërat, dikur me shumicë, kanë filluar të shihen

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

gjithënjë më rrallë, prandaj qeveria e ka rregullar me ligjë gjahun e kafshëve të egra dhe të shpendëve të egjër.

PRODHIMET MINERALE. Nga prodhimet minerale të nëntokës vendin e parë e zënë puset e vajgurit të Qytetit Stalin (në Rrethin e Beratit) e të Patosit (jo larg nga Fieri). Pastaj vijnë me radhë: qymyri i gurit në Memalijaj (afër Tepelenës), në Krrabë, në Mëzez, në Priskë (afër Tiranës) e në Mborje-Drenovë të Korçës; puset e serës a të bitumit në Selenicë (afër Vlorës), në Mallakastër e në Kurvelesh; minierat e bakrit në Rubik e Kurbnesh (në Rrethin e Mirditës) dhe në Gjegjan të Rrethit të Kukësit; minierat e kromit në rrethet e Kukësit, Tropojës, Pogradecit dhe në Bulqizë të Dibrës; minierat e hekur-nikelit në Pishkash të Librazhdit dhe në rrethin e Pogradecit. Aty këtu ka edhe bauksit, linjit e minerale tjera jo-metalike.

Është për t'u shënuar se pasuritë minerale në Shqipëri nuk kanë qenë shfrytëzuar në një shkallë të gjerë, por tani kanë nisur t'i shfrytëzojnë me shpejtësi.

INDUSTRIA. Megjithëse në vitet e fundit ka marrë një hov të madh, industria është ende në një fazë fillestare të përparuar.

Janë për t'u shënuar industria e naftës, industria mekanike, kimike, metalike, industria e pëlhurave të ndryshme dhe e stofave, e pambukut, e duhanit, e pijeve, e lëkurave, e çimentos, e drurit dhe industria ushqimore.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Me industrinë mund të radhiten edhe një seri punimesh artizanati, si p.sh. punimi i drurit për cigarishte, çibukë e sepete; punimi i argjendit për unaza, bylyzykë e gjëra tjera zbukurimi, dhe veçanërisht punimi i mëndafshit dhe i qilimave. Ndër këto punime gratë e Shqipërisë përdorin një mjeshtëri të rrallë dhe konsiderohen artiste.

TREGËTIA. Tregëtia e brendshme ashtu edhe ajo e jashtme ushtrohen nga shteti. Nëpër sektorin e shtetit dhe nëpër sektorin kooperativist kalon pothuaj krejt tregëtia e vendit.

Tregëtia e brendshme zhvillohet ndër qytete e qendra nga Ndërmarrjet Tregëtare Shtetërore (N.T.Sh.), të cilat e kanë për detyrë t'u shpërndajnë magazinave të sektorit të tregëtisë mallrat që prodhohen nga industria, nga artizanati kooperativist e nga bujqësia.

Ndër fshatra gjenden edhe kooperativat e shitblerjes ku fshatarët kanë mundësi të blejnë artikuj të fabrikuar e të shesin prodhimet bujqësore e blegtorale.

Pazare janë vendet ku fshatarët shesin lirisht tepricat e prodhimeve të bagëtive dhe të kopshteve personale.

Tregëtia e Jashtme është monopol i shtetit dhe kryhet me anë të Ministrisë së Tregëtisë. Sot Shqipëria importon maqineri të ndryshme për zhvillimin e industrisë, vegla ndërtimi e prodhime

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

konsumi (ilaçe, veshmbathje etj.), dhe eksporton prodhime minerale (bakër, naftë, krom etj.), prodhime blegtorale, fruta, drunjë industriale etj.

Sot Shqipëria ka marrëdhënie tregëtare me R.P. të Kinës, me shtetet e Europës Lindore, me Turqinë, Kubën, Algjerinë etj. Bën shkëmbime tregëtare në një shkallë të vogël edhe me Jugosllavinë, Italinë, Francën, Greqinë dhe me firma tregëtare zvicerane, austriake, suedeze etj.

TEMPERATURAT ABSOLUTE

	Maksimale	data	Minimale	data
Tiranë Q.	**39.8**	14.8.57	— 8.1	8. 2.65
Shkodër Q.	40.4	8.7.57	—10.6	30.12.41
Vlorë	42.2	31.7.45	— 7.2	1. 1.42
Durrës	39.0	14.8.57	— 7.4	24. 1.42
Sukth	38.7	8.8.62	— 8.2	18. 1.64
Q. "Stalin„	41.5	23.7.39	—11.7	1. 1.42
Lushnjë	41.9	14.7.57	— 7.4	8. 2.65
Fier	39.5	14.8.57	—13.0	26. 1.54
Borsh	36.8	8.8.56	— 1.5	17. 1.63
Elbasan	41.0	30.7.54	— 7.2	24. 1.63
Sarandë	40.2	14.8.57	— 2.8	17. 1.53
Gjirokastër	42.2	14.7.57	— 9.1	18—19. 1.64
Korçë	38.5	9.8.45	—23.0	30—31.12.41
Pogradec	39.6	19.8.51	—12.8	26. 1.63
Ersekë	34.9	14.8.57	—17.2	19. 2.56
Orman Pojan (Sheqeras)	37.0	22.8.58	—25.8	27. 1.63
Voskopojë	33.4	27.6.65	—25.6	26. 1.54
Peshkopi	38.3	26.7.65	—20.8	27. 1.54
Kukës	39.5	13.7.57	—18.7	26—27. 1.54

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

NDARJA ADMINISTRATIVE E R.P.SH.

Republika Popullore e Shqipërisë, në pikëpamje administrative ndahet në 26 njësi të mëdha që quhen r r e t h e, dhe në qytetin e Tiranës. Që të gjitha këto njësi të mëdha administrative kanë lidhje të drejtëpërdrejtë me aparatin qendror shtetëror, që gjendet në Tiranë. Organet lokale të pushtetit shtetëror në fshatra e lagje, në lokalitete e rrethe dhe në qytetin e Tiranës janë këshillat popullore. Këshillat popullore janë baza politike e shtetit.

Sipas lajmeve zyrtare të fundit, Shqipëria ka pak më shumë se 2 milion banorë.

Numri i banorëve për çdo rreth dhe qendër rrethi: (1964)

	Rrethi	Banorë	Qendra	Banorë
1.	Rrethi i Beratit	95.390	Berati	22.000
2.	" " Dibrës	86.990	Peshkopia	5.525
3.	" " Durrsit	142.240	Durrsi	47.870
4.	" " Elbasanit	118.080	Elbasani	35.330
5.	" " Fierit	127.120	Fieri	17.850
6.	" " Gramshit	22.200	Gramshi	2.225
7.	" " Gjirokastrës	47.400	Gjirokastra	15.000
8.	" " Kolonjës	18.325	Erseka	2.320
9.	" " Korçës	150.500	Korça	43.745
10.	" " Krujës	47.400	Kruja	6.725
11.	" " Kukësit	54.055	Kukësi	3.855
12.	" " Lezhës	30.250	Lezha	3.000
13.	" " Librazhdit	39.850	Librazhdi	1.500
14.	" " Lushnjës	73.840	Lushnja	15.970
15.	" " Matit	42.240	Burreli	3.420

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

	Rrethi	Banorë	Qendra	Banorë
16.	Rrethi i Mirditës	19.957	Rrësheni	1.310
17.	" " Përmetit	29.240	Përmeti	4.045
18.	" " Pogradecit	39.650	Pogradeci	8.910
19.	" " Pukës	25.350	Puka	1.660
20.	" " Sarandës	53.890	Saranda	7.710
21.	" " Skraparit	21.500	Çorovoda	1.945
22.	" " Shkodrës	140.895	Shkodra	47.000
23.	" " Tepelenës	28.800	Tepelena	2.540
24.	Qyteti i Tiranës	180.000		
25.	Rrethi i Tiranës	65.970	Tirana	180.000
26.	" " Tropojës	23.350	Bajram Curri	1.925
27.	" " Vlorës	112.550	Vlora	46.905

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

RRETHI I GJIROKASTRËS

Shikimi fizik. Rrethi i Gjirokastrës zë një pjesë bukur të mirë të jug-perëndimit të Shqipërisë. Kufizohet me rrethin e Sarandës, me atë të Tepelenës, të Përmetit, të Vlorës dhe me Greqinë.

Relievi i rrethit të Gjirokastrës është i ndryshëm; në pjesën më të madhe sipërfaqja e tij është malore dhe kodrinore. Malet më të lartë të këtij rrethi janë vargu Dhëmbel-Nemërçkë, si edhe Lunxhëri-Bureto dhe Mali i Gjërë. Lartësia e këtyre maleve shkon prej 1700 m. gjer mbi 2000 m. Fushat e këtij rrethi janë të rrethuara nga male e kodra dhe në përgjithësi shkojnë gjatë rrjedhjeve të lumenjve. E tillë është fusha e Drinos.

Klima e rrethit të Gjirokastrës është mesdhetare atlantike në perëndim, kurse më nga lindja klima është tranzitore.

Lumi Drino, që është degë e Vjosës, i përket pothuaj krejtësisht këtij rrethi.

Shikimi ekonomik. Në pikëpamje ekonomike rrethi i Gjirokastrës ka të zhvilluar blegtorinë, por edhe bujqësia me degët e saja, si edhe industria venë mjaft mirë. Gjirokastra ka shumë kooperativa, ndërmarrje bujqësore shtetërore dhe fidanishte.

Nga kulturat bujqësore në këtë rreth kanë rëndësi drithërat, gruri dhe misri, por në fushat e Drinos mbillet edhe orizi. Edhe kultura e perimeve është e zhvilluar kudo.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Pyje në rrethin e Gjirokastrës ka pak, por ka kullota të shumta verore dhe dimërore ku kullosin me qindra mijë bagëtish. Për punimin e bulmetit janë ngritur punishte bulmeti. Djathi i Gjirokastrës është i përmendur.

Ndarja administrative. Qendra e rrethit të Gjirokastrës është Gjirokastra me më se 15.000 banorë. Gjirokastra është e ndërtuar në faqen lindore të Malit të Gjërë.

Nga larg, qyteti ka një pamje piktoreske me shtëpi që duken të ndërtuara njëra mbi tjetrën, dhe me lagje të përhapura; shumë prej këtyre lagjeve lidhen me ura, të cilat shkojnë mbi përrenjtë që përshkojnë qytetin. Kështjella, e ngritur në një nga kurrizet e qytetit, është e madhe dhe e mbajtur mirë.

Gjirokastra ka luajtur një rol me rëndësi në rilindjen kombëtare. Këtu ka lindur Çerciz Topulli, heroi i Mashkullores, që ka luftuar me heroizëm kundër okupatorëve turq. Edhe Enver Hoxha, diktatori komunist i Shqipërisë së sotme, është nga Gjirokastra.

Ky qytet është qendër e rëndësishme tregëtare e gjithë zonës që e rrethon. Bujqësia dhe blegtoria janë zhvilluar mjaft në këtë rreth. Ka edhe disa fabrika, si atë të miellit, të mobiljeve, të përpunimit të lëkurës, të këpucëve, të fermentimit të duhanit, uzinën e artikujve metalikë të konsumit të gjerë, uzinën mekanike

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

etj. Këtu gjendet një spital modern, një gjimnaz, një shkollë pedagogjike, një bibliotekë, një muze, një shtëpi kulture etj.



Qyteti muze, Gjirokastra, me kështjellën e mirëmbajtur.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

RRETHI I SARANDËS

Ky rreth shtrihet për së gjeri ndërmjet rrethit të Gjirokastrës dhe Detit Jon dhe për së gjati ndërmjet rrethit të Vlorës dhe Greqisë. Rrethi i Sarandës nuk ka male të larta, por kodrina dhe male të ulta. Klima e tij është tipike mesdhetare atlantike. Në veri përshkohet nga lumi i Kalasës dhe në jug nga lumi Pavllo.

Përsa i përket ekonomisë, ky rreth ka mjaft rëndësi për mbjelljen e orizit, por edhe frutikulturën e ka të zhvilluar, sidomos agrumet (portokaj, limoj etj.), si dhe rrushin e ullinjtë. Këtu gjendet fabrika e çveshjes së orizit, ajo e vajit dhe një fabrikë konservash.

Saranda është qendra e rrethit të Sarandës. Qyteti është i ndërtuar në breg të Detit Jon. Pas Vlorës është porti më i rëndësishëm i Shqipërisë së Jugut, dhe i treti në tërë Shqipërinë --pas Durrësit e Vlorës. Saranda lidhet me rrugë automobilistike me Gjirokastrën dhe me Vlorën.

Në jug të Sarandës është Butrinti, që ndodhet në bregun jugor të liqenit me këtë emër. Këtu janë bërë zbulime arkeologjike me rëndësi.

Delvina është qyteti i dytë me rëndësi në këtë rreth. Ndodhet në rrugën Gjirokastër-Sarandë, dhe është qendër bujqësore-blegtorale. Në qytet brenda ka kopshte me portokaj dhe me limoj.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Në afërsitë e Delvinës, nga lindja, është ngritur një hidrocentral mbi lumin Bistricë me një kapacitet prej 27.000 kw .

Në Vurg gjendet një fermë shtetërore (2.000 ha).



Shtëpi karakteristike gjirokastrite



Pamje e përgjithëshme e kodrës së Butrintit.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

RRETHI I TEPELENËS

Shtrihet ndërmjet rrethit të Gjirokastrës, të Përmetit, të Beratit, të Fierit dhe të Vlorës. Është një vend malor me gryka të mëdha. Më e madhja është Gryka e Këlcyrës, që formohet nga lumi Vjosa, e cila e ka prerë përmes vargun e maleve Trebeshinë nga ai i Lunxhërisë. Pjesa e poshtme veriore e lumit Drino i përket këtij rrethi.

Ky rreth është më tepër blegtoral se sa bujqësor. Ekonomikisht është rreth i varfër, por me gjithë atë ka një qendër industriale me rëndësi, minierën e qymyrgurit të Memaliajt, që po rritet e po bëhet një qytet i ri.

Tepelena është qendra e rrethit me këtë emër. Është një qytet i vogël, por përmendet në historinë e Shqipërisë, sepse këtu ka lindur Ali Pashë Tepelena që ka luftuar kundër turqve.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

RRETHI I PËRMETIT

Rrethi i Përmetit kufizohet nga veriu me rrethin e Skraparit dhe pjesërisht me atë të Beratit, nga lindja me rrethin e Kolonjës, nga jugu me Greqinë dhe me rrethin e Gjirokastrës, dhe nga perëndimi me rrethin e Gjirokastrës dhe me atë të Tepelenës.

Nëpër rrethin e Përmetit kalojnë vargmalet e larta të Shqipërisë Jugore: Trebeshinë-Dhëmbel-Nemërçkë. Ky rreth përshkohet nga lumi Vjosa. Lugina e Vjosës që kalon nëpër këtë rreth është mjaft e pasur në drithëra, perime dhe pemë, përndryshe vendi është blegtoral dhe i pasur në kullota. Rakia më e mirë e Shqipërisë bëhet në këtë rreth.

Përmeti është qendra e rrethit të Përmetit dhe ndodhet në krah të mëngjër të Vjosës, në rrëzë të malit Dhëmbel.

Në veri-lindje të Përmetit gjendet fshati i Frashërit, ku kanë lindur vëllezërit Abdyl, Naim dhe Sami Frashëri, të cilët kanë punuar shumë për zgjimin e ndjenjës kombëtare të popullit shqiptar.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

RRETHI I KOLONJËS

Rrethi i Kolonjës kufizohet në veri nga rrethi i Korçës, në lindje nga Greqia, në jug nga Greqia dhe nga rrethi i Përmetit dhe në perëndim nga rrethi i Përmetit.

Nëpër këtë rreth kalon lumi i Osumit, i cili buron nga pllaja e Kolonjës. Mali më i lartë i këtij rrethi është Gramosi në kufirin e Greqisë. Natyra fizike e këtij rrethi është malore, dhe vendësit merren me blegtori. Pllaja e Kolonjës ka më se 1000 m. lartësi nga sipërfaqja e detit.

Erseka është qendra e këtij rrethi. Përmendet si vend klimaterik.

Leskoviku është qyteti i dytë me rëndësi në këtë rreth, por klima e tij s'është si ajo e Ersekës, pasi bën mjaft të ftohët gjatë dimrit, kurse gjatë verës shumë të nxehtë.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

RRETHI I SKRAPARIT

Shikimi fizik, ekonomik dhe qyteti. Rrethi i Skraparit kufizohet me rrethin e Beratit, me atë të Gramshit, të Korçës dhe të Përmetit.

Edhe ky është një nga rrethet malore të Shqipërisë. Këtu zotërojnë malet e Ostrovicës e pjesërisht vazhdimi i maleve të Tomorit. Luginat janë shumë të pakta. Ky rreth ka një klimë tranzitore. Lumenjtë që e përshkojnë këtë rreth janë: rrjedhja e mesme e Osumit dhe Tomorica, degë e Devollit.

Rrethi i Skraparit nga pikëpamja ekonomike është një rreth blegtoral dhe rreth ku rriten frutat. Si rreth blegtoral rrit lopë, dhen e dhi. Nga pemët, më me rëndësi janë fiqtë, dardhat dhe sidomos rrushi që rritet në pjergulla. Në përgjithësi është një rreth i varfër malor.

Bujqësia zhvillohet në parcela të vogla.

Qendra e rrethit është Çorovoda, e lidhur tani vonë me Beratin me anë të një rruge automobilistike.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

RRETHI I KORÇËS

Shikimi fizik. Rrethi i Korçës gjendet në jug-lindje të Shqipërisë dhe kufizohet me rrethin e Pogradecit, me atë të Gramshit, të Skraparit e të Kolonjës, dhe nga lindja me Greqinë.

Relievi i këtij rrethi ka karakteristikat e veta. Gati i gjithë rrethi gjatë kufive ka male të larta, si Malin e Thatë, Moravën, Gramosin etj. E rrethuar nga këto male shtrihet fusha e Korçës me më se 800 m. lartësi, si dhe lugina e Devollit të sipërm me një lartësi që shkon prej 800 - 900 m. mbi sipërfaqen e detit. Këto dy fusha janë shumë pjellore. Fusha e Korçës me tharjen e liqenit të Maliqit u zgjerua dhe tani në vend të liqenit shtrihet një fushë e mbjellur me panxhar sheqeri dhe perime.

Klima e rrethit të Korçës, e përcaktuar nga relievi i lartë dhe nga largësia e deteve, është mesdhetare kontinentale. Në këtë rreth hidrografia përbëhet nga liqeni i Prespës së Madhe dhe i Prespës së Vogël që u përket tre shteteve kufitarë: Shqipërisë, Jugosllavisë dhe Greqisë. Rrjedhja e sipërme e Devollit i përket këtij rrethi.

Shikimi ekonomik. Rrethi i Korçës është i zhvilluar mirë ekonomikisht. Bujqësia në këtë rreth ka marrë një zhvillim të madh dhe sot është mjaft e përparuar. Është shtuar sipërfaqja

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

e tokës së punueshme, janë përdorur kultura të reja që nuk prodhoheshin fare më parë, si panxhari i sheqerit, dhe janë përdorur metoda të reja pune.

Kulturat bujqësore të këtij rrethi janë drithërat: gruri, misri, kulturat industriale, sidomos panxhari i sheqerit, elbi, urovi etj. Një rëndësi të madhe ka edhe prodhimi i fasuleve dhe i patateve.

Edhe frutikultura është mjaft e zhvilluar në këtë rreth. Dardhat dhe mollët e rrethit të Korçës janë nga më të mirat e vendit.

Në kullotat e pasura verore të këtij rrethi kullosin me qindra mijë bagëti, sidomos dhen e dhi.

Në industri rrethi i Korçës ka rëndësi të veçantë. Qendrat industriale janë: Korça, Mborja, Drenova dhe Maliqi.

Ndarja administrative e rrethit të Korçës. Qyteti i Korçës është qendra e rrethit. Qytete tjera me rëndësi që përfshihen administrativisht në rrethin e Korçës janë: Bilishti dhe Maliqi.

Korça është qyteti më i madh i Shqipërisë së Jugut dhe tani ka afër 47.000 banorë. Është e ndërtuar në pjesën lindore të fushës së Korçës në një lartësi 835 m. në këmbë të malit të Moravës.

Sot Korça është një qytet modern me rrugë të drejta dhe të gjera, me shtëpi të larta etj.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

E vendosur në një fushë pjellore, Korça është qendër me rëndësi bujqësore dhe tregëtare. Ajo lidhet me rrugë kryesore automobilistike me qytetet kryesore të Shqipërisë, si me Tiranën, Vlorën dhe Gjirokastrën, me të cilat shkëmben mallra të ndryshëm.

Korça është shquar gjithënjë në lëvizjet për liri. Ajo ka lojtur një rol të madh gjatë rilindjes kombëtare.

Këtu ndodhen një sërë fabrikash si ajo e birrës, e trikotazhit, e miellit, e alkoolit, e sheqerit, e qelqit, e mobiljeve, e përpunimit të lëkurës, e këpucëve, e konservave, uzina mekanike, TEC-i (centrali termo-elektrik), uzina e aparateve të precizionit etj.

Ky qytet ka rëndësi edhe në fushën arësimore. Këtu është hapur një nga shkollat e para shqipe më 1886. Sot ka shkolla të mesme, një bibliotekë të pasur, spitale etj.

Qytete tjera me rëndësi të këtij rrethi, siç thamë më lart, janë Bilishti e Maliqi.

Bilishti është qendër e lokalitetit të Bilishtit dhe ka rëndësi në pikëpamje bujqësore për rrethin e vet.

Maliqi është një qytet i ri industrial që po rritet dita ditës. Këtu gjendet fabrika e madhe e sheqerit.

Si qendër industriale e rrethit të Korçës është edhe miniera e qymyrgurit Mborje-Drenovë.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Në rrethin e Korçës ka edhe qendra klimaterike me rëndësi për arësye të klimës së shëndoshë që kanë. Vithkuqi, Dardha dhe Voskopoja janë qendra të tilla të dorës së parë.



Bllok i ri apartamentesh moderne në Korçë.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

RRETHI I POGRADECIT

Ky rreth kufizohet me liqenin e Ohrit, me rrethin e Librazhdit, të Gramshit e të Korçës dhe pjesërisht me Jugosllavinë.

Pogradeci është qendra e rrethit dhe është i ndërtuar në breg të liqenit të Ohrit. Klima e shëndetshme dhe pamja shumë e bukur e kanë bërë këtë qytet një qendër klimaterike pushimi. Pogradeci po rritet e zbukurohet vazhdimisht. Këtu është i zhvilluar shumë peshkimi.

Sidomos në pjesën jugore të këtij rrethi janë të zhvilluara po ato kultura bujqësore që zhvillohen në pjesën veriore të rrethit të Korçës.



Punim qilimash në Rrethin e Korçës

Endja e sixhadeve kërkon vëmëndje, duar të shkathëta, shije të hollë artistike.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

RRETHI I VLORËS

Shikimi fizik, ekonomik dhe qyteti. Rrethi i Vlorës kufizohet nga Deti Jon dhe nga Deti Adriatik, nga rrethi i Fierit, nga ai i Tepelenës, i Sarandës dhe pjesërisht nga ai i Gjirokastrës.

Relievi i këtij rrethi është i ndryshëm. Malet që gjenden ndërmjet Shushicës dhe detit janë mali i Çikës si dhe malet Rrëza e Kanalit që shkojnë drejt veri-perëndimit dhe zgjaten në malin e Karaburunit, dhe më përtej me lartësitë e Sazanit.

Fushat e këtij rrethi gjenden në luginën e Shushicës. Në këto fusha hyn edhe pjesa jugore e fushës së Myzeqesë.

Klima e rrethit të Vlorës është e tipit mesdhetar atlantik. Lumi Vjosa, Shushica (degë e Vjosës) dhe lumi i Dukatit që derdhet në gjirin e Vlorës i përkasin rrethit të Vlorës. Në rrethin e Vlorës gjendet edhe Këneta ose Liqeni i Nartës.

Rrethi i Vlorës ka një rëndësi të madhe ekonomike, sepse jo vetëm që ka një bujqësi të zhvilluar në të gjitha degët e saja, por edhe industria në këtë rreth ka marrë një hov të madh.

Në këtë rreth janë krijuar ndërmarrje shtetërore, fidanishte, si dhe kooperativa bujqësore; janë hapur kanale, si kanali i Himarës etj.

Rrethi i Vlorës është i pasur edhe me pemë si rrush, fiq, lajthi etj. dhe sidomos me agrume dhe ullinj. Agrumet e këtij

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

rrethi gjatë bregdetit shquhen për sasinë dhe cilësinë e tyre, kurse ulliri mbulon hapësira të mëdha si në Vlorë, ashtu edhe në Himarë.

Rrethi i Vlorës ka pak pyje, por ka kullota të pasura, ku kullosin një numër i madh bagëtish.

Peshkimi është zhvilluar si në këneta ashtu edhe në det.

Qendrat industriale të këtij rrethi janë: Vlora dhe Selenica.

Qendra e rrethit është Vlora me më se 46.900 banorë. Vlora është e ndërtuar në këmbë të kodrave të veshura me ullinj. Filloi të zhvillohet pas Luftës së Parë Botërore.

Vlora përmendet në historinë kombëtare të Shqipërisë sepse këtu më 28 Nëndor 1912 u ngrit flamuri dhe u shpall indipendenca e Shqipërisë. Ajo përmendet edhe për luftën kundër italianëve më 1920.

Vlora është porti i dytë i Shqipërisë dhe qendër e rëndësishme që lidhet me gjithë Shqipërinë e Jugut. Porti lidhet me qytetin me një rrugë kryesore automobilistike 2 km. të gjatë e me Selenicën me një rrugë dekovili. Me qytetet tjera lidhet me rrugë kryesore automobilistike.

Vlora është bërë qendër me rëndësi industriale. Këtu janë ngritur fabrika e çveshjes së orizit, e përpunimit të lëkurës (ekstrat-taninit), fabrika e madhe e çimentos "Lenin", fabrika

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

e mobiljeve, kombinati ushqimor "Ernest Telman", fabrika kimike, elektrike, e alkoolit, e sapunit etj.

Qendra tjera me rëndësi të këtij rrethi janë Himara e Selenica.

Selenica është bërë një qendër me rëndësi industriale, dhe çdo ditë po merr pamjen e një qyteti të ri me ndërtimin e apartamenteve për punëtorët e familjet e tyre dhe me klubet e sallat e dëfrimit.

Kthjellтësia e Detit Jon e mbleksur me bregdetin përherë të gjelbërt e bëjnë Himarën "rivierë të Shqipërisë".



Vlorë 1970

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

RRETHI I FIERIT

Shikimi fizik, ekonomik dhe qyteti. Rrethi i Fierit kufizohet me rrethin e Vlorës, me atë të Tepelenës, të Beratit, të Lushnjës dhe në perëndim me Detin Adriatik.

Rrethi i Fierit në pjesën perëndimore është tërë fushë; vetëm në pjesën jug-lindore lartësohen kodrat e Mallakastrës. Klima e rrethit të Fierit shkon nga tipi mesdhetar atlantik në perëndim në tranzitor në lindje e në jug-lindje. Ky rreth, përveç Semanit dhe Vjosës që i ka në kufi, ka edhe lumin Gjanicë, degë e Semanit.

Rrethi i Fierit ka një ekonomi të përparuar. Ky rreth është jo vetëm bujqësor, por edhe industrial. Ngritja e N.B.SH.-së, shtimi i kooperativave bujqësore, hapja e kanaleve vaditës, sidomos e kanalit Vjosë-Levan-Fier etj. kanë bërë që të rritet sipërfaqja e mbjellur, të shtohen kulturat bujqësore dhe rendimenti i tyre.

Nga kulturat bujqësore më me rëndësi të këtij rrethi janë: drithërat, pambuku, orizi etj. Rrethi i Fierit është rrethi i pemëve, sidomos në zonat kodrinore ku rriten hardhia, lajthia, bajamja etj. Ulliri është i përhapur shumë në Mallakastër. Rrethi i Fierit ka dy qendra industriale: Fierin dhe Patosin.

Qendra e rrethit të Fierit është Fieri me afro 18.000 banorë.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Fieri është i ndërtuar në krahun e mëngjër të Semanit në kryqëzimin e udhëve që vijnë nga Durrësi e Berati për në Vlorë. Fieri është një qytet i ri me rrugë të drejta e shtëpi të bukura. Fieri, i ndodhur në fushën e Myzeqesë, është qendër e rëndësishme bujqësore. Ka TEC-in (central termo-elektrik), uzinën e përpunimit të naftës, mullinj mielli, fabrikën e çveshjes së pambukut, fabrikën e mobiljeve, uzinën kimike (të plehrave azotikë), një fabrikë konservash etj. Në Fier, përveç shkollave fillore tetëvjeçare gjendet edhe teknikumi bujqësor. Lidhet me hekurudhë me Lushnjën e me qytete tjera të Shqipërisë qendrore.

Në perëndim të Fierit ndodhet Pojani (Apolonia), qytet i lashtë. Sot Pojani është vetëm qendër me rëndësi arkeologjike.

Qendër tjetër industriale është Patosi në jug-lindje të Fierit, në Mallakastër. Patosi është duke u zhvilluar shumë me ngritjen e objekteve industriale për çfrytëzimin e naftës etj.



Çezma a Nymfeu i Apollonisë.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

RRETHI I BERATIT

Shikimi fizik, ekonomik dhe qytetet. Rrethi i Beratit kufizohet nga rrethi i Lushnjës, i Elbasanit, i Gramshit, i Skraparit, i Fierit, i Përmetit dhe i Tepelenës.

Relievi i rrethit të Beratit është i ndryshëm. Malet si Tomori dhe Shpiragu, që kanë lartësitë më të mëdha të këtij rrethi, i përkasin pjesërisht rrethit të Beratit. Ky rreth ka kodra të shumta, si kodrat e Sulovës dhe pjesët e ulta të maleve Tomori e Shpiragu.

Fusha e Beratit shtrihet në të dy anët e rrjedhjes së mesme të Osumit. Ajo zgjerohet duke shkuar drejt perëndimit. Rrjedhja e poshtme e lumit Osum (ose lumi i Beratit) e përshkon këtë rreth nga lindja në perëndim. Devolli i përket pjesërisht rrethit të Beratit. Klima e këtij rrethi është tranzitore.

Rrethi i Beratit ka një bujqësi të zhvilluar. Një rëndësi të madhe në këtë degë të ekonomisë kanë kooperativat bujqësore, stacionet e maqinave dhe traktorëve, si edhe kanalet vaditës. Rritja në shkallë të gjerë e kulturave të orizit dhe të pambukut i kanë dhënë këtij rrethi rëndësi të madhe. Në këtë rreth gjenden edhe puset e vajgurit.

Kulturat kryesore të rrethit të Beratit janë drithërat si gruri e misri; orizi, pambuku etj. Ky rreth është edhe rrethi i pemëve ku rriten fiq, ftonj, dardha, kumbulla, arra, bajame

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.



Peizazh industrial — Qyteti Stalin.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

dhe rrush. Ulliri mbulon hapësira të mëdha dhe është një nga kulturat më me rëndësi të këtij rrethi. Ullinjtë e Beratit janë shumë të mirë si për industrinë e vajit, ashtu edhe për t'u ngrënë.

Blegtoria është e zhvilluar mirë. Në këtë rreth rriten shpend shtëpiakë, sidomos pata, rosa, gjela deti etj.

Qendra e rrethit të Beratit është Berati me më se 22.000 banorë. Berati është i ndërtuar në të dy anët e lumit Osum, aty ku ky del në fushë.

Berati, i përbërë prej dy pjesësh të lidhura me një urë guri të mesjetës dhe me shtëpi të ndërtuara në shpatet e kodrave të veshura me ullinj, është një qytet me panoramë të bukur.

Në Berat gjendet kombinati i madh i tekstilit, kantieri i ndërtimit të materialeve të parafabrikuara, fabrika e miellit, e mobiljeve, e vajit vegjetal, e konservave, e cigareve etj. Berati ka një shkollë pedagogjike, filialen e U.SH.T., një spital etj.

Qendra tjetër me rëndësi industriale e këtij rrethi është Qyteti Stalin.

Qyteti Stalin me më se 12.000 banorë ndodhet aty ku ishte përpara fshati i vogël Kuçovë. Ky qytet është një nga qendrat më të rëndësishme industriale të Republikës Popullore të Shqipërisë (këtu është ndërtuar rafineria e naftës). Ky qytet industrial po rritet nga viti në vit. Ndërtesa të bukura dhe

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

moderne janë ndërtuar për punëtorët, teknikët, inxhinierët dhe nëpunësit që punojnë në këtë qendër industriale. Krahas puseve të shumtë që mbulojnë hapësira të mëdha, ndërtimeve me karakter industrial dhe ndërtimeve për banim, janë ndërtuar edhe shkolla tetëvjeçare dhe teknikumi i naftës. Përveç këtyre ka klube, salla leximi, salla kinemaje, si dhe spitalin e qytetit.

1.



2.



1. Berati i sipërm - Kështjella.
2. Berati i poshtëm me urën mesjetare.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

RRETHI I LUSHNJËS

Shikimi fizik, ekonomik dhe qyteti. Rrethi i Lushnjës kufizohet me rrethin e Durrësit, të Elbasanit, të Beratit, të Fierit dhe me Detin Adriatik, që lag një pjesë të mirë të këtij rrethi.

Rrethi i Lushnjës ka një sipërfaqe të ulët; në këtë rreth zotëron fusha e Myzeqesë ndërmjet Shkumbinit dhe Semanit. Kodrat i ka të ulta, si kodrat e Divjakës etj.

Klima e këtij rrethi është kryesisht kontinentale në pjesën perëndimore dhe tranzitore në pjesën lindore. Me tharjen e kënetës së Tërbufit dhe me bonifikimin e gjithë kësaj fushe, Fusha e Myzeqesë, ndërmjet Semanit dhe Shkumbinit është bërë një nga fushat më pjellore të Shqipërisë. Kështu janë përfituar 6.000 ha. toka të reja duke arritur një sipërfaqe prej 18.000 ha. tokë të punueshme.

Rrethi i Lushnjës është një rreth kryesisht bujqësor. Këtu mbillen kultura të ndryshme bujqësore dhe në radhë të parë pambuku. Por edhe blegtoria në lidhje me bujqësinë është e zhvilluar, sidomos në kafshë të trasha e shpend. Ka disa fabrika, si p.sh. fabrikën e letrës, e kartonit katramat, e pllakave të eternitit të bituminuara dhe fabrikën e përpunimit të qumështit e të djathit.

Qendra e rrethit është Lushnja, me afro 16.000 banorë.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Lushnja ndodhet mbi rrugën automobilistike Durrës-Berat dhe Durrës-Vlorë dhe afër rrugës hekurudhore Rogozhinë-Fier.

Lushnja ka edhe një rëndësi historike. Këtu u mblodh Kongresi i Lushnjës më 21 Janar 1920, i cili së bashku me luftën e Vlorës kundër italianëve konsolidoi pavarësinë e Shqipërisë.



Shtëpia ku u mbajt Kongresi i Lushnjes.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

RRETHI I ELBASANIT

Shikimi fizik, ekonomik dhe qytetet. Rrethi i Elbasanit gjendet pothuaj i tëri në Shqipërinë e Mesme dhe kufizohet me rrethin e Tiranës, të Librazhdit, të Gramshit, të Beratit, të Lushnjës dhe të Durrësit. Në jug-lindje të këtij rrethi janë mali i Polisit dhe i Shpatit. Në pjesën qendrore, të rrethuar pothuaj nga male dhe kodra dhe gjatë rrjedhjes së mesme të lumit Shkumbin, shtrihet fusha e Elbasanit.

Klima e rrethit të Elbasanit është e ndryshme. Në të influencon relievi i lartë dhe Deti Adriatik. Ndërsa vendet e larta kanë klimë mesdhetare kontinentale, pjesa tjetër ka një klimë të zonës tranzitore.

Rrethi i Elbasanit ekonomikisht është mjaft i zhvilluar. Përveç drithërave, një rëndësi e madhe u është dhënë kulturave bujqësore, si duhanit, orizit dhe pambukut. Në këtë rreth është zhvilluar shumë frutikultura dhe sidomos ullinjtë e agrumet (në qytetin e Elbasanit), kurse blegtoria është e zhvilluar në malësitë e rrethit.

Pyjet e shumta të rrethit, si dhe të rretheve fqinjë, sidomos të rrethit të Tiranës furnizojnë me lëndë kombinatin e drurit "Nako Spiru".

Elbasani është qendra e rrethit të Elbasanit. Ka më se 35.000 banorë. Qyteti i Elbasanit ndodhet në fushën e Elbasanit,

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

buzë Shkumbinit, lugina e të cilit lidh detin me Shqipërinë e brendshme. Elbasani gjendet në një pozitë qendrore të Shqipërisë.

Qendra e qytetit është pazari me dyqane të stilit të vjetër. Këtu rrugët janë të ngushta. Shtëpitë janë të rrethuara me mure të larta e me kopshte portokajsh. Muret e kalasë së vjetër të ndërtuar prej venedikasve e më vonë prej turqve, agrumet brenda në qytet, ullishtet, kopshtet e gjera dhe fushat e duhanit në periferi të qytetit, i japin Elbasanit një pamje shumë të bukur.

Sot Elbasani po e ndërron pamjen e tij të vjetër me hapjen e rrugëve të gjera dhe me ndërtimet e ndryshme që po bëhen.

Elbasani është qendër me rëndësi ekonomike. Ka ekonomi bujqësore të zhvilluar, sidomos përmendet për mbjelljen e orizit. Në industri dallohet për këto fabrika: për fabrikën e vajit të ullirit, atë të sapunit, të alkoolit, të miellit, të cigareve, të orizit, të likusit, për kombinatin e drurit "Nako Spiru", për fabrikën e madhe të çimentos (me atë të Krujës e të Vlorës janë më të mëdhatë e Shqipërisë), për uzinën e metalurgjisë së zezë, për fabrikën e konservave etj.

Për shkak të pozicionit të tij qendror, Elbasani është nyje me rëndësi transporti. Lidhet me udhë kryesore automobilistike me Tiranën, Durrësin dhe Korçën. Rëndësia e Elbasanit u shtua me ndërtimin e hekurudhës Elbasan-Durrës-Tiranë dhe Elbasan-Prrenjas (kjo e fundit në mbarim e sipër).

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Elbasani përmendet edhe në fushën e arësimit. Aty është ngritur e para shkollë normale më 1909. Gjithashtu këtu kanë lindur edhe lavruesit e gjuhës shqipe: Kristoforidhi dhe Dhaskal Todri. Elbasani sot ka një shkollë pedagogjike, një muze, një bibliotekë etj.

Qendra tjera me rëndësi të rrethit janë: Peqini dhe Cërriku.

Peqini ndodhet në të djathtë të Shkumbinit mbi rrugën Elbasan-Durrës, dhe është një nyje me rëndësi, sepse lidhet me rrugë automobilistike dhe me hekurudhë si me Durrësin, ashtu edhe me Elbasanin e Cërrikun.

Cërriku po bëhet një qendër me rëndësi industriale. Është një qytet i ri, ku po ndërtohen ndërtesa për organet e pushtetit dhe apartamente për punëtorët e nëpunësit e rafinerisë së madhe të naftës, që është ngritur aty.

Elbasani



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

RRETHI I GRAMSHIT

Ky rreth kufizohet me rrethin e Elbasanit, me atë të Librazhdit, të Pogradecit, të Korçës, të Skraparit dhe të Beratit.

Gramshi është një rreth malor dhe qendra e tij është qyteti me të njëjtin emër. Mali më i lartë në këtë rreth është mali Guri i Topit. Ky rreth është më tepër blegtoral se sa bujqësor.

Përgjithësisht klima e këtij rrethi është tranzitore. Gramshi ka një rrugë kryesore që e lidh me qytete tjera të Shqipërisë. Ekonomikisht Gramshi është një nga rrethet e varfëra të Shqipërisë dhe nuk është aq i populluar. Në këtë rreth, afër kufirit me rrethin e Elbasanit, gjendet një grumbull i madh liqenësh të vegjël, po as që kanë peshk dhe as që janë vend banjash e verimi.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

RRETHI I LIBRAZHDIT

Rrethi i Librazhdit kufizohet me Jugosllavinë nga lindja, me rrethin e Dibrës dhe të Matit nga veriu, me rrethin e Tiranës, të Elbasanit dhe të Gramshit nga perëndimi dhe me rrethin e Pogradecit nga jugu.

Malet e Jabllanicës, që i përkasin Vargut lindor të Maleve të Shqipërisë sundojnë në pjesën lindore të këtij rrethi, kurse në pjesën veri-perëndimore ka malet e Çermenikës. Klima e këtij rrethi është mjaft e ftohët gjatë dimrit.

Edhe rrethi i Librazhdit është një rreth blegtoral. Në pikëpamje të industrisë Librazhdi ka rëndësi sepse pyjet e tij po shfrytëzohen vazhdimisht. Ky rreth është i pasur edhe në minerale sidomos në krom e hekur-nikel. Prrenjasi dhe Pishkashi, ku gjenden minierat e hekur-nikelit po lidhen me hekurudhë me Elbasanin.

Qendra e rrethit është Librazhdi, qytet i vogël, por që lidhet me rrugë kryesore automobilistike me Elbasanin, Peshkopinë dhe me Korçën.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

QYTETI I TIRANËS

Qyteti më i madh dhe kryeqyteti i Republikës Popullore të Shqipërisë është Tirana me më se 180.000 banorë. Tirana ndodhet në mes të fushës me të njëjtin emër dhe ka në lindje malin e Dajtit, në jug dhe në perëndim kodra të bukura të veshura me bimësi. Vetëm nga veriu qyteti është i hapët.

Për shkak të pozitës në mes të vendit, Tirana u caktua në Kongresin e Lushnjës (1920) si qendra e qeverisë dhe më vonë u bë kryeqytet i Shqipërisë. Që nga kjo kohë Tirana fillon të rritet dhe të zhvillohet me shpejtësi të madhe.

Sot Tirana është qyteti më i bukur i Shqipërisë. Me pallate dhe ndërtesa të mëdha, me rrugë të gjera, me lulishte e parqe të bukura, Tirana ka pamjen e një qyteti të madh.

Në qendër të qytetit janë ngritur monumente e buste të heronjëve të popullit, të njerëzve të rilindjes kombëtare etj.

Tirana është qendër politike, kulturale, tregëtare, nyje transporti dhe qendër ekonomike me rëndësi.

Këtu kanë selinë e tyre organet më të larta shtetërore e politike: Komiteti Qendror i Partisë, Kuvendi Popullor, Qeveria etj.

Tirana është qendra më e rëndësishme kulturale e Republikës. Këtu ndodhen muzeumet Arkeologjike-Ethnografike të Shkencave të Natyrës, ai i Lëvizjes Nacional-Çlirimtare, muzeumi Lenin-Stalin,

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Biblioteka Kombëtare, Pallati Ali Kelmendi, Pallati i Kulturës, ndërtesa e Lidhjes së Shkrimtarëve, Teatri Popullor, Teatri i Operas dhe i Baletit, Kinostudioja "Shqipëria e Re", Qendra e Televizionit, Pallati i Sportit "Partizani", Pallati i Sportit "Studenti", Stadiumet "Qemal Stafa", "Dinamo", "Partizani" etj.

Gjithashtu në Tiranë gjenden edhe institute të larta arësimore: Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti Pedagogjik, Instituti Bujqësor, Politeknikumi, Liceu Artistik, Shkolla e Fiskulturës, Shkolla e Oficerëve "Skënderbeg" dhe shkolla të shumta të mesme: gjimnaze, shkolla pedagogjike të mesme, teknikume të ndryshme, shkolla të rezervave të punës etj.

Në Tiranë ndodhen institucione shëndetësore të pajisura më së miri me aparate, si spitali civil, sanatoriumi, dispenseria, poliambulanca, materniteti etj.

Tirana po zbukurohet e rritet dita ditës. Sot ajo ka rreth 80 lulishtesh, dhe mijëra apartamente modernë janë ndërtuar dhe po ndërtohen gjithënjë.

Tirana është nyje me rëndësi transporti, ku kryqëzohen rrugët që vijnë nga të gjitha qytetet e krahinat e vendit dhe lidhet me hekurudhë me Durrësin, portin kryesor të Republikës, me Elbasanin, Fierin etj. Tetëmbëdhjetë kilometra në veri-perëndim të kryeqytetit gjendet aeroporti ndërkombëtar i Rinasit.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Kryeqyteti është njëkohësisht një qendër me rëndësi industriale. Rëndësia industriale e Tiranës është rritur me ngritjen e kombinatit të tekstilit "Stalin", (afër 5000 punëtorë) të fabrikës së stofrave të leshta, të filaturës së pambukut, të hidrocentralit "Lenin", të uzinave mekanike e metalike "Enver", "Partizani" e "Dinamo", të uzinës së madhe të pjesëve të ndërrimit për traktorë, të fabrikës së përpunimit të drurit "Misto Mane", të fabrikës së këpucëve, të uzinës "Tirana" (artikuj të konsumit të gjerë), të kombinatit ushqimor "Ali Kelmendi", të kombinatit të materialeve të ndërtimit "Josif Pashko", të fabrikës së bojrave, të uzinës gjeologjike, të fabrikës së përpunimit të qumështit, të fabrikës së qelqit, të tullave, të cigareve, të birrës, të likernave etj.



Me 11 shkurt 1920, ditën që Tirana u bë kryeqytet, në këtë vend u vendos qeveria shqiptare që doli nga Kongresi i Lushnjes.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

RRETHI I TIRANËS

Shikimi fizik, ekonomik dhe qyteti. Rrethi i Tiranës ndodhet në Shqipërinë e Mesme dhe kufizohet me rrethin e Krujës, të Matit, të Librazhdit, të Elbasanit dhe të Durrësit.

Relievi i rrethit të Tiranës ndahet në dy pjesë kryesore: në pjesën lindore zotërojnë zona malore me malin e Dajtit (1620 m.) në lindje të Tiranës, e tjera male; kurse në pjesën perëndimore gjendet zona e fushës dhe e kodrinave. Fusha më me rëndësi është fusha e Tiranës. Fusha e Tiranës ka një lartësi që shkon nga 120 gjer në 130 m. nga deti dhe është pothuajse e rrethuar me kodra të veshura me drunj mesdhetarë.

Klima e rrethit të Tiranës është e tipit tranzitor. Lumenjtë e këtij rrethi janë të pakët. Lumi Erzen i përket këtij rrethi vetëm në rrjedhjen e sipërme dhe të mesme, kurse rrjedhja e poshtme gjersa derdhet në Detin Adriatik, i përket rrethit të Durrësit.

Rrethi i Tiranës ka një rëndësi të madhe ekonomike. Bujqësia e këtij rrethi është mjaft e zhvilluar. Nga kulturat bujqësore, përveç drithërave, një vend me rëndësi u është dhënë edhe bimëve industriale, sidomos pambukut etj. Frutikultura e këtij rrethi është e zhvilluar: këtu rriten hardhia, dardha, kajsia, pjeshka, gështenja etj.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Blegtoria dhe rritja e bletëve është e zhvilluar në malësitë e rrethit. Në rrethin e Tiranës gjendet edhe miniera e qymyrgurit të Krrabës, si edhe sharrat e Bizës.

Qendra e rrethit të Tiranës është Tirana.

Qendra e vjetër me rëndësi e rrethit të Tiranës është Petrela. Petrela është një qendër e vogël banimi. Petrela ka një rëndësi për luftrat e heroit kombëtar, Skënderbeut, kundër turqëve.



Tirana: Pamje e Bulevardit "Shqipëria e Re".

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

RRETHI I DURRËSIT

Shikimi fizik, ekonomik dhe qytetet. Rrethi i Durrësit kufizohet me rrethin e Krujës, me atë të Tiranës, të Elbasanit, të Lushnjës dhe nga perëndimi laget nga Deti Adriatik.

Relievi i rrethit të Durrësit ndryshon nga relievi i gjithë rretheve tjerë të Republikës Popullore të Shqipërisë. Ky rreth ka kodra, si kodrat e Prezës, të Shijakut dhe të Kavajës, si edhe fusha, si fushën e Durrësit, të Shijakut dhe atë të Kavajës në anën veriore të fushës së Myzeqesë.

Rrethi i Durrësit ka një klimë të zonës mesdhetare atlantike dhe të zonës tranzitore. Ky rreth përshkohet nga rrjedhja e poshtme e Erzenit. Rrjedhja e poshtme e Shkumbinit e ndan nga rrethi i Lushnjës.

Rrethi i Durrësit ka një ekonomi të zhvilluar. Në bujqësi rol të madh lozin në këtë rreth N.B. Shtetërore, si ajo e Sukëthit, ajo e Xhafzotajt dhe ajo e Kavajës, që janë nga fermat më të mëdha të vendit. Në këtë rreth ka dy stacione të maqinave dhe të traktorëve. Në fushat e këtij rrethi janë hapur kanale kullues dhe vaditës.

Kulturat bujqësore janë rritur; kultura të reja po mbillen krahas me kulturat e mëparshme. Kështu, sot, përveç misrit, grurit, elbit e tërshërës, mbillen edhe bimë industriale si

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

pambuku, lule dielli etj. Një zhvillim të madh kanë marrë zarzavatet dhe bostani. Frutikultura në këtë rreth është e përhapur kudo; gjithashtu edhe ulliri.

Qendrat industriale të këtij rrethi janë Durrësi dhe Rogozhina.

Rrethi i Durrësit përshkohet më së miri jo vetëm prej rrugëve automobilistike, por edhe prej hekurudhës që e lidh me Tiranën, me Elbasanin, me Cërrikun, me Fierin, si edhe me Laçin. Hekurudha është mbaruar pas Luftës së Dytë Botërore (1949).

Qendra e rrethit është Durrësi me më se 47.800 banorë. Durrësi, pas Tiranës, është qyteti më i madh i Shqipërisë. Është i ndërtuar në këmbë të malit po me këtë emër. Durrësi është një qytet i bukur me ndërtesa të mëdha, rrugë të gjera e të drejta. Ai ka edhe gjurmë të ndërtimeve të vjetra, siç janë muret e kështjellës.

Gjatë luftës së fundit porti i Durrësit u dëmtua rëndë. Më vonë u ndreq dhe tani është i pajisur me mjete moderne për ngarkim-çkarkim.

Durrësi është porti më i rëndësishëm i Shqipërisë që kryen pjesën më të madhe të marrëdhënjeve me shtetet e huaja. Ai është bërë një qendër e rëndësishme tregëtare dhe transporti sidomos me ndërtimin e hekurudhës.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.



Një rrugë kryesore në Durrës



Fabrika e gozhdave në Kavajë

One DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Durrësi është edhe qendër industriale me rëndësi. Këtu gjenden fabrika të mëdha si ajo e mielit, e makaronave, e cigareve, e tullave, fabrika e përpunimit të gomës, e përpunimit të lëkurës, fabrika e plastmasit, e mobiljeve, ofiçina e lokomotivave, uzina mekanike, kombinati i pesticideve, kantieri detar etj.

Ka shumë shkolla tetëvjeçare, një gjimnaz, një bibliotekë, një spital dhe një shtëpi të invalidëve të luftës. Në jug të qytetit ndodhet plazhi, që është një nga plazhet më të mirë të Adriatikut.

Qendra tjera me rëndësi të rrethit të Durrësit janë: Shijaku Kavaja dhe Rogozhina.

Shijaku është një qytet i vogël, i ndërtuar në të dy anët e Erzenit. Shijaku është qendër bujqësore me rëndësi.

Kavaja ndodhet mbi rrugën automobilistike Durrës-Elbasan e Durrës-Lushnjë-Fier dhe mbi hekurudhën Durrës-Elbasan-Prrenjas e Durrës-Rogozhinë-Lushnjë-Fier. Kavaja është qendër me rëndësi për prodhime bujqësore dhe blegtorale. Këtu janë ndërtuar edhe këto fabrika: fabrika e vajit, fabrika e letrës, fabrika e gozhdave dhe bullonave, fabrika e xhamit dhe e qelqit etj. Nga artizanati, Kavaja zë vendin e parë në punimin e shtambave, pasi argjili i këtij vendi është shumë i përshtatshëm për këtë lloj arti.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Laçi është mbi rrugën automobilistike Tiranë-Shkodër dhe lidhet me hekurudhë me Durrësin dhe me Tiranën.

Kruja në mesjetë ka qenë kryeqendra e Kastriotëve; e pushtuar prej turqëve, u çlirua prej Skënderbeut dhe u bë kryeqyteti i Shqipërisë së atëhershme. Qyteti i Krujës është bërë i famshëm për qëndresën heroike kundër hordhive turke.



Vetëm kjo ku mbetur nga Kështjella e Krujës.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.



Uzina e superfosfatit të granuluar Lac (Foto N. Xhufka)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

RRETHI I MATIT

Shikimi fizik, ekonomik dhe qyteti. Rrethi i Matit kufizohet me rrethin e Dibrës, me atë të Librazhdit, të Tiranës, të Krujës, të Lezhës dhe të Mirditës.

Relievi i këtij rrethi është malor, por ka edhe lugina të gjera. Malet e tij janë Mali i Dejës, i Skënderbeut etj. Lugina e Matit është shumë pjellore. Klima e këtij rrethi është e tipit tranzitor. Lumi që e përshkon këtë rreth është lumi i Matit dhe degët e tij, më kryesorja Fani i Mirditës.

Rrethi i Matit është më fort një rreth i ekonomisë blegtorale dhe bujqësore. Këtu rriten dhentë e dhitë, si dhe drithërat.

Mbi lumin Mat ngrihen hidrocentralet "Karl Marks" dhe "Frederik Engels". Ndërtimi i këtyre dy hidrocentraleve si dhe i uzinës së përpunimit të kromit afër Klosit kanë një rëndësi të madhe edhe për zhvillimin e mëtejshëm të këtij rrethi. Po mbi këtë lumë kalon ura më e gjatë dhe më moderne e Shqipërisë, e ndërtuar në vitin 1930.

Burreli është qendra e këtij rrethi. Me ndërtimin e hidrocentraleve "Karl Marks" dhe "Frederik Engels" Burreli po bëhet një qendër me rëndësi.

Në fshatin Burgajet të rrethit të Matit pat lindur ish-mbreti i Shqipërisë, Zogu I (1895-1961).

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

RRETHI I DIBRËS

Shikimi fizik, ekonomik dhe qyteti. Rrethi i Dibrës kufizohet me rrethin e Kukësit, me atë të Mirditës, të Matit, të Librazhdit dhe nga lindja me Jugosllavinë.

Rrethi i Dibrës ka male të mëdha si malin e Korabit (2751 m.) që është mali më i lartë i Shqipërisë, malin e Deshatit etj. Në këtë rreth luginat janë të kufizuara, por nga luginat më me rëndësi është ajo e Drinit të Zi. Kjo luginë është shumë pjellore.

Ky rreth ka një klimë mesdhetare kontinentale. Lumi që e përshkon rrethin nga jugu në veri është Drini i Zi.

Rrethi i Dibrës është një rreth bujqësor e blegtoral. Nga kulturat bujqësore më me rëndësi janë drithërat dhe fasulet, bizelet etj. Këtu rriten dhentë e racës "rudë", sidomos në pjesën veriore të rrethit.

Në rrethin e Dibrës gjenden edhe minierat e kromit të Bulqizës. Ky rreth ka rezerva të mëdha allçie (gips) në malin Korab.

Qendra e rrethit të Dibrës është Peshkopia. Qyteti i Peshkopisë rritet vazhdimisht dhe zbukurohet me ndërtesa të mëdha. Këtu janë ndërtuar: një hotel modern, ndërtesa të shkollës pedagogjike etj. Qendra tjetër me rëndësi është Bulqiza, qendër industriale. Edhe Bulqiza po rritet vazhdimisht e po bëhet një qytet i vogël, por i bukur.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

RRETHI I KUKËSIT

Shikimi fizik, ekonomik dhe qyteti. Rrethi i Kukësit zë pjesën veri-lindore të Shqipërisë. Ky rreth kufizohet me Jugosllavinë, me rrethin e Dibrës, me atë Mirditës, të Pukës dhe të Tropojës.

Relievi i këtij rrethi është malor. Malet më me rëndësi janë: Pashtriku në të djathtë të Drinit të Bardhë, dhe në të majtë të tij gjenden Koritniku, Gjalica e Lumës etj. Luginat e këtij rrethi janë të ngushta, por pjellore, si ajo e Krumës, e Bytyçit etj.

Klima e rrethit të Kukësit është mesdhetare kontinentale. Rrethit të Kukësit i përket një pjesë e Drinit, si dhe rrjedhjet e poshtme të Drinit të Zi e të Drinit të Bardhë gjer në bashkimin e tyre afër Kukësit.

Rrethi i Kukësit, nga vetë natyra e tokës, ka të zhvilluar blegtorinë: dhen e dhi. Dhentë e këtij rrethi janë ato të racës rudë, që rriten në kullotat e Gjalicës së Lumës dhe të Koritnikut. Bujqësia po zhvillohet nëpër lugina. Rrethi i Kukësit e ka frutikulturën të zhvilluar. Prodhon dardha, mollë, rrush, gështenja, kumbulla etj. Ky rreth ka një pasuri të madhe pyjore.

Qendra e rrethit të Kukësit është Kukësi. Ky qytet është një qendër e vogël banimi, dhe është i ndërtuar aty ku bashkohet Drini i Bardhë me Drinin e Zi. Jo shumë larg nga vendi ku

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

ndodhet qyteti sot është duke u ndërtuar Kukësi i ri, pasi me ndërtimin e hidrocentralit të ri që parashihet të ndërtohet në këtë zonë, Kukësi i vjetër do të përmbytet nga liqeni artificial i Fierzës. Në Kukës po zhvillohet industria lokale dhe artizanati. Kjo qendër ka shkolla tetëvjeçare dhe një gjimnaz.

Në Rrethin e Kukësit gjendet miniera e kromit në Kalimash dhe vendburimi më i madh i Shqipërisë për nxjerrjen e bakrit në Gjegjan. Këtu janë ndërtuar një numër uzinash për përpunimin e metaleve, si p.sh. uzina e metalurgjisë së bakrit në Kukës, uzina e pasurimit të kromit dhe uzina e përpunimit të hekur-nikelit.



Rritja e dhënve është traditë e lashtë e banorëve të kësaj krahine. Në foto: **Bariu i tufës së qingjave të NBSH-së, Feim Dafku.**

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.



Qyteti i ri i Kukësit.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

RRETHI I TROPOJËS

Shikimi fizik, ekonomik dhe qytetet. Ky rreth kufizohet me Jugosllavinë, me rrethin e Kukësit, me atë të Pukës dhe të Shkodrës.

Rrethi i Tropojës është malor, dhe formohet prej pjesës lindore të Alpeve të Shqipërisë. Mali më me rëndësi i këtij rrethi është Shkëlzeni (2460 m.). Në këtë rreth mungojnë fushat dhe luginat e gjera, por me gjithë këtë gjatë rrjedhjeve të lumenjve janë sajuar lugina të vogla dhe pjellore. Lugina më me rëndësi është ajo e Valbonës.

Përsa i përket klimës, rrethi i Tropojës hyn në zonën klimatike mesdhetare kontinentale. Ky rreth përshkohet, në një pjesë fare të vogël, prej Drinit, në të cilin derdhet Valbona. Valbona i përket pothuaj krejt këtij rrethi.

Rrethi i Tropojës në pikëpamje ekonomike është rrethi i blegtorisë dhe i bujqësisë. Një rëndësi të madhe ka për këtë rreth frutikultura. Ka pyje të tërë me gështenjë, mollë dhe kumbulla.

Këto kohët e fundit në këtë rreth kanë gjetur edhe bakër. Gjatë Luftës së Dytë Botërore kromin nga minierat e fshatit "Degë" e shfrytëzuan gjermanët; tani ai bën pjesë në kompleksin metalurgjik të vendit.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Qendra e rrethit është Bajram Curri (ish Kolgecaj). Bajram Curri, nga një fshat shumë i vogël, po rritet vazhdimisht. Qendër tjetër e këtij rrethi është Tropoja, e ndërtuar në rrëzë të Shkëlzenit.



Bukurija e forca e këtyre valleve do të shoqërojë brezat e ardhshëm.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

RRETHI I SHKODRËS

Shikimi fizik, ekonomik dhe qyteti. Rrethi i Shkodrës zë një pjesë të mirë të Shqipërisë së Veriut dhe kufizohet nga perëndimi dhe veriu me Jugosllavinë, nga lindja kufizohet pjesërisht me Jugosllavinë, me rrethin e Tropojës, me atë të Pukës, dhe me rrethin e Lezhës; nga jugu pjesërisht me rrethin e Pukës, të Lezhës dhe me Detin Adriatik.

Relievi i këtij rrethi është i ndryshëm. Gjithë pjesa veriore dhe gati gjithë pjesa jug-lindore e lindore e këtij rrethi është e mbuluar me male të larta, kurse pjesa tjetër është e ulët. Alpet e Shqipërisë mbulojnë gjithë pjesën veriore të këtij rrethi në krahun e djathtë të Drinit. Këtu gjenden maja të larta si mali i Jezercës afër 2693 m., që është mali më i lartë i Shqipërisë pas Korabit; pastaj vjen mali i Shënikut, i Radohimës, i Cukalit etj.

Fushat e rrethit të Shkodrës shtrihen që prej rrëzës së Alpeve të Shqipërisë në veri, në kufi me Jugosllavinë, gjer te Deti Adriatik. Fushat kryesore të këtij rrethi janë: fusha e Shtoit, ajo e bregut të Bunës dhe pjesërisht fusha e Zadrimës.

Klima e këtij rrethi të madh ndryshon. Në pjesën më të madhe ky rreth ka një klimë mesdhetare kontinentale; pjesa tjetër gjatë perëndimit hyn në zonën tranzitore.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Ky rreth është mjaft i pasur nga pikëpamja hidrografike. Këtu gjendet liqeni i Shkodrës (360 km^2) dhe lumenjtë Bunë, Kir, Drinas, dhe Drini që përshkon pothuaj krejt rrethin e Shkodrës.

Rrethi i Shkodrës, megjithëqë në pjesën më të madhe është një vend malor, prapseprapë ka një bujqësi dhe një industri mjaft të zhvilluar.

Bujqësia e këtij rrethi është e zhvilluar sidomos në pjesën e ulët. Ka shumë ndërmarrje bujqësore. Instituti Zooteknik i Shkodrës merret me studimin dhe seleksionimin zooteknik të gjësë së gjallë dhe veçanërisht të gjedhave, të dhenve, të derrave etj., si edhe me rritjen e pemëve dhe të fidaneve të hardhisë, të manit etj. Punime të mëdha janë bërë dhe po bëhen për hapjen e kanaleve vaditës-kullues, për rregullimin e përrenjve, për mbjellje pyjore etj. Për të ndaluar dëmtimin e tokave të Zadrimës nga lumi i Drinit dhe nga Gjadri duhet të bëhen punime të mëdha.

Nga kulturat bujqësore, rëndësi të dorës së parë kanë misri dhe duhani. Duhani i këtij rrethi është i një cilësie të lartë. Nga frutikultura fiqt e rrushi rriten më shumë se pemët tjera në në këtë rreth.

Blegtoria është e zhvilluar në të gjithë rrethin. Dhentë e rrethit të Shkodrës dhe gjedhat janë të racës shkodrane.

Gjedhi i këtij qarku, lopa e kuqe e Shkodrës, jep shumë

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

qumësht me një përqindje të lartë undyre dhe është një kafshë që u qëndron vështirësive të klimës së ashpër.

Në këtë rreth ka rëndësi edhe rritja e krimbit të mëndafshit, peshkimi (në liqenin e Shkodrës, në Bunë etj.), si dhe gjahu i shpendëve të egjër.

Qendra industriale e rrethit është Shkodra.

Thethi i Shalës i krahinës së Dukagjinit dhe Boga janë të përmendura si vende klimaterike. Që të dyja këto vende i përkasin rrethit të Shkodrës.

Qyteti i Shkodrës ka mbi 47.000 banorë dhe është i treti qytet i Shqipërisë (pas Tiranës e Durrësit) për madhësi. Ndodhet pranë liqenit me të njëjtin emër e ndërmjet Kirit, Drinasit dhe Bunës. Shkodra është një qytet i hapët, me rrugë të drejta dhe me shtëpi të mëdha.

Shkodra është një qendër bujqësore, blegtorale dhe industriale. Këtu ka këto fabrika: fabrika e çimentos, e tisazhit (tekstili), e cigareve, e konservave, fabrika e fermentimit të duhanit "Vasil Shanto", fabrika e telave prej bakri dhe e motorëve të ndryshëm, fabrika e letrës, e makaronave, e alkoolit, e sapunit, e këpucëve, e mobiljeve, fabrika e përpunimit të lëkurës, fabrika e përpunimit të qumështit, uzina mekanike, kombinati i drurit etj.

Shkodra ka një gjimnaz, një shkollë pedagogjike, një spital, sanatorium, stadiumin, pallatin e sportit, teatrin etj.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Shkodra është edhe një port i lundrimit të brendshëm me anë liqenit të Shkodrës dhe me anë të Bunës. Udhët automobilistike e lidhin me Tiranën dhe me krahina tjera.

Në Shkodër ka edhe shumë objekte të kohës së vjetër, që dëshmojnë për zhvillimin kultural në të kaluarën. Në këtë qytet është mësuar gjuha shqipe në shkollat franceskane aty nga mesi i shek. të 19-të e këtej, do të thotë para se Shqipëria të bëhej shtet më vete.

Përveç Koplikut dhe Vaut të Dejës, rrethi i Shkodrës nuk ka ndonjë qytet tjetër me rëndësi; por edhe këto që u përmendën janë më tepër fshatra të mëdhaj se sa qytete. Në Vaun e Dejës është duke u ndërtuar mbi lumin Drin hidrocentrali më i madh i Shqipërisë.

Një nga rrugët kryesore të Shkodrës.



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

RRETHI I PUKËS

Ky rreth kufizohet me rrethin e Shkodrës, me atë të Kukësit, të Mirditës, të Tropojës dhe me rrethin e Lezhës.

Është një rreth malor që shtrihet në jug të Drinit, nga ku fillon edhe vargu i maleve qendrorë të Shqipërisë.

Edhe Puka ka një klimë kontinentale tranzitore. Ky rreth është rreth blegtoral dhe fare pak bujqësor. Malet që përfshin ky rreth janë shumë të pyllëzuara, prandaj në këtë rreth gjenden sharrat më të mëdha të Shqipërisë për industrinë e drurit. Fshati Fusha-Arrëzit është qendra e industrisë së drurit.

Qendra e rrethit është qyteti i vogël i Pukës, dhe përshkohet nga rruga automobilistike që lidh Shkodrën me Kukësin.

Shkodra e parë nga Rozafa.



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

RRETHI I MIRDITËS

Rrethi i Mirditës kufizohet nga veriu me rrethin e Pukës, nga lindja me rrethin e Kukësit e të Dibrës, nga jugu me rrethin e Matit dhe nga perëndimi me rrethin e Lezhës.

Ky rreth është një krahinë malore, me male jo shumë të larta. Ka një klimë kontinentale dhe tranzitore. Lumenjtë që e përshkojnë këtë rreth janë Fani i Madh dhe Fani i Vogël, që bashkohen dhe formojnë lumin Fani, degë e lumit Mati.

Edhe ky rreth është rreth blegtoral, por vendësit merren pak a shumë edhe me bujqësi. Rrethi i Mirditës, si ai i Pukës, i Librazhdit, i Gramshit dhe i Skraparit, është një rreth i varfër përsa u përket prodhimeve bujqësore. Por ky rreth është i pasur në pyje (pjesa lindore) dhe tani në kohët e fundit janë gjetur shtresa të pasura bakri në Kurbnesh.

Qendra industriale e bakrit për këtë rreth është bërë Kurbneshi, por edhe miniera e mëparshme e bakrit, Rubiku, punon vazhdimisht. Për arësye të vendburimeve minerale, në këtë rreth janë ndërtuar edhe një numër uzinash, si p.sh. uzina metalurgjike në Rubik, uzina e pasurimit të bakrit në Kurbnesh e uzina e pasurimit të bakrit në Reps.

Në Rubik gjendet një shkollë e mesme industriale.

Qendra administrative e rrethit të Mirditës është Rrësheni, një fshat i ndërtuar në luginën e Fanit të vogël. Këtu ka një gjimnaz të plotë.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Himara në jug dhe Mirdita në veri përmenden në historí si dy krahina që kanë ruajtur një gjysmë pavarësie edhe gjatë pushtimit turk.



The ciftelia complex of the art group of the Mirdita District which participated in the Vlora festival playing various folk melodies.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

RRETHI I LEZHËS

Rrethi i Lezhës shtrihet ndërmjet rrethit të Shkodrës, të Pukës, të Mirditës, të Matit, të Krujës dhe Detit Adriatik.

Në pjesën perëndimore ky rreth përbëhet nga gjysma e fushës së Zadrimës dhe nga fusha e Bregut të Matit, kurse nga lindja ka male, që vijnë duke u ngritur. Lumi që kalon nëpër këtë rreth është Drini (i Lezhës), i cili në veri të rrethit bashkohet me Gjadrin, pastaj, duke kaluar pranë qytetit të Lezhës, derdhet në Detin Adriatik.

Rrethi i Lezhës është kryesisht një rreth bujqësor e blegtoral. Me bonifikimin e Fushës së Lezhës dhe të Bregut të Matit kulturat bujqësore më me rëndësi janë bërë drithërat, orizi, duhani, hardhitë etj. Përsa i përket blegtorisë sidomos dhentë e bagëtia e trashë mbahen me shumicë, por rëndësi të madhe kanë edhe derrat e shpendët.

Qendra e rrethit është qyteti i vogël i Lezhës, i ndërtuar mbi të dy anët e rrugës automobilistike që vete për në Shkodër. Në këtë rreth gjendet edhe porti i vogël i Shëngjinit; këto kohët e fundit plazha e tij po bëhet edhe qendër verimi.

Lezha ka rëndësi historike pasi këtu më 2 mars 1444 u mblodhën princat feudalë shqiptarë (Kuvendi i Lezhës) nën kryesinë e Skënderbeut. Po këtu me 17 janar 1468 vdiq dhe u varros ky hero i kombit shqiptar.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Gjatësia e kufirit

në kilometra

Shtetet	Gjithsejt	Nga kjo			
		Tokësore	Lumore	Liqenore	Detare
Gjatësia e përgjithshme	1.204	577	83	72	472
— Me Jugosllavinë	476	347	64	65	—
— Me Greqinë	256	230	19	7	—

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Pasqyrë mbi lumenjtë kryesorë të Shqipërisë

Emri i lumit	Gjatësia në km.	Sipërfaqja e pellgut të lumit në km^2.
1. Drini	281	5817
2. Mati	104	2478
3. Ishmi	70	626
4. Erzeni	91	773
5. Shkumbini	146	2358
6. Semani	252	5923
7. Vjosa	238	4323
8. Buna	44	

Pasqyrë mbi liqenët kryesorë

Emri i liqenit	Sipërfaqja në km2	Lartësia në m. nga deti	Thellësia maksimale në m.
Liqeni i Shkodrës	372	6	10-13
Liqeni i Ohrit	360	695	286*
Liqeni i Prespës	286	853	54
Liqeni i Butrintit	16	0	25

* është liqeni më i thellë i Europës.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

MESATARJA E RESHJEVE VJETORE NË SHQIPËRI

Stacioni Meteorologjik	Milimetra (mm.)
Shkodër	2200
Kukës	900
Peshkopi	945
Lezhë	1262
Burrel	1215
Krujë	1615
Tiranë	1189
Durrës	1040
Elbasan	1103
Korçë	660
Berat	930
Lushnjë	886
Vlorë	1047
Himarë	1555
Tepelenë	1439

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Gjendja e pronësisë së tokës para vitit 1945

Kategoria e pronarit	F a m i l j e		Toka në zotërim		Mesatarja për familje
	Numër	%	Ha	%	
Latifondistë	7	0,006	14.554	3,70	2,07
Pronarë të pasur	4.713	3,034	9.133	23,16	19,00
Çifliqet e shtetit	--	--	50.000	12,71	--
Pronarë të vegjël e të mesëm.....	128.961	83,080	237.668	60,43	1,80
Fshatarë pa tokë	11.545	13,880	--	0,00	0,00
Gjithësejt:	155.222	100,000	393.355	100,00	

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Çpronësimet pas vitit 1945

Kategoria e pronarëve të çpronësuar	Çpronësimet			
	Nr. pronarëve	Ara(Ha)	Ullinj (rrënjë)	Kafshë pune
Pronarë të çpronësuar tërësisht.....	8.714	54.599	287.944	5.923
Pronarë të çpronësuar pjesërisht....	10.641	64.997	125.259	--
Çifliqet e shtetit.....	--	50.000	--	-- --
Entet fetare.....	--	3.163	61.024	-- -- --
	19.355	172.659	474.227	5.923

shënim:

Tani, përveç kopshteve private të kooperativistëve, të tëra tokat janë çpronësuar nga shteti.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

DENDËSIA E POPULLSISË

Viti	Dendësia: frymë për km.			Rritja e dendësisë në % (1923=100)		
	Në Republikën	Në qytetet	Në fshatrat	Në Republikën	Në qytetet	Në fshatrat
1923	28,0	4,4	23,6	100,0	100,0	100,0
1945	39,0	8,3	31,7	139,5	187,2	130,6
1950	42,4	8,7	33,7	151,6	195,8	143,3
1955	48,4	13,3	35,1	173,0	302,2	148,6
1960	56,0	17,3	38,7	200,0	393,1	164,0
1962	60,1	19,6	40,5	214,6	445,1	176,1

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Qytetet e Shqipërisë me popullsi mbi 5 mijë frymë
(në mijëra frymë)

Nr.	Qytetet	1923	1938	1945	1960	1964
1.	Tiranë	10,8	25,1	60,0	136,4	157,0
2.	Shkodër	21,6	25,3	34,2	43,2	47,0
3.	Vlorë	5,9	9,9	12,7	41,3	47.0
4.	Durrës	4,8	10,5	14,2	39,9	47,8
5.	Korçë	25,6	21,2	24,6	39,4	43,7
6.	Elbasan	10,4	12,7	14,7	29,8	35,3
7.	Berat	8,0	9,6	12,0	18,6	22,0
8.	Kavajë	6,3	7,3	9,7	14,2	17,6
9.	Fier	1,5	4,8	7,5	14,3	17,8
10.	Gjirokastër	8,9	8,8	9,4	14,0	15,0
11.	Lushnjë	1,9	4,3	5,5	12,5	16,0
12.	Qyt. Stalin	----	----	----	10,3	12,4
13.	Pogradec	2,3	3,6	5,0	7,8	9,0
14.	Sarandë	----	1,8	1,5	6,0	7,7
15.	Krujë	3,6	3,7	6,0	6,2	6,7
16.	Delvinë	2,5	2,5	3,5	5,1	5,6
17.	Patos	----	----	----	4,8	6,3
18.	Cërrik	----	----	----	4,7	5,0
19.	Peshkopi	----	1,1	2,0	3,5	5,0
20.	Shijak	1,1	2,2	2,6	4,2	5,1

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Prodhimi i naftës brut gjatë periudhës 1928-1964

1928-35	(gjashtëmujori i parë)	9.770	tonelata
1935	(gjashtëmujori i dytë)	13.120	"
1936		51.000	"
1937		93.000	"
1938		108.000	"
1955		208.078	"
1958		403.200	"
1960		727.519	"
1961		770.920	"
1962		785.208	"
1963		750.793	"
1964		763.723	"

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

DISA SHIFRA TJERA

Gjerësia e Shqipërisë.....75 - 148 km.

Gjerësia maksimale e Shqipërisë.....148 km.

Gjatësia nga Veriu (Vermosh) në Jug (Konispol)...340 km.

Lartësia mesatare nga niveli i detit.....714 m.

LARGËSITË DETARE

Durrës - Bari.....220 km.

Durrës - Brindisi.....150 km.

Durrës - Shëngjin..... 60 km.

Durrës - Vlorë.....110 km.

Vlorë - Sarandë.....120 km.

Brindisi - Korfuz.....219 km.

Kanali i Korfuzit (i gjërë).... 4 km.

Kanali i Otrantos (Karaburun - Otranto)..72 km.

Sipërfaqja e ishullit Sazan..... 5.7 km^2

Gjatësia e Gjirit të Vlorës.....16 km.

Gjerësia e Gjirit të Vlorës..... 6 km.

Sazan - Skelja e Vlorës.....15 km.

Sazan - Kepi i Treportit..... 8 km.

Sazan - Karaburun (Kepi i Gjuhëzës).. 5 km.

LARGËSITË AJRORE (AFËRSISHT)

Tiranë - Romë.....587 km. (365 mila)

Tiranë - Trieste.....666 km. (415 mila)

Tiranë - Bari.....214 km. (141 mila)

Tiranë - Beograd.....394 km. (245 mila)

Tiranë - Athinë.....500 km. (311 mila)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

NJË PËRMBLEDHJE E HISTORISË SË SHQIPËRISË

Nga kohët e lashta gjer në Luftën e Parë Botërore.

Shqiptarët e sotëm janë pasardhësit e Ilirëve. Ilirët kanë ardhur në Gadishullin Ballkanik 3000 vjet para Krishtit dhe u vendosën në bregun lindor të Adriatikut, nga Epiri gjer në Alpet e Austrisë.

Pas shumë luftërash të gjata, mbretëria e Ilirëve mori fund më 168 pr.Kr. duke u bërë koloni romake. Kështu, Ilirët u bënë shtetas romakë, duke i dhënë kësaj perandorie njerëz të mëdhenj. Romakët ndërtuan në Iliri rrugën e famshme Via Egnatia, që lidhte Romën me Perandorinë Bizantine.

Me shkatërrimin e Perandorisë Romake dhe me ardhjen e sllavëve në Ballkan, Shqipëria pësoi fatin e banorëve tjerë të gadishullit; nga shekulli i 12-të gjer në shek. e 14-të u pushtua nga zaptues të ndryshëm dhe herë pas here u çlirua. Ushtria e Stefan Dushanit, e themeluesit të Perandorisë Serbe, në të 14-in shekull pushtoi një pjesë të madhe të Shqipërisë. Pas vdekjes së Stefan Dushanit Shqipëria u nda në principata feudale, të sunduara nga princër të vendit.

Kur turqit sulmuan Gadishullin Ballkanik, më 1385, princërit shqiptarë kishin bërë një koalicion ushtarak; ky koalicion u thye nga ushtritë e turqve dhe krerët e Shqipërisë u detyruan, jo

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.



Dress of Illyria origin, Lepidia (in the middle of the 1st century before our era)



Illyrian pillar on Teutaia's tomb (III-I centuries b.c.)



Silver Illyrian fibula (III-I centuries b.c.)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.



Objekte të kulturës së hershme mesjetare shqiptare të zbuluar në varrezën pranë Sardës (Shurdh) mesjetar, në rrethin e Shkodrës.



Vathë të gjetura ne varrezën e mesjetës së hershme të Krujës. Janë punuar nga mjeshtrat arbër të mesjetës në bronx, argjënd e ar. Janë karakteristikë për kulturën e hershme shqiptare dhe nuk gjinden jashtë tokave të banuara nga shqiptarët.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

vetëm ta njihnin pushtetin e tyre, por t'i paguanin Turqisë një haraç të përvitshëm. Sundimi i Turqisë në Shqipëri u ndërpre nga një periudhë 24 vjetësh pamvarësie, fryt i kryengritjes së shqiptarëve të kryesuar nga Gjergj Kastrioti, i mbiquajtur "Skënderbej".

GJERGJ KASTRIOTI-SKËNDERBEU (1405? - 1468)

Gjatë kohës që jetoi Skënderbeu, me përjashtim të disa skeleve bregdetare të Venedikut, turqit po e plotësonin pushtimin e të tërë Gadishullit Ballkanik. Po në atë kohë e tërë Europa ishte e ndarë në mbretëri, principata e dhespotate të vogla, të cilat luftonin njera kundër tjetrës, gjë që lehtësoi shumë vërshimin e hordhive otomane në vendet kristiane. Në këtë gjendje grindjesh mesjetare secilit shtet, principatë e dhespotat i u desh të përballonte pothuajse vetëm fuqinë ushtarake më të fortë e më të organizuar të kohës. E njëjta gjë u ndodhi edhe principatave të Shqipërisë së asaj kohe.

Një nga principatat shqiptare që luftoi me trimëri kundër turqve qe edhe ajo e Gjon Kastriotit, babait të Skënderbeut, i cili, kur u thye për të tretën herë nga turqit, pranoi paqën. Si shumica e princërve tjerë, edhe ai u bë vasal i Sulltanit duke i dhënë këtij të fundit péng të katër djemtë e tij: Stanishin, Konstantinin, Reposhin dhe Gjergjin. Për të tre

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Skënderbeu



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

vëllezërit e parë të Gjergjit historia flet pak ose aspak, por më i vogli nuk i humbi lidhjet me atdhenë e vet. Si peng ai qe i detyruar të merrte pjesë në fushatat luftarake të turqve, ku tregoi zotësi e zgjuarësi të veçantë, për të cilat fitoi besim, mori tituj nga Sulltani dhe u bë i famshëm.

Kryengritjet e shqiptarëve që shpërthyen gjatë viteve që Gjergj Kastrioti ish peng, fitoret e tyre të para e pastaj shtypja e tyre me egërsi nga turqit i lanë atij përshtypje të thellë. Duke e konsideruar si trashëgimtar të zotërimeve të Gjon Kastriotit, dhe duke parë aftësitë e tij të shquara ushtarake, shumë shqiptarë vajtën shpeshherë në Turqi ta ftonin që t'i drejtonte në luftë. Rasti i kthimit erdhi më 1443 kur ai u dërgua nga Sulltani të luftonte kundër hungarezëve nën Princin e Transilvanisë, Gjon Huniadin (Korvin-in). Sipas historianit shqiptar, Marin Barletit, Skënderbeu, para se të braktiste frontin, mori me forcë një ferman (dekret) të rremë nga Sekretari i Sulltanit, me anë të të cilit sundimtari turk i Krujës do t'i dorëzonte vendin e tij trashëgimtarit legjitim të Katriotëve. Kështu Skënderbeu me nja 300 shqiptarë vajti në Krujë, mori në dorëzim kështjellën, sulmoi e asgjësoi garnizonin që e mbronte, hapi kushtrimin e kryengritjes dhe më 28 nëntor 1443 e shpalli Principatën e Kastrotëve të pavarur. Pastaj, duke përfituar nga përparimet e Huniadit, pushtoi njerën pas tjetrës kështjellën e

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.



Përqëndrimi i qëndresës shqiptare
1443-1468

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Petrelës (afër Tiranës), atë të Gurit të Bardhë (Mat), të Stelushit, të Tromacit dhe të Sfetigradit (Dibër) duke e mëkëmbur kështu të tërë Principatën e Kastriotëve.

LIDHJA SHQIPTARE NË KUVENDIN E LEZHËS (1444)

Qëllimi i Skënderbeut nuk ish vetëm çlirimi i principatës së tij nga turqit, por i tërë Shqipërisë, prandaj ai i ftoi bujarët shqiptarë për bisedime. Fitoret e Huniadit në zemër të Ballkanit, lajmet që qarkullonin se Europa Qendrore e Perëndimore po organizonte një fushatë kundër turqve, suksesi i shpejtë i Skënderbeut, si dhe entuziazmi e gadishmëria e popullit për të luftuar kundër turqve i bindën bujarët shqiptarë për një kryengritje të përgjithshme. Mbledhja u mbajt në Lezhë, zotërim i Venedikut. Aty u ftuan të dëgjonin bisedimet si Republika e Venedikut, ashtu edhe ajo e Raguzës, miqësia dhe ndihma e të cilave i interesonte shumë Skënderbeut. Nga bujarët që morën pjesë në mbledhje ishin: Gjergj Arianiti, Andrea Thopia, Nikollë Dukagjini, Theodor Korona Muzaka, Pal Dukagjini, Lekë Zaharia, Lekë Dushmani, Gjergj Stresh Balsha, Pjetër Spani, Stefan Cërnojeviqi i Malit të Zi etj. Skënderbeu u foli pjesëmarrësve mbi të kaluarën e tij, mbi gjendjen ballkanike, mbi gjendjen e Turqisë dhe veçanërisht mbi nevojën që të lidhnin besën për të luftuar armikun e përbashkët. Besëlidhja u arrit dhe besëlidhësit

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

e zgjodhën Skënderbenë njëzëri si kryetar të besëlidhjes dhe kryekomandant të tyre. Ndër vendimet tjera me rëndësi të Lidhjes së Lezhës ishin edhe këto:

1. të formohej një ushtri shqiptare e kryesuar (si u tha) nga Skënderbeu;

2. të krijohej arka e përbashkët për të përballuar shpenzimet e luftës dhe

3. secili bujar të ish autonom dhe Skënderbeu të ish i parë në mes të të barabartëve.

Duke i shqyrtuar këto tri pika kryesore të vendimeve të Lidhjes, rrethanat e luftës dhe pjesëmarrësit feudalë në të, shohim se Shqipëria nën Skënderbenë u bë konfederatë e lirë dhe jo mbretëri e centralizuar si mund të kish pretenduar çdo tjetër feudal mesjetar. Duhet marrë parasysh edhe se shumica e tokave të bujarëve pjesëmarrës ose ishin zotërime të Republikës së Venedikut ose ishin të pushtuara nga turqit. Së paku këto të fundit duheshin çliruar me anë të këtij bashkimi të parë kombëtar. Kjo na jep të kuptojmë edhe se të tëra luftat e Skënderbeut brenda Shqipërisë kanë qenë lufta mbrojtje e qëndrese për pavarësi.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

ORGANIZIMI I USHTRISË

Puna e parë që bëri Skënderbeu pas formimit të federatës qe krijimi dhe funksionimi i ushtrisë dhe forcimi e mbrojtja e kështjellave. Për t'i a arrijtur këtij qëllimi ai u përpoq të zhdukte grindjet ndërmjet feudalëve besëlidhës, shumicën e të cilëve i pajtoi; ca prej tyre i bëri për vete dhe i shtiu në ndëgjesë të tij të plotë. Kështu ai mundi të vente fshat më fshat dhe t'i regjistronte vetë ushtarët. Bërthama e ushtrisë së tij dolli nga zotërimet e Kastriotëve; pjesën tjetër e përbënin ushtarët e bujarëve dhe ca reparte tjera mercenare (franceze, italiane etj). Ushtrinë e ndau në ushtri të përhershme, në atë ndihmëse për kohë lufte dhe në repartet e kufirit. Listat e ushtarëve për kushtrime bazoheshin në thirrjen "burrë për shtëpi". Por nganjëherë kur e kërkonte nevoja, si në luftën e vitit 1450, thirreshin të tërë meshkujt që mund të mbarnin armë. Çdo repart kish nga 2000-3000 vetë. Oficerët i zgjidhte nga aristokracia feudale ose nga ushtarët e dalluar për trimëri, të cilët u përpoq t'i shpërblente me toka e gradime. Si strateg ai e hartonte vetë planin e luftës dhe merrte vetë pjesë në të. Taktika e tij ishte ajo e tërheqjes për ta futur armikun aty ku donte dhe për ta sulmuar pastaj në kohën e volitshme. Skënderbeu vetë nuk ndryhej kurrë ndër kështjella për t'u mbrojtur, por linte në to ndonjërin nga besnikët e tij më me përvojë dhe ai vetë në

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

krye të grupeve a çetave sulmuese i dobësonte e demoralizonte krahët armikut nga jashtë dhe i kapte furnizimet. Në strategjinë e Skënderbeut duhet përmendur edhe rjeta e fortë e informatorëve që ai mbante në këmbë për çdo lëvizje dhe veprimtari të armikut.

POLITIKA E JASHTME E SKËNDERBEUT

Mjetet dhe fuqia luftuese që mund të mblidhte Skënderbeu për t'u qëndruar turqve ka qenë jashtëzakonisht e pabarabartë, prandaj ai kish nevojë të madhe për aleatë e ndihmë të shteteve të huaja, sidomos të atyre që ishin të kërcënuara nga vrulli i pushtimeve turke. Kjo nevojë e dyanëshme e përforcoi pozitën e Skënderbeut e të popullit shqiptar në fushën ndërkombëtare. Së pari Skënderbeu hyri në marrëdhënie me Republikën e Vendikut, e cila zotëronte qytetet bregdetare shqiptare me rëndësi: Shkodrën Lezhën, Durrësin etj., ashtu si sundonte edhe një numër të madh qytetesh bregdetare të Mesdheut, prej nga bënte tregëti me Perandorinë Turke. Është tamam kjo gjë që shpeshherë marrëdhëniet e Skënderbeut me Venedikun qenë të ndera e kaluan gjer në përleshje. Përkundrazi, si me Papatin, ashtu edhe me Republikën e Raguzës kryetrimi shqiptar ka pasë gjithëherë marrëdhënie miqësore. Mund të thuhet se ndihmat më të mëdha materiale i erdhën Skënderbeut nga Alfonsi V, mbreti i Napolit, i cili ishte në ngatërresa e luftë me Venedikun dhe synonte për të krijuar një perandori të

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

veten. Kur Skënderbeu u kërcënua nga të katër anët dhe u trathëtua nga ca princër e komandantë vendas, ai, për të marrë ndihmat e domosdoshme, bëri një marrëveshje me Alfonsin V të Aragonëve të cilin e njohu formalisht si kryezot. Me Dhespotin e Serbisë, Gjergj Brankoviq-in, i cili u shtërngua të bëhej vasal i Sulltanit, Skënderbeut i patën dalë mjaft telashe. Por miqësinë më të çeltërt Skënderbeu e pati me Gjon Huniadin në fushën e luftës. Asnjëherë marrëdhëniet e marrëveshjet e tyre s'ranë në kundërshtim në luftën e përbashkët kundër armikut.

LUFTAT KRYESORE TË SKËNDERBEUT KUNDËR TURQVE

1. Fitoret e para. - Më 1444 Sulltan Murati II dërgoi 25.000 ushtarë nën komandën e Ali Pashës, i cili e sulmoi Shqipërinë ngá Lugina e Drinit të Zi drejt Dibrës. Skënderbeu e priti me 10.000 ushtarë në Fushën e Dibrës dhe në fillim bëri sikur u thye. Ushtria turke e ndoqi, por në fushën e ngushtë të Torviolit shqiptarët u ranë turqve nga malet dhe i thyen plotësisht (29 qershor) duke vrarë 7.000 vetë dhe zënë rob 500 tjerë. Nga ana shqiptare ranë në fushën e betejës 3.800 vetë. Ishte hera e parë që shqiptarët mësuan nga strategu Skënderbe si ta frenonin veten duke u tërhequr me rregull të plotë, duke u fshehur e dalur papritmas, duke e lënë ndjekjen përgjysmë për t'u kthyer në baza dh duke qëndruar në pozitat e tyre pa u shtyrë tepër. Me një fjalë

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

ata nxunë si të jenë besnikë e zbatues të përpikët të urdhërave për të cilët ata s'dinin gjë më parë, dhe zbatimi i të cilëve nuk mund të vihej në diskutim.

Po në atë vit mbreti Vladislav i Polonisë e sulmoi ushtrinë turke në Varnë (Bullgari e sotme), por ushtria e tij u thye dhe ai vetë mbeti i vrarë. Pas kësaj fitorje Sulltan Murati i u drejtua Shqipërisë, por u thye nga forcat e Skënderbeut si më 1445 në Fushën e Domosdovës, ashtu edhe më 1446 në Fushën e Dibrës së Sipërme.

2. Ngatërresat me Venedikun e me Gjergj Brankoviqin. - Këto fitore shqetësuan jo vetëm turqit, por edhe venedikasit, të cilët pushtuan qytetin e vogël të Danjës (Vau i Dejës i sotëm). Skënderbeu me "Lidhjen Shqiptare" e mbajti këtë qytet të rrethuar më 1447 dhe u lidh me Gjergj Brankoviqin, Dhespotin e Serbisë, dhe me mbretin e Napolit, Alfonsin. Venediku i nxiti turqit t'i binin Skënderbeut pas shpine dhe i premtuan 100 dukat në muaj atij që do ta vriste Skënderbenë. Kështu më 1448 vetë Sulltan Murati e sulmoi Shqipërinë ndërsa Skënderbeu po korrte fitoren kundër vendikasve në brigjet e Drinit. Sulltani rrethoi Sfetigradin, pas ca kohe i preu ujin e pishëm dhe më në fund e mori. Skënderbeu, i gjetur në një luftë dy frontesh midis dy armiqve të mëdhej, bëri paqë me Venedikun dhe hoqi dorë nga rrethimi i Danjës.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.



Vendosja e kalave shqiptare dhe drejtimi i ekspeditave të ushtrive turke.

More DLI courses on Live Lingua - Online Language School.

Kur Gjon Huniadi lidhi besë me Skënderbenë dhe sulmoi turqit, Dhespoti i Serbisë i preu rrugën Huniadit dhe e zuri. Atëherë forcat shqiptare në shenjë hakmarrje sulmuan dhe shkatërruan ca vise të vasalit të Sulltanit, të cilit i kish dhënë edhe të bijën për grua.

3. Rrethimi i parë i Krujës. - Më 1450 Sulltan Murati II me të birin, Mehmetin II sulmoi personalisht Krujën. Skënderbeu nuk i doli hapur ushtrisë së madhe turke, por e la të arrinte gjer te muret e Krujës, që i mbronte Kont Urani me nja 1500 burra, kurse Skënderbeu me nja 8.000 vetë e dërmonte vazhdimisht ushtrinë sulmuese nga pusitë dhe u kapte furnizimet, me të cilat mbante edhe popullsitë e fshatrave të strehuara nëpër male nga furia turke. Pasi rrethimin e zgjatën ndihmat që i vinin ushtrisë turke me anë të Venedikut nga Shkodra e Durrësi, Skënderbeu u ra edhe këtyre. Kështu, pas katër muajsh, rrethimi dështoi dhe Sulltan Murati u kthye në Adrianopojë. Ky qëndrim heroik i a rriti famën Skënderbeut në opinionin publik europian. Si rrjedhim, në Krujë erdhën delegacione të shumta nga Europa për ta përgëzuar Skënderbenë.

4. Disfata e Beratit dhe fatkeqsitë tjera. - Pushtimi i Konstantinopojës më 1453 i shtiu tmerin tërë Europës, por një vit më vonë ushtritë e Sulltanit u thyen në Serbi. Kjo ngjarje

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

e fundit i dha zemër Skënderbeut të sulmonte Beratin, të cilin e kishin marrë turqit. Në fillim puna vajti mbarë, por gjatë afatit që i u dha garnizonit turk për dorëzim, Moisi Golemi trathëtoi dhe ushtria turke nën Isak Bej Evrenosin e dërmoi ushtrinë shqiptare e ca reparte të Alfonsit përreth Beratit. Kjo disfatë i kushtoi shtrenjtë Skënderbeut: Alfonsi V i ndaloi ndihmat, ca krerë feudalë, të shtyrë nga Venediku, u mënjanuan; Dukagjinët u bënë me turqit; Gjergj Stresh Balsha dorëzoi kështjellën e Modricës më 1456; po atë vit trathëtoi edhe Hamzai, nipi i Skënderbeut, dhe më në fund vdiq edhe aleati më i mirë i Skënderbeut, Gjon Huniadi.

Një vit më vonë, më 1457 Sullтani dërgoi Evrenosin dhe Hamza Kastriotin me 80.000 vetë kundër Skënderbeut, i cili në fillim la të kuptonte se u tërhoq duke shpërndarë ushtrinë. Por kur turqit po kremtonin fitoren në Fushën e Albuenës afër Milotit të sotëm, Skënderbeu u ra papritur dhe e shkatërroi fare ushtrinë turke duke kapur edhe nipin e tij trathëtar, Hamzanë. Këtë e dërgoi në Itali ku mbaroi në burg. Kjo fitore e re i hapi derën Skënderbeut për të kërkuar përsëri ndihma në Europë. Pasi korri edhe tri fitore tjera kundër ekspeditave turke, Skënderbeu bëri një paqë tri vjetësh me turqit për ta çlodhur e përforcuar ushtrinë e rraskapitur për 15 vjet rrjesht.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

5. Ekspedita e Skënderbeut në Itali. - Një nga shkaqet tjera që e shtyu Skënderbenë të bënte paqë me Sullтanin qe edhe thirrja për ndihmë që i bëri mbreti i Napolit, Alfonsi, i cili po i humbte një nga një zotërimet e tija në Itali. Kështu më 1461 Skënderbeu u hodh në Itali me një fuqi të vogël, mori kështjellën e Barletës dhe më vonë Tranin dhe i a dorëzoi aleatit të tij.

Pasi u kthye në Shqipëri më 1462 Skënderbeu theu tri ekspedita turke të dërguara nga Sullтan Fatihu: në Mokër, në Fushën e Pologut dhe afër Ohrit. Pasardhësi i Fatihut, Sullтan Mehmeti i kërkoi paqë Skënderbeut. Paqa u pranua dhe u nënshkrua në Shkup më 1463; por pregatitja e një kryqëzate nga ana e krishterimit, traktati i miqësisë me Venedikun dhe pajtimi me Dukagjinët e bënë Skënderbenë ta prishte paqën me turqit. Fatkeqësisht vonesa e kryqtarëve dhe sidomos vdekja e Papës Piu II që kish organizuar kryqëzatën e lanë Skënderbenë ballë për ballë turqve.

6. Rrethimi i dytë i Krujës. - Tani Sullтani kish rast të çfrynte kundër Skënderbeut duke e shkatërruar Shqipërinë me plaçkitje për ta shtërnguar të dorëzohej. Prandaj më 14 gusht 1464 dërgoi një ekspeditë, të cilën Skënderbeu e theu në Ohër; më 1465 dërgoi një tjetër nën Ballaban Pashën që u thye në Bulqizë dhe pastaj edhe një tjetër që u thye në Fushën e Kasharit afër Tiranës. I zemëruar nga këto humbje, më 1467 Sullтan Mehmeti II u nis vetë për Shqipëri në krye të 150.000 ushtarëve dhe rrethoi

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Krujën duke përdorur të gjitha mjetet e mundshme për shkatërrimin e popullsisë dhe të prodhimeve tokësore. Duke parë furinë e pafrenuar të turqve, këtë herë shqiptarët braktisën të tëra fshatrat e ulta dhe luginat e u tërhoqën për shpëtim e mbrojtje ndër male të thyera. Historiani turk Qemal Pashë Zadeja thotë se turqit bënë aq shumë plaçkë, sa edhe kuajt e ngarkuar me barrë të rënda ngordhën rrugës. Një historian tjetër i kohës, Kritobuli, shkruan se shumë vajza e gra shqiptare, për të mos rënë në dorë të turqve, u hudhën nga shkëmbinj të thepisur në greminë. Skënderbe e la mbrojtjen e Krujës nën komandën e Tanush Thopisë me 4.000 burra, kurse ai vetë me 8.000 tjerë i sulmonte pareshtur turqit pas krahësh. Pas dy muaj rrethimi, pushtuesi i Konstantinopojës e la rrethimin dhe u kthye në Stamboll, por rrugës ndërtoi kalanë e Elbasanit që ta përdorte për sulmet e mëvonshme, si edhe pushtoi qytetin e Qidhnës malore, banorët e së cilës i masakroi për hakmarrje.

Menjëherë pas largimit të Sulltan Mehmetit II, Skënderbeu vajti në Itali ke Papa dhe në Napoli, prej nga mori ca ndihma materiale. Posa u kthye, sulmoi e mundi Ballaban Pashën, i cili e mbante ende Krujën të rrethuar.

7. <u>Rrethimi i tretë i Krujës</u>. - Me vrasjen e Ballaban Pashës nga mbrojtësit e Krujës, Sulltan Mehmeti u zemërua për së tepërmi dhe u kthye përsëri në Shqipëri për rrethimin e tretë të Krujës;

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

por, me gjithë rrenimet që bëri ushtria Turke rreth Durrësit, Shkodrës e Krujës, shqiptarët s'u dorëzuan. Vetëm pas dy javësh qëndrimi në Shqipëri, Sullтani u kthye prapë në Stambol1. Ushtritë që la pas u thyen keqas njera pas tjetrës nga Skënderbeu, i cili e çliroi Krujën. Për t'i përmbledhur fuqitë dhe për t'i riorganizuar Skënderbeu thirri në janar të 1468-ës edhe një mbledhje në Lezhë, por në prakun e kuvendit ai ra i sëmurë dhe vdiq më 17 janar. U varros në Kathedralen e Shën Kollit të Lezhës duke lënë në zi e vaj tërë Shqipërinë dhe miqt e tij.

FIGURA E SKËNDERBEUT

Me vdekjen e tij u mbyll fleta e artë e qëndresës shqiptare. Pas dhjetë vjetësh Kruja ra në dorë të turqve, pastaj Shkodra dhe kështu Shqipëria u pushtua tërësisht nga otomanët. Me Skënderbenë Shqipëria humbi lirinë, Europa mbrojtësin dhe aleatin më të fortë që kish mbetur. Si strateg ai dijti të tërhiqej në Torviol, të sulmonte në Abulenë, të sulmonte kundër kalorësve të lehtë e të rëndë në Italí, të fuste në grackë ushtri të mëdha si në Oranik, Polog etj. Taktika e çetave "sulmo e tërhiqu" është sekreti i qëndresës së Skënderbeut. Megjithëse atë e trathëtuan edhe njerëzit më të afërm si Hamzai e Moisiu, ai s'e humbi shpresën, por luftoi, dhe kur i kapi u falí jetën. Për të janë shkruar mbi 600 libra në gjuhë të ndryshme dúke i a përjetësuar emrin dhe

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.



Skënderbeu në çastet e fundit të jetës. (Tablo e piktorit Simon Rrota).

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

nëpërmjet të tij edhe qëndresën e popullit shqiptar gjatë mesjetës. Kështu ai mbetet në histori si heroi dhe njeriu më i madh që ka pasur Shqipëria, si mbrojtësi i saj dhe i krishterimit dhe si njeri nga luftarët më të famshëm të kohës së tij.

PËRPJEKJE LIRIE TË DËSHTUARA GJATË GJYSMËS SË DYTË TË SHEK. XVIII

Edhe pas vdekjes së heroit kombëtar, Gjergj Kastriotit, shqiptarët janë përpjekur të shfrytëzonin çdo rast të favorshëm për ta hedhur poshtë zgjedhën turke. Në të vërtetë nuk mund të thuhet se e tërë Shqipëria ishte e pushtuar plotësisht tërë kohën nga Turqia, sepse herë pas here, ja në një krahinë ja në një tjetër ka pasur vazhdimisht lëvizje dhe kryengritje kundër skllavërisë turke qoftë për arësye të shtypjes së lirisë, të mohimit të fesë, të grabitjes së pasurisë, të taksave të rënda, ose të përdhunimeve tjera të gjithëfarë llloji. Privilegjet dhe gjysmë-autonomia që gëzonin krahina e Himarës në Jug dhe ajo e Mirditës në Veri e vërtetojnë këtë tezë. Me gjithë atë u deshën më se treqind vjet pushtimi që Turqia të jepte shenjat e dobësimit dhe të tronditjes nga brenda dhe nga jashtë gjersa shqiptarët të fillonin sulme të organizuara në masë kundër perandorisë për t'i ndihmuar shembjes së saj.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Ndër sundimtarët më me famë që gati qenë duke e bërë Shqipërinë të pavarur gjatë gjysmës së dytë të shek. të 18-të dhe fillimit të të 19-tit shek. historia përmend Bushatlijtë e Sanxhakut të Shkodrës - Mehmet, Mustafa dhe sidomos Kara Mahmud Pashë Bushatin në Veri, dhe Ali Pashë Tepelenën e Sanxhakut të Janinës në Jug.

1. Kara Mahmud Pasha, ose Mahmud Pashë Plaku, si e quante populli, sundoi nga 1756 gjer më 1796. Ai me politikën e tij të brendshme u përpoq të afronte Shqipërinë Veriore, Lindore dhe atë të Mesmen duke e bërë Shkodrën si qendër tregëtare, dhe në të njëjtën kohë synoi në krijimin e një njësie administrativo-politike të pavarur.

Ai ndoq një politikë bashkëjetese e tolerance, tolerancë fetare që s'u pëlqente turqve, kështu ai fitoi përkrahjen e plotë të malësorëve katolikë dhe të një pjese të mirë të shtresave të ulta shoqërore të qyteteve e të fushave pa dallim feje, veçanërisht të zanatlijve bakallë dhe terzi që kishin krijuar në Shkodër bashkimet e para të punëtorëve. Në kohën e tij u përkrah arësimi dhe arti, sidomos folklori popullor. Taksat, gjyqet, apelimet dhe e tërë administrata kryhej nga njerëzit e rekrutuar prej tij dhe jo nga Sullтani ose të dërguarit e tij. Simboli politik i Bushatliut të shquar ish Skënderbeu.

Në politikën e jashtme, duke përfituar nga luftat e Austrisë dhe të Rusisë kundër Turqisë, Kara Mahmud Pasha u vu në lidhje me

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

fuqitë e krishtera perëndimore dhe u mundua ta qetësonte fqirin e vet ortodoks nga veriu, Malin e Zi, të cilin e ndihmonte dhe e shtynte aq fort Rusia kundër tij e Turqisë. Kara Mahmudi qe bërë kryetar i koalicionit shqiptar-malazez-boshnjak kundër Turqisë; pat hyrë në marrëdhënie të mira diplomatike me Republikën e Venedikut, me Austrinë dhe me Francën etj. Për tërë këtë veprimtari të shumanëshme Turqia e dënoi tri herë me vdekje, dhe për ta zbatuar këtë dënim e rrethoi Shkodrën dy herë (1787 dhe 1793), por që të dyja herët u thye keqas nga fuqitë e Pashës së Shkodrës. Kur u dënua për herën e tretë nga Porta (Porta ose Porta e Lartë quhej selia e Sultanit) Kara Mahmudi u fal me ndërhyrjen e mbretit të Spanjës të nxitur nga vetë Papa i Romës (1794-95).

Me gjithë qëllimet e tija të qarta për pavarësi (Austria dhe Rusia i patën premtuar ta njihnin mbret të Shqipërisë së pavarur), dhe me gjithë luftat që bëri kundër Turqisë Kara Mahmud Pasha ca herë luftoi edhe përkrah Turqisë, si p.sh. në Vidin të Bullgarisë së sotme më 1791, në More të Greqisë dhe ca herë me radhë kundër Malit të Zi. Kjo do të thotë se Turqia kish nevojë për fuqinë e tij nga një anë, dhe nga ana tjetër Bushatliu i Shkodrës as që u përkrah as që u kuptua sa duhej nga mbretëritë e krishtera të Europës së atëhershme; prandaj ai u shtërngua të ndërronte anë për të përfituar nga koha dhe për të marrë sa më shumë armatime nga Porta. Ai u vra duke luftuar kundër Malit të Zi në shtator

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

të 1796-ës. Pas vdekjes së tij Pashallëku i Shkodrës hyri përsëri nën bindjen e plotë të Sulltanit.

Luftat e Kara Mahmud Pashës kundër Turqisë nuk patën qëllime të kufizuara separatiste, por ato qenë një pikënisje e shëndoshë për rezistencën e mëtejme kundër pushtuesit dhe për procesin e formimit të kombit shqiptar.

2. Ali Pashë Tepelena (1753-1822). Po në atë kohë kur Pashallëku i Shkodrës ishte në kulmin e shtrirjes së vet, në Jug të Shqipërisë u formua edhe Pashallëku i Janinës, edhe më i fortë se i pari. Ky u drejtua nga dora e fortë e Ali Pashë Tepelenës. Ky tepelenas i ashpër, me një dinakëri të pashoqe, me një vullnet të pathyeshëm, me energji të pashterrur dhe me krime të ndryshme ia hapi rrugën vetes, dhe, duke eliminuar çdo kundërshtar, arrijti të bëhej sundimtari i Sanxhakut të Tërhallës (1787), në të cilën bënte pjesë Pashallëku i Janinës. Ai i zgjëroi kufitë e sundimit të vet mbi gjithë Shqipërinë e sotme Jugore, mbi Epirin, Thesalinë dhe Morenë, që do të thotë edhe mbi shumicën e Greqisë së sotme duke i bërë në fakt të tëra këto vende prej më se 1 milion e gjysmë banorësh krejtësisht të varura prej tij dhe jo prej Sulltanit.

Kjo veprimtari e tij energjike tërhoqi vemendjen e personaliteteve të huaja, kështu që shtetet më të fuqishme të Europës së asaj kohe dërguan pranë Ali Pashës misionet e tyre diplomatike

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

e ushtarake për marrëveshje. Rrjedhimisht çështja shqiptare u ngrit në arenën ndërkombëtare.

Kur Franca mori zotërimet e Venedikut në Detin Jon, Ali Pasha hyri në korrespondencë personale me Napoleon Bonapartin, i cili e njohu menjëherë pozitën e këtij burri shteti të fuqishëm. Kur ra Napoleoni, ai i përzuri francezët dhe u lidh me anglezët, me të cilët u prish më vonë për skelen e Pargës. Porta e pat emëruar vezir "governator" kur i pat nxjerrë francezët nga Deti Jon. Në kohë paqe Ali Pasha mbante një ushtri prej 15.000 vetësh, kurse në kohë lufte e trefishonte.

Me prestigjin që fitoi e presionet që bënte, Ali Pasha lidhi krushqi me shumë pashallarë shqiptarë, të cilët pastaj i futi në grackën e sundimit të tij. Të dy djemtë e tij - Velinë dhe Myftarin arrijti t'i emëronte pashallarë në vende kyçe, prej nga e ndihmuan në ndërmarrjet e tija të guximshme. Ali Pasha, që në fillim të karierës së tij pati vetëm dy çifliqe, vdiq si pronar i më se 900 çifliqeve. Megjithatë ai qe një kursimtar i fortë dhe arka e qeverisë së tij ishte përherë plot për çdo rast lufte, ryshfeti ose blerjeje. Ai vetë drejtoi politikën e brendshme dhe të jashtmen, dhe përqëndroi në duart e veta si pushtetin legjislativ ashtu edhe atë ekzekutiv.

Kështu edhe ky pashë shqiptar ra në kundërshtime të papajtueshme me Portën, sepse deshi të shkëputej plotësisht nga

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Turqia dhe të krijonte shtetin e tij me sa më shumë toka shqiptare. Kjo përpjekje për pavarësi përputhi jo vetëm me dëshirat e popullit shqiptar për çlirim, por edhe me ato të popullit grek. Ali Pasha në oborrin e tij kish këshilltarë e sekretarë që dinin gjuhët e shteteve përfaqësuese. Por këshilltarët e tij më me rëndësi ishin grekërit Stavro Çapallono dhe Mantho Ekonomi, të cilët dijtën të përfitonin nga fuqia e madhe e Ali Pashës kundër Turqisë në dobi të Greqisë. Në të vërtetë pak pasi ra Janina në dorë të turqve dhe Ali Pashës i u pre koka (1822) dhe i u dërgua në Stamboll, Greqia fitoi lirinë e vet me kryengritje. Mbi varrin e kokës së tij është shkruar ky epitaf: "Këtu është varrosur koka e të famshmit Ali Pashë Tepelenës, ish-qeveritar i Janinës, i cili më tepër se 30 vjet qeverisi i pavarur Shqipërinë."

Episodet e ndryshme rreth Ali Pashës e sidomos rreth vdekjes së tij janë bërë subjekt librash historie, letërsie, muzike e artesh tjera të asaj kohe në tërë Europën. Pas Skënderbeut ai është figura më e rëndësishme shqiptare që frymëzoi jo vetëm poetë, shkrimtarë e dramaturgë të mëdhaj e përparimtarë, si Lord Byron-in (p.sh. Childe Harold), Victor Hugo-n, Lemercier-in etj., por edhe koreografë e muzikantë të ndryshëm që i zgjodhën subjektet e tyre po nga jeta dhe veprimtaria e Ali Pashës për melodrame, opera, opereta, balete etj. Nëpërmjet këtyre veprave

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.



Abdyl Frashëri, frymëzuesi dhe kryetari i parë i Lidhjes së Prizrenit.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

popullin dhe intelektualët europianë u njohën pak a shumë me një kaptiull të rëndësishëm të historisë së Shqipërisë, e cila ahere për shumë diplomatë europianë ish vetëm një "shprehje gjeografike".

As synimet e Ali Pashë Tepelenës nuk gjetën përkrahjen e fuqive europiane dhe për këto arësye: 1) nga rivaliteti e ambicjet e pashallarëve shqiptarë e turq; 2). nga frika se duke shkatërruar Turqinë, mund të prishej balancimi i fuqive; 3) nga se Europa nuk donte të krijonte shtete me shumicën e popullsisë muslimane në Europë, e cila përkrahte haptazi çlirimin e Greqisë e jo të Shqipërisë.

LIDHJA E PRIZRENIT (1878)

Perandoria otomane kish filluar të kalbej në rrënjë, kurse Perandoria ruse po zgjerohej në kurriz të saj. Nga dëshira për liri dhe të shtyrë nga Rusia, sllavët e Ballkanit: bullgarët, serbët e malazeztë i shpallën luftë Turqisë më 1876, por kjo e pengoi Malin e Zi dhe theu keq serbët e bullgarët, të cilët nuk i trajtoi mirë pas humbjes. Rusia, si mbrojtëse e sllavëve. gjeti rast ta sulmonte Turqinë, të cilën e dërmoi. Në paqën që u nënshkrua në Shën Stefan, një lagje e Stambollit, Bullgaria u zgjerua aq shumë, sa kufitë e saj arrijtën gjer në Drinin e Zi, Pogradec e në Fushën e Korçës; serbëve i u dha një pjesë e madhe e Kosovës, kurse Malit të Zi i u lëshuan vendet shqiptare gjer në

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Bunë. Pas kësaj ndarje grekët kërkuan Epirin e Veriut duke përfshirë Janinën, kryeqytetin e atëhershëm të Shqipërisë.

Mirëpo Fuqitë e Mëdha si Anglia, Austro-Hungaria dhe Gjermania s'e shihnin me sy të mirë një zgjerim të tillë sllav në Ballkan, prandaj më 1878 u mblodhën në Berlin për ta shqyrtuar edhe një herë Traktatin e Shën Stefanit.

Shqiptarët, duke parë se Turqia po i shpërblente popujt sllavë me tokat e tyre, u mblodhën në Prizren më 10 qershor 1878 nën kryesinë e Abdyl Frashërit, pa dallim feje, krahine e klase dhe protestuan për copëtimin e atdheut që atëhere numëronte nja 2 milion frymë. Mbledhja u quajt "Lidhja e Prizrenit", tamam si ajo e Lezhës më 1444 nën Skënderbenë. Ajo krijoi komitete për mbrojtjen e Shqipërisë, në Shkodër, Dibër, Elbasan (qyteti ndërlidhës i veprimtarive të Lidhjes), në Gjirokastër, Janinë, Stamboll etj.; caktoi kryetarët e komiteteve dhe të ushtrisë shqiptare, i bëri një protestë të përbashkët Kuvendit të Berlinit dhe dërgoi grupin e saj përfaqësues nën kryesinë e Abdyl Frashërit në Romë, Paris, Vienë e Berlin që të kërkonin të drejtat e tyre. Mjerisht, pasi Turqia e mundur i përfaqësonte viset e copëtuara shqiptare, Kongresi i Berlinit s'u a mori parasysh kërkesat, dhe e urdhëroi Turqinë që t'u a lëshonte tokat shqiptare fqinjëve.

Turqit e lejuan në fillim hapjen e Lidhjes së Prizrenit, por shqiptarët duke parë se Porta s'po bënte asgjë për ta, kërkuan

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

autonominë e tyre me shkolla, gjyqe, administratë shqipe e ushtri shqiptare. Për t'i qetësuar dhe paralizuar shqiptarët, Sullтani dërgoi Mehmet Ali Pashën në Kosovë me disa reparte, por ai u vra në Gjakovë nga të besëlidhurit, dhe repartet e tija u shkatërruan fare. Më vonë Lidhja mori tërë Kosovën, pushtoi Shkupin dhe theu malazeztë në Plavë e Guci.

Pasi shqiptarët nuk po i bindeshin Turqisë, Fuqitë e Mëdha dërguan flotën e tyre të përbashkët në Tivar e Ulqin, por bijt e shqipes vijuan ta mbronin vendin e tyre me vendosmëri nga malazeztë, nga flota e aleatëve dhe nga turqit. Më në fund Sullтani dërgoi në Shqipëri Marshall Dervish Turgut Pashën, i cili me forcat e tija mori Shkupin, Prishtinën, Prizrenin-ku shkatërroi Lidhjen, Shkodrën, Ulqinin e Tivarin; ngrehi gjyqet ushtarake turke në këto vende dhe u dorëzoi tokat shqiptare fqinjëve sipas vendimeve të Berlinit. Kryetarët e Lidhjes u kapën e internuan në Anadoll. Abdyl Frashëri u dënua me vdekje, por pas pesë vjet burgimi u fal.

Historia e këtyre përpjekjeve shqiptare për vetëmbrojtje është subjekti i poemës epike të Lahutës së Malcisë së poetit kombëtar At Gjergj Fishta.

Sadoqë u shkatërrua, Lidhja e Prizrenit i zgjoi shqiptarët të mendojnë e të punojnë për pavarësinë e tyre, të vëllazëroheshin përpara rrezikut duke mos marrë parasysh ndarjet fetare, të

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

hudhnin themelet e rilindjes kombëtare dhe t'i a bënin Europës të dijtur se ka një komb shqiptar, me gjuhë, tradita e frymë të përbashkët që lufton për lirinë e vet.

SHQIPËRIA ETNIKE OSE E "ROBËRUAR"

Kemi parë se Kara Mahmud Pashë Bushati u vra në Malin e Zi të sotëm, i cili banohej e banohet nga një numër i konsiderueshëm shqiptarësh; se Ali Pashë Tepelena u vra nga turqit në Janinë, që ish kryeqyteti administrativ i Shqipërisë; se Lidhja e Prizrenit e pat selinë e vet në Prizren dhe e zhvilloi veprimtarinë më të madhe ushtarake në Kosovë. Nuk duhet harruar edhe se vendimi i patriotëve e gjuhëtarëve shqiptarë për të përdorur shkronjat latine në shkrimin e gjuhës shqipe qe marrë në Kongresin e Monastirit. Të tëra këto ngjarje e vende me rëndësi jetike për zgjimin e kombit shqiptar kanë ndodhur jashtë kufive të sotëm politikë. Në të vërtetë këto e kanë pregatitur drejtpërdrejt ose tërthorazi ngritjen e flamurit në Vlorë dhe shpalljen e pavarësisë. Është mu për këto arësye që shqiptarët i quajnë të padrejta vendimet e Fuqive të Mëdha përsa i përket copëtimit të Shqipërisë ndërmjet fqinjëve; prandaj ata i quajnë tokat e mbetura nën Jugosllavi e Greqi herë "Shqipëria Etnike", herë "Shqipëria e Robëruar".

Duke e marrë çështjen thjeshtë në pikëpamje gjuhe, mund të

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

thuhet se së paku dy të pestat e shqiptarëve kanë mbetur nën fqinj, kryesisht nën Jugosllavi (afër një milion sipas statistikave zyrtare jugosllave) dhe një pjesë tjetër më e vogël nën Greqi. Mjerisht nuk dihet numri i saktë i shqiptarëve të atjeshëm, pasi atyre as që u janë lejuar shkollat shqipe as që është dhënë ndonjë statistikë për ta nga ana e qeverisë greke.

Gjithënjë në lidhje me gjuhën shqipe, është për t'u theksuar se shqiptarët në Jugosllavi kanë shkollat e tyre shqipe nga fillorja gjer në universitet. Politikisht, krahina që ka shqiptarë të grumbulluar në shumicë absolute është Kosova, e njohur zyrtarisht nën emërin "Krahina Autonome Socialiste e Kosovës", pjesë e Republikës së Serbisë në kuadrin federativ jugosllav.

Kryeqendra e Kosovës është Prishtina (65.000 banorë). Qytete tjera me rëndësi janë: Prizreni, qytet historik e me arte të zhvilluara; Gjakova, qytet bujqësor e industrial; Peja, qytet klimaterik; Mitrovica, qytet industrial dhe Gjilani e Ferizaj ose Uroshevaci, qytete bujqësore. Dibra, Tetova, Gostivari etj. bëjnë pjesë në Republikën e Maqedonisë, kurse Ulqini, Tivari, Plava e Gucia, vende turistike e klimaterike, i përkasin Republikës së Malit të Zi.

Në Greqi, qytete e rrethe ku flitet shqipja janë Janina, Preveza, Kosturi, Filati etj.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.



Ismail Qemali shpall pavarësinë më 28 Nëndor 1912.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

SHPALLJA E PAVARËSISË

Kur filloi kryengritja e Turqve të Rinj dhe dobësimi i perandorisë turke, populli shqiptar kishte bërë shumë përpjekje dhe i kishte të zhvilluara ndjenjat kombëtare për liri, ashtu si tërë popujt e tjerë të Ballkanit. Në këto përpjekje, rolin më të rëndesishëm e luajti Ismail Qemal Vlora, i cili punoi me mjeshtëri të rrallë politike dhe kërkoi pranë Fuqive të Mëdha të Europës të drejtat e popullit shqiptar për liri dhe pamvarësi. Kështu, ai i kurorëzoi përpjekjet e shqiptarëve me çpalljen e Pamvarësisë dhe ngritjen e Flamurit më 28 Nëndor 1912 në Vlorë. Kjo ngjarje historike puthiti me programin e asaj kohe të Fuqive të Mëdha për të rregulluar një herë e mirë çështjet ballkanike. Prandaj, në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, më 29 korrik 1913 dhe sipas interesave të Fuqive të Mëdha, u vendos që Shqipëria të njihet si shtet i pamvarur dhe sovran, por mjerisht kufitë e saj, kufitë e Shqipërisë së sotme, u caktuan në një mënyrë të padrejtë dhe në dëm të popullit shqiptar. Në vendimet e kësaj konference thuhej edhe se, administrata dhe financa e këtij shteti të ri duhej të ishin nën drejtimin e këtyre fuqive; prandaj u vendos që në Shqipëri të dërgohej një mbret i huaj, gjerman, dhe pikërisht Princi Wilhelm Wied. Ky arriti në Durrës në mars të vitit 1914, por shqiptarët e detyruan pas pak muajsh të largohej, pa ushtruar pothuajse aspak detyrën e tij.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Lufta e Parë Botërore. Lufta e Parë Botërore, që filloi po në vitin 1914, i shkaktoi Shqipërisë një rrëmujë të re dhe vendi u pushtua përsëri nga pushtues të huaj, nga të dy palët luftuese. Kështu, më 1916 Shqipëria u bë shesh lufte ndërmjet ushtrive austro-hungareze nga njëra anë, dhe ushtrive italo-franceze e serbe nga tjatra. Gjatë luftës, pikërisht më 1915, në Londër, fuqitë aleate kishin nënshkruar një marrëveshje sekrete mbi çështjen shqiptare. Prandaj, në Konferencën e Paqës në Paris, 1919, çështja shqiptare paraqitej jashtëzakonisht e vështirë, për arësye të lakmive të fqinjve të Shqipërisë, Greqisë dhe Jugosllavisë, të cilët donin ta ndanin Shqipërinë më dysh. Sklavëria e re e Shqipërisë gati u pranua nga Fuqitë e Mëdha, por përkrahja e fortë e Presidentit Wilson dhe përpjekjet e vetë popullit shqiptar e shpëtuan edhe një herë këtë vend kaq shumë të sakrifikuar.

Kongresi i Lushnjës. Një nga këto përpjekje qe edhe Kongresi i Lushnjës që u mblodh më 21 janar 1920. Ky kongres përpiloi dhe i dorëzoi Konferencës së Paqës në Paris një memorandum, ku protestonte kundër copëtimit të Shqipërisë, duke kërkuar gjithashtu vullnetin e popullit për lirinë dhe pamvarësinë e Shqipërisë me kufitë e saj etnikë dhe të natyrshëm. Kongresi i Lushnjës formoi gjithashtu një qeveri me Sulejman Delvinën si kryeministër dhe

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

zgjodhi si autoritet më të lartë "Këshillin e Lartë", të formuar prej katër vetësh, një për çdo besim fetar.

Kjo qeveri filloi menjëherë të zotërojë situatën. Në këtë kohë Vlora ish ende e pushtuar nga Italia, por populli i atij qyteti dhe i rretheve hyri në luftë kundër ushtrisë italiane në qershor 1920, të cilën e dëboi nga toka shqiptare. Pas kësaj përleshje me armë, në gusht 1920 u arrit një marrëveshje me Italinë, e cila e njohu pamvarësinë dhe sovranitetin e Shqipërisë, por me kondite që të mbante nën sundim të saj ishullin e Sazanit (në perëndim të Vlorës). Ky ishull i u kthye përsëri Shqipërisë në bazë të traktatit të paqës nënshkruar me Italinë pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore.

Rilindja e Shtetit të Ri (1920-1939).

Në dhjetor të vitit 1920 Shqipëria u pranua si anëtare e Lidhjes së Kombeve, pasi dha prova të shkëlqyera se ishte në gjendje të vetqeveriset dhe të mbajë detyrimet ndërkombëtare. Mirëpo, gjer në këtë kohë Shqipëria nuk ishte njohur nga Fuqitë e Mëdha dhe kufitë e saj nuk ishin ende të caktuar ndërkombëtarish Prandaj, më 1921 Konferenca e Paqës muar në shqyrtim edhe një herë çështjen shqiptare duke i caktuar Shqipërisë kufitë e 1913-ës, sikurse kishte vendosur Konferenca e Ambasadorëve.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Pas Kongresit të Lushnjës, periudha që vete nga viti 1921 gjer më 1924, karakterizohet nga intriga dhe përleshje të të dy partive kryesore në parlamentin shqiptar, për të marrë në dorë drejtimin e shtetit të ri. Kështu, nga viti 1922 gjer në qershor të vitit 1924 është partia popullore e Ahmet Zogut në fuqi; në këtë muaj e merr fuqinë partia e opozitës e Peshkop Fan Nolit dhe Zogu detyrohet të largohet në Jugosllavi. Në dhjetor po të këtij viti, Zogu u kthye nga Jugosllavia dhe me forca ushtarake marshoi mbi Tiranë, duke detyruar Nolin të largohet nga Shqipëria. Në janar të vitit 1925 Shqipëria u çpall republikë dhe Zogu u zgjodh President; më 1 shtator 1928 u çpall mbretëri dhe Zogu muar titullin Zog I, "Mbret i Shqiptarëvet." Kjo periudhë vazhdoi gjer më 7 prill 1939, datë në të cilën Italia fashiste pushtoi Shqipërinë.

Gjatë sundimit të Zogut si president dhe si mbret, nga viti 1925 e gjer më 1939, Shqipëria bëri përparime të konsiderueshme. Njësimi i vendit rreth një qeverie qendrore, futja shkallë-shkallë e parimeve të botës perëndimore dhe sidomos përpjekja dhe patriotizmi i vetë popullit shqiptar, solli përmirësime të mëdha në shumë pjesë të jetës kombëtare. Kështu, sistemi administrativ turk filloi të zëvendësohej me sisteme moderne; hynë në fuqi kodet e rinj civil, penal dhe tregëtar. Përparimin më të madh, gjatë kësaj kohe, Shqipëria e ka bërë në fushën e arësimit:

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

programi shkollor, i kopjuar nga programi zviceran, francez dhe austriak, i bëri shkollat shqiptare, fillore dhe të mesme, të barazohen me më të mirat e Europës. Për një kohë të gjatë u lejuan edhe shkolla me programe të huaja, nga të cilat më të mirat kanë qenë: Shkolla Teknike në Tiranë me program amerikan dhe Liceu i Korçës në Korçë me program francez. Përveç të tjerave, kjo periudhë mund të quhet kohë paqe dhe rimbëkëmbje për popullin shqiptar.

Invadimi italian dhe Lufta e Dytë Botërore (1939-1944).

Më 25 mars 1939 qeveria italiane dërgoi në Shqipëri një përfaqësi, e cila kërkoi që Shqipëria të bëhej një protektorat i Italisë. Vetë Konti Çiano, ahere Ministër i Jashtëm i Italisë, ka shkruar në autobiografinë e tij se "ky hap i Italisë s'ishte tjatër veçse një dhunim i sovranitetit dhe i pamvarësisë së Shqipërisë". I tërë populli qe me Mbretin Zog, që ky t'i qëndronte me armë invadimit italian. Më 7 prill, ditën e së Premtes së Zezë, anije luftarake të Italisë fashiste filluan të bombardojnë bregdetin dhe, megjithëse gjetën rezistencë, zbarkuan në shumë vende: Durrës, Vlorë, Sarandë e Shkodër nga ku pushtuan vendin. Italia e justifikoi këtë invadim se gjoja dëshironte vetëm të vendoste rregull dhe të mbante qetësi në Shqipëri. Zogu qe larguar nga Shqipëria një ditë më parë.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Italia fashiste tregoi, që në tri ditët e para, se çfarë "rregulli të ri" dëshironte të vendoste: detyroi Parlamentin të formonte një qeveri me Kryeministër Shefqet Vërlacin, që ishte një kundërshtar i Zogut, të rrëzojë Kushtetutën e 1928-ës dhe t'i ofrojë kurorën e Mbretërisë Viktor Emanuelit III, Mbret i Italisë; vendosi në Shqipëri një zëvendës mbreti, Jacomoni-n, i cili më parë ishte Ambasador i Italisë në Tiranë; themeloi një parti fashiste shqiptare, e ndërroi Parlamentin në "Këshill Korporativ Fashist", zhduku Ministrinë e Jashtme dhe i ngjiti Flamurit shqiptar dy emblema të Liktorit.

Qëllimi kryesor i pushtimit të Shqipërisë ka qenë që Italia të kontrollonte Adriatikun me anë të Kanalit të Otranto-s dhe të kishte në Ballkan një fushë të lirë veprimi për sulmet e ardhshme. Dhe me të vërtetë, në tetor të vitit 1940 Italia sulmoi Greqinë nga kufitë e Shqipërisë. Në luftën kundër Greqisë, Italia përdori edhe trupa shqiptare, të cilat ja u tërhoqën nga fronti ose hodhën nga ana greke që në ditët e para të luftës. Vetë gjenerali Badoglio ka shkruar në raportet e tija se dezertimi i trupáve shqiptare e shkatërroi krejt frontin. Dihet se italianët u thyen dhe grekët pushtuan një të katërtën e Shqipërisë, gjer sa Italia kërkoi ndihmën e Gjermanisë, e cila, duke sulmuar nga Jugosllavia, shkatërroi në pak ditë ushtrinë greke. Pas këtij përfundimi, Italia i bashkoi "Mbretërisë së Shqipërisë" Kosovën

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

dhe një pjesë të Çamërisë, dy krahina thjeshtë shqiptare të lëna jashtë kufive nga Konferenca e Ambasadorëve më 1913. Pas kësaj ngjarje Italia dhe Gjermania propagandonin se më së fundi Shqipëria i kishte siguruar kufitë e saj etnikë.

Qëndresa dhe krijimi i P.K.SH. Por, me gjithë padrejtësitë që i ishin bërë Shqipërisë më 1913, populli shqiptar nuk u bë me kauzën e Fuqive të Aksit, por u hodh në rezistencë dhe formoi dy organizata: Ballin Kombëtar, një organizatë patriotësh nacionalistë, dhe pas hyrjes së Rusisë në luftë, Këshillin Nacional Çlirimtar, nën emrin e së cilës fshihej partia komuniste.

Shumë vjet para Luftës së Dytë Botërore ekzistonin në Shqipëri disa grupe komunistësh, më i madhi i të cilëve ka qenë grupi i Korçës. Anëtarët e këtij grupi ishin punëtorë dhe formonin një shoqëri që quhej "Puna". Anëtar i kësaj shoqërie ka qenë edhe Enver Hoxha, Sekretari i sotëm i Partisë Komuniste Shqiptare. Nga grupet e vogla ata bënë një parti komuniste të njohur nga Moska; në muajin tetor 1941 u formua i pari Komitet Qendror, me anëtarë, ndër të tjerë, Enver Hoxhën dhe Koçi Xoxën.

Ishte e natyrshme që kjo parti e re të mvarej nga Partia Komuniste Jugosllave; dhe në të vërtetë qe një degë e saj. Emisarët jugosllavë qëndruan në Shqipëri gjatë tërë luftës dhe kryetarët e vërtetë të saj qenë: Miladin Popović-i si organizator politik dhe Dushan Mugosha, i njohur me mbiemërin Salë si organizator ushtarak. Pasi u themelua Partia Komuniste Shqiptare,

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

lëshoi shumë qarkore; bëri gjithashtu hapat e para drejt formimit të celulave, përbërë kryesisht nga punëtorë dhe fshatarë. Puna e saj ideologjike dhe politike ka qenë e bazuar në punimet e marksizëm-leninizmit; natyrisht, propaganda e parë sillej rreth popullarizimit të Bashkimit Sovjetik dhe sidomos rreth faktit se gjoja Rusia luante rolin kryesor në luftën kundër fashizmit. Partia i mësoi popullit si të kryejë akte sabotimi, të bëjë demonstrata dhe greva.

Konferenca e Pezës (shtator 1942). Duhet shënuar se gjatë luftës komunistët përmendnin emrin "Parti" dhe asnjë herë fjalën "Komuniste"; atyre u duhej përkrahja e popullit, por populli shqiptar nuk mund të bashkohej me komunizëm. Përdorën prandaj një manevër që kishte pasur shumë sukses në shtetet fqinj. Në shtator të vitit 1942 komunistët organizuan në Pezë një konferencë, në të cilën ftuan komunistë, jo-komunistë që ishin përgjithësisht në favor të Partisë dhe disa nacionalistë. Megjithëqë pothuaj të tërë vajtën si individë, komunistë u munduan t'u a veshin atyre rolin e përfaqësuesve të popullit, sepse, siç dihet, qëllimi kryesor i tyre ishte ta quanin këtë konferencë si një bashkim të nacionalistëve me komunistët. Në këtë konferencë, përveç Abaz Kupit (Monarkist), që përfaqësonte disa çeta, të cilat s'kishin hyrë ende në luftë, asnjë nga të ftuarit nuk përfaqësonte ndonjë grup ose krahinë.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Në konferencë komunistët, me fjalimet e tyre, shtrembëruan tërë historinë e Shqipërisë. Përsa u përket përpjekjeve patriotike të Rilindjes Kombëtare ata thanë se ishin lëvizje komuniste; përsa i përket luftës kundër gjermano-italianëve, në fjalimin e tij Enver Hoxha dalloi dy grupe luftuese: çetat partizane dhe çetat vullnetare. Ai propozoi që të parat të kishin si shenjë dalluese Flamurin e Shqipërisë me një yll të kuq dhe të dytat vetëm Flamurin. Ai nënkuptonte se çetat partizane duhej të ishin komuniste dhe ato vullnetare, nacionaliste. Të dy këto grupe çetash duhej të formonin Lëvizjen Nacional Çlirimtare. Në Këshillin Nacional Çlirimtar, që do të drejtonte luftën kundër pushtuesve, Enver Hoxha propozoi katër komunistë, një simpatizues dhe dy nacionalistë, që të dy në favor të komunistëve (një ndër këta të dy ishte edhe Abaz Kupi). Në një rregullim të tillë të këshillit, ishte e natyrshme që Partia Komuniste Shqiptare do do ta kishte në dorë krejt drejtimin e lëvizjes së rezistencës.

Nacionalistët shqiptarë në Konferencën e Pezës u kujtuan se kishin rënë në grackë dhe nuk e nënshkruan çpalljen e krijimit të Lëvizjes Nacional Çlirimtare. Me gjithë atë, komunistët vazhduan t'i thonë popullit se bashkimi midis tyre dhe komunistëve ishte "çementuar" dhe se së bashku do ta luftonin pushtuesin. Ndër qytete nuk u muar vesh se ç'kishte ngjarë, por edhe ndër fshatra propaganda komuniste nuk eci ashtu siç deshën ata.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Sidoqoftë, me krijimin e L.N.Ç., komunistët patën një përfitim të madh: me titullin e ri ata e zhdukën fjalën "komuniste", kështu që ata mund të pregatisnin luftën e tyre revolucionare nën maskën e një revolucioni nacionalist.

Pas Konferencës së Pezës, komunistët e shumëzuan aktivitetin e tyre: shtuan numrin e çetave (që mbanin emrin "Çetat e L.N.Ç.), vendosën Këshilla N.Ç. në vendet e çliruara dhe mblodhën ushqime e mjete tjera. Vendet-kyç i kishin përherë komunistët.

Balli Kombëtar (1942). Megjithëse nacionalistët ishin kujtuar me kohë për grackën që po ngrehnin komunistët, vetëm pas Konferencës së Pezës dolli në shesh Balli Kombëtar, udhëhequr nga Mid-hat Frashëri. Ky, një patriot demokrat i vjetër, kishte formuar, që nga ditët e para të pushtimit italian, një lëvizje rezistence të fshehtë Anëtarët e Ballit Kombëtar ishin të rekrutuar nga të tëra radhët, përveç atyre komuniste. Kryetarët e kësaj organizate ishin të mirënjohur si patriotë.

Balli Kombëtar mori menjëherë një hov të madh dhe komunistët, gjatë tërë kohës që nuk e ndjenin vehten të fortë, u munduan të fitojnë përkrahjen e Ballit Kombëtar, por kurrë nuk dëshiruan një marrëveshtje të sinqertë me të. Qëllimi i komunistëve nuk ishte aq shumë lufta kundër pushtuesit, por kontrolli i vendit dhe Balli Kombëtar paraqitej për ta si armiku numër 1; prandaj duhej zhdukur. Për këtë arësye, tamam kur të dy palët filluan

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

bisedimet për një bashkëpunim ushtarak, komunistët përdorën të tëra mjetet, me propagandë e çpifje, për të minuar pozitat e Ballit Kombëtar.

Konferenca e Mukajt (2 gusht 1943). Kur zbarkuan Aleatët në Siqili, u fillua seriozisht të vendoset një bashkëpunim ndërmjet Ballit Kombëtar dhe L.N.Ç. (partia komuniste). Arësyet që e shtynë Ballin Kombëtar dhe L.N.Ç. të fillojnë bisedime për një marrëveshje kanë qenë: së pari, opinioni publik, që nuk shihte me sy të mirë dy fronte të ndryshme kundër një okupatori; së dyti, shtytja e Misionit Ushtarak Britanik, që kishte ardhur në Shqipëri disa muaj më parë, dhe, së treti, mundësia që Shqipëria të bëhej një zonë për operacione të Aleatëve. Pra, më 2 gusht 1943, përfaqësues të të dy organizatave u mblodhën në Mukaj, një fshat afër Tiranës. Diskutimet qenë të gjata dhe të nxehta. Me kompromise nga të dy palët u arrit në një marrëveshje për një komitet të përbashkët, që kishte pamjen e një qeverie revolucionare dhe u quajt "Komiteti për Shpëtimin e Shqipërisë".

Konferenca e Labinotit (13 tetor 1943). Me gjithë atë, marrëveshja e Mukajt nuk pat asnjë vleftë, veçse si një dokument. Ja arësyet e dështimit të kësaj marrëveshje, dështim që cakton fillim e vëllavrasjes në Shqipëri: Emisarët jugosllavë, "padronët" e Partisë Komuniste Shqiptare, më 13 tetor 1943

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

shkruanin kështu: "Shokët delegatë kanë rënë në Mukaj në pozitat e nacionalistëve dhe, duke bërë oportunizëm, ata mund të kënaqeshin atje vetëm duke shkëmbyer me nacionalistët ndonjë fjalë osè fjalí. Në atë kohë shoku Tempo (Vukmanović-Tempo, figura kryesore e komunizmit jugosllav në Maqedoni) ka qenë atje (në Shqipëri). Ne e biseduam dhe e studjuam, së bashku me K.Q., tërë çështjen, situatën etj. dhe vendosëm që ta hedhim poshtë deklaratën (manifestin) dhe të mos njohim mënyrën në të cilën u organizua Komiteti për Shpëtimin e Shqipërisë, si edhe funksionet e tija si autoritet suprem në luftën për çlirimin kombëtar".[1]

Në direktivat sekrete që K.Q. i P.K.Sh. u dërgonte komiteteve krahinore në shtator të vitit 1943, thuhej: "Ju e dini se marrëveshja me B.K. ka qenë në dëm të L.N.Ç. dhe të Partisë sonë dhe si e tillë nuk u pranua nga K.Q.".[2]

Në shtator të 1943-ës komunistët shqiptarë, gjithënjë sipas urdhërave të eprorëve jugosllavë, u hodhën haptazi kundër Ballit Kombëtar. Me këtë rasë, K.Q. i. P.K.Sh. dha këto direktiva: "Të jini të pamëshirshëm në diskreditimin e B.K. në popull, në ndarjen e popullit nga ai, në mënyrë që populli të bashkohet me ne..,ta paraqitni B.K. si shkaktar të përçarjes dhe nxitës të

---

1. V. Dedier, Marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë e Jugosllavisë nga 1939-1948, (1949), f. 89.
2. idem, f. 90.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

luftës vëllavrasëse; ta bëni popullin të besojë se politika e B.K. do të na dëmtojë në luftën e armatosur kundër armikut, ta bëni tërë popullin të hidhet kundër tij, sepse në këtë mënyrë përgjegjësia historike e përçarjes së popullit shqiptar dhe dëmtimi i luftës kundër armikut do të bjerë mbi B.K.".[3]

Në luftën vëllavrasëse që vijoi, terrori qe arma më e përdorur nga komunistët. Së pari, ata sulmonin me qëllim forcat gjermane afër, krejt afër fshatrave, kështu që këta t'i digjnin dhe t'i vrisnin banorët ose të ishin të detyruar të zmadhonin radhët e komunistëvet në mal; pastaj, me çpifje të sendërgjuara mirë, i a hidhnin fajin Ballit Kombëtar.

Kongresi i Përmetit. Sulmi që gjermanët u bënë komunistëve në dimrin e vitit 1943-1944 qe shumë i fortë dhe forcat komuniste u dobësuan shumë, por gjermanët nuk synonin në këtë: ata donin që t'i kishin krahët të siguruar në tërheqjen e tyre nga Shqipëria. Pasi u rimbëkëmbën, forcat e L.N.Ç. u mblodhën në Përmet, më 1944 dhe formuan Këshillin Antifashist Nacional Çlirimtar, që ishte një organ suprem legjislativ dhe ekzekutiv, si edhe Komitetin Antifashist Nacional Çlirimtar, që ishte një qeveri e përkohshme. Edhe në këtë rast, Partia Komuniste nuk e hoqi maskën për të dalur haptazi në shesh. Me gjithë atë, dy gjëra të kundërta u

---

3. Enver Hoxha, Vepra I, (Shtëpia Botonjesë "Naim Frashëri", Tiranë, 1968), f. 375.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

thanë në deklaratën e Kongresit të Përmetit: nga njëra anë u tha se në Frontin Nacional Çlirimtar nuk kishte ndonjë parti ose grup dominues; n'anën tjatër u përmend se Partia Komuniste i a kishte treguar popullit rrugën e çlirimit dhe kishte marrë në dorë drejtimin e tij.

Në qershor të vitit 1944 gjermanët dërguan nga Greqia në Shqipëri Divizionin e Parë Malor, një nga njësitë më të mira që kishin, por sulmi i tyre nuk i shkatërroi dot partizanët. Aty nga faza e fundit e luftës, komunistët, që ishin të sigurtë se do ta merrnin fuqinë në dorë, u mblodhën në Berat më 22 tetor 1944 dhe e ndërruan Komitetin Antifashist Nacional Çlirimtar në Qeveri Demokratike të Shqipërisë. Enver Hoxha, që disa kohë më parë ishte emëruar Komandant i Ushtrisë me gradën Gjeneral-Kolonel, u zgjodh Kryeministër.

Qëllimi kryesor i Partisë Komuniste ishte të asgjësonte kudo të tëra pengesat në të cilat ndeshej politika e saj. Në Shqipëri një gjë e tillë nuk qe e vështirë: Balli Kombëtar pat qenë eliminuar si opozitë, së pari sepse pat përçarje në gjirin e tij; së dyti, sepse F.N.Ç. gëzonte simpatinë e radiove të huaja, në radhë të parë të radiove aleate si dhe furnizimin me material lufte nga aleatët. Nga ana tjatër, Shqipëria nuk kishte një qeveri në mërgim, ashtu siç e kishte Greqia dhe Jugosllavia dhe s'kishte asnjë njësi aleate brenda në Shqipëri. Veç të

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

tjerave, L.N.Ç. kishte ndihmën e forcave komuniste të Tito-s dhe të E.A.M.-it grek. Kështu pra, kur u tërhoqën gjermanët, qeveria e formuar në Berat u vendos në Tiranë më 29 nëndor 1944 si qeveri e Shqipërisë me Enver Hoxhën Kryeministër.

Qëndrimi aleat gjatë Luftës së Dytë Botërore. Gjatë luftës, për një kohë të gjatë, nga ana e Aleatëve nuk ishte thënë asgjë përsa i përket Shqipërisë; qe Amerika ajo që nuk e kishte njohur as aneksimin e Shqipërisë nga Mbretëria Italiane dhe që theu heshtjen. Më 10 dhjetor 1942, Sekretari i Shtetit aso kohe, Cordell Hull, deklaroi se, në bazë të parimeve të Kartës së Atlantikut, Shtetet e Bashkuara të Amerikës do ta shihnin me sy të mirë një Shqipëri të çliruar, të qeverisur vetë dhe me të drejta sovrane. Një deklaratë e tillë i a ngriti moralin popullit shqiptar, që ishte duke kryer detyrën e vet në luftë kundër pushtuesit.

Deklarata amerikane u ndoq edhe nga ajo e Ministrit të Jashtëm të Britanisë së Madhe, Anthony Eden, por deklarata e tij shtonte edhe se kufitë e Shqipërisë duheshin studjuar edhe një herë pas lufte, me marrëveshtje direkte në mes Shqipërisë dhe fqinjvet të saj.

Përsa i përket Rusisë, dihet, në mënyrë jo zyrtare, se politika e Moskës ishte për një federatë ballkanike. Në dhjetor të vitit 1942, ashtu si Amerika e Anglia, edhe Bashkimi Sovjetik

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

bëri një deklaratë, ku thuhej se qeveria sovjetike e shihte me sy të mirë luftën që ishin duke bërë patriotët shqiptarë kundër forcave italiane, dhe se dëshironte të shihte një Shqipëri të pamvarur. Komunistët i bënë propagandë të madhe kësaj deklarate të Molotov-it. Megjithëse Lëvizjes Nacional-Çlirimtare ndihma i vinte nga Anglia dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, komunistët çfaqën, gjatë gjithë kohës, mirënjohje vetëm ndaj Bashkimit Sovjetik; ja një shembull nga deklarata e Kongresit të Përmetit, më 1943: "Lufta heroike e ushtrisë së lavdishme sovjetike, e udhëhequr nga strategjia e gjeniut Stalin, vuri me shpatulla në mur fuqitë kryesore të Hitler-it dhe të satelitëve të tij të frontit perëndimor, shkatërroi forcat e fashizmit dhe bëri të mundur lëvizjen e popujve të shtypur. Kjo është ndihma më e madhe që i është dhënë popullit tonë gjatë tërë historisë së tij. Për këtë ndihmë populli ynë do t'i jetë mirënjohës Bashkimit Sovjetik".[4]

Ngjarjet e mëpastajme nuk i sollën Shqipërisë veçse skllavëri.

Nën sundimin komunist (1944 gjer sot).

Pasi e mori fuqinë në dorë, qeveria e Enver Hoxhës përdori çdo mjet për ta forcuar pozitën e saj: së pari, filloi ta sheshojë

---

4. Enver Hoxha, Vepra I, (Shtëpia Botonjesë "Naim Frashëri", Tiranë, 1968), f. 442.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

rrugën nga çdo pengesë. Të tërë kundërshtarët, një pas një u dërguan para "gjyqeve të popullit" për t'u gjykuar si "kriminelë lufte" ose "armiq të popullit". Qeveria synonte, gjoja, të dënonte ata që kishin bashkëpunuar me armikun, por qëllimi i vërtetë ishte që të çdukte të tërë ata njerëz që kishin një farë influence në popull dhe që mund të pengonin forcimin e regjimit komunist. Sepse, dihet që shumë bashkëpunëtorë të armikut, për të cilët komunistët kishin nevojë në përmbushjen e qëllimeve të tyre, i zgjidhën nga çdo mëkat dhe gëzonin mbrojtjen dhe besimin e qeverisë, si p.sh. Behar Shtylla, ish anëtar i rinisë fashiste, Omer Nishani ish funksionar i lartë dhe përkrahës i pushtimit italian etj. etj. Natyrisht, edhe luftën kundër çetave anti-komuniste, që qëndronin ende ndër male, qeveria nuk e kishte lënë pas dore; çdukja e këtyre çetave nuk qe aq e vështirë për qeverinë, sepse, së pari, kufitë ishin të mbyllur, dhe së dyti, fqinjët e përkrahnin qeverinë komuniste. Prandaj, në Shqipëri çdo rezistencë ishte destinuar të dështonte.

Fronti Nacional Çlirimtar (që më parë quhej L.N.Ç.) e kishte kryer pjesën më të madhe të punës: tani, konditat e reja kërkonin që L.N.Ç. të quhej Front Demokratik. Enver Hoxha dhe komunistët më përgjegjës, me fjalime të ndryshme, premtuan se fronti i ri do të përmblidhte të tëra rrymat e opinionit politik. Nuk kaloi shumë kohë dhe u pa qartas se krijimi i këtij Fronti

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Demokratik nuk qe tjatër veçse një grackë; shumë anëtarë të F.D., të cilët dëshironin sinqerisht demokratizimin e Shqipërisë, u arrestuan dhe u dënuan me akuzën se komplotonin kundër regjimit. (p.sh. Dr. Gjergj Kokoshi, i pari ministër Arësimi në qeverinë komuniste).

Partia komuniste, përsa i përket demokracisë, ishte e interesuar që demokracia të kishte vetëm dukjen, vetëm pamjen e jashtme. Dy ishin qëllimet e saja: nga brenda, t'i epte popullit të besonte se Partia ishte gati të bashkëpunonte me tërë elementët demokratë dhe të ndershëm të vendit; nga jashtë, t'i a mbushte mendjen botës se qeveria e re shqiptare ishte "demokratike", dhe për konsekuencë, të njihej nga Aleatët zyrtarisht.

Zgjedhjet. Për njohjen e Shqipërisë Amerika dhe Anglia patën vënë si kusht, më 1945, që të bëheshin zgjedhje të lira. Për t'u dukur se gjoja zgjedhjet bëheshin të lira, qeveria vuri edhe kutinë e votave për opozitën; mirëpo opozitë nuk ekzistonte; ekzistonin vetëm dy kandidatë indipendentë, ndër të cilët njëri, i kërcëmuar me vdekje, u tërhoq një ditë para se të bëheshin zgjedhjet (2 dhjetor 1945). Posa që opozitë nuk ekzistonte, për shkak të terrorit të ushtruar vazhdimisht, ishte e natyrshme që të triumfonte Fronti Demokratik, kjo maskë e re e kohës së paqës e partisë komuniste. Pra, siç parashihej zyrtarisht, kandidatët e Frontit fituan me 93% të votave.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Asambleja që doli nga këto votime u mblodh në Tiranë më 10 janar 1946, rrëzoi monarkinë e mëparshme dhe e çpalli Shqipërinë Republikë Demokratike Popullore, ashtu siç kishte bërë më parë Jugosllavia duke ndjekur shembullin sovjetik.

Fronti Demokratik vijoi, ashtu siç vazhdon edhe sot, të jetë në shërbim të komunistëve shqiptarë, të grumbulluar tani në Partinë e Punës (partia komuniste). Detyra e sotme që ka F.D. është të paraqesë kandidatë për zgjedhje lokale dhe kombëtare; nuk është e lejuar paraqitja e asnjë liste tjatër përveç asaj të F.D. Pra, vetëm rreth emrave që janë në këtë listë mund të zhvillohet fushata elektorale.

Reforma agrare. Ekonomia e Shqipërisë bazohet kryesisht në bujqësi. Duke dashur gjoja ta bëjë fshatarin pronar të tokës së tij, qeveria komuniste bëri ligjin mbi reformën agrare (1945-46). Kjo lloj reforme ka qenë propaganduar edhe gjatë periudhës së rezistencës. Pra, qeveria konfiskoi të tëra tokat e pronarëve të ndryshëm dhe i ndau këto në bazë të ligjëve të reformës agrare të vitit 1945-46. Secilit bujk me një familje prej 5 vetësh i u dhanë për punim 5 ha. tokë (afërsisht 12.35 acres) dhe 1/2 ha. për çdo pjesëtar të familjes prej më shumë se 5 vetësh. Bujkut i u caktua edhe një sasi e përhershme prodhimesh që duhej t'i dorëzonte Shtetit; nga prodhimet i u lejua që të mbante vetëm një sasi të vogël, krejt të pamjaftushme për jetesën e pjesëtarëve

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

të familjes së vet. Më vonë u vu në zbatim kolektivizimi i tokave dhe në një kohë të dytë edhe kolektivizimi i deleve dhe i dhive të malësorëve. Tani vonë--1970--ca gazetarë të huaj që kanë vizituar Shqipërinë, kanë shkruar se çdo anëtar kooperative ka një parcelë private prej një dynymi (1000 m2), sasi e cila mund të shtohet gjer në tre dynym po qe se familja është e madhe. Sidoqoftë, gjendja e bujqve të Shqipërisë nuk ka qenë kurrë më e vajtueshme se sot. Në Shqipëri, në të kaluarën, çifligarët e mëdhenj kanë qenë fare të pakët; pjesa më e madhe e tokave ishte pronë e bujqve vetë. Prandaj, reforma agrare e komunistëve jo vetëm u a ka marrë bujqve tokën që kishin pasur dhe dashur më parë, duke u imponuar gjithashtu detyrime të rënda kundrejt qeverisë, por i ka bërë edhe skllevër të shetit.

Punëdhënësi dhe Punëtori. Në çdo regjim komunist, tregëtarët janë të konsideruar parasitë dhe si të tillë duhet të çduken si klasë. Prandaj, pas kundërshtarëve të regjimit, thika u ra atyre. Me tregëtarët qeveria nuk u sualL ashtu si me pronarët e mëdhenj të tokave, d.m.th. nuk u a konfiskoi pasurinë, por u vuri një taksë aq të rëndë sa, edhe sikur ta shitnin tërë pasurinë që zotëronin, nuk do të kishte qenë e mundur t'i paguanin këto taksa. Dhe kështu ngjau; në këtë rast, qeveria jo vetëm që u a konfiskoi pasurinë, por i futi edhe në burg, me akuzë se sabotuan pagesën e taksave, familjet e tyre u nxorën nga shtëpia dhe u dërguan në fusha përqëndrimi me punë të detyruar.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Edhe industria u transformua. Fabrikat që ekzistonin para luftës u konfiskuan menjëherë; minierat dhe puset e vajgurit të Kuçovës (ky qytet i vogël quhet sot Qyteti Stalin), që ishin pronë e disa shoqërive italiane, i u dhanë qeverisë shqiptare nga Komisioni Aleat i Paqës me Italinë. Dhe së fundi, çdo mjet që u klasifikua si "mjet prodhimi" u bë pronë e shtetit.

E drejta e punës, e punës që dëshiron të bëjë punëtori, dhe e pagesës, siç janë të përshkruara në art. 23-25 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, nuk janë marrë aspak parasysh. Në Shqipëri puna është e rregulluar sipas një rregulloreje të gjymtë të Bashkimeve Profesionale (sindikatave) të formuara dhe të drejtuara nga vetë shteti.

Më 28 tetor 1945 u krijua Bashkimi i Përgjithshëm i Sindikatave, që përfshinte tërë punëtorët dhe nëpunësit civilë. Më 1949 u bënë ndryshime për të vajtur paralel me strukturën organizative të sindikatave të Bashkimit Sovjetik dhe organizata e re u quajt Bashkimet Profesionale të Shqipërisë. Pas katër vjetësh, bashkimet e ndryshme profesionale u ndanë në tri federata: Bashkimi Profesional i Punëtorëve të Industrisë dhe Ndërtimit, Bashkimi Profesional i Arësimit dhe Mjeshtrive dhe Bashkimi Profesional i Punëtorëve të Bujqësisë dhe Grumbullimeve. Shuma e anëtarëve më 1953 ishte 88.105 punëtorë e nëpunës. Lëvizja e punëtorëve në Shqipëri, natyrisht pas luftës, ka qenë

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

gjithënjë nën kontrollin e Partisë Komuniste dhe e përdorur si masë e popullit për qëllimet e saja politike, ideologjike, ekonomike dhe kulturale.

Në gjirin e Bashkimeve Profesionale, që në vitin 1952 numëronte 17.049 vetë, përgjithësisht të rinjtë, ushtrojnë një rjetë aktivitetesh: kontrollojnë dhe mbikëqyrin punën në organizatat lokale, nxitin punëtorët në mënyrë që këta të përmbushin normat dhe t'i tejkalojnë ato, si edhe që ta përmirësojnë edhe më tepër edukatën politike dhe ideologjike të punëtorëve.

Marrëdhëniet e punës. Shpejt pas ardhjes së komunistëve në fuqi u legalizua edhe puna e detyrueshme. Më 15 dhjetor 1944, tërë punëtorët e specializuar, duke përmbledhur edhe mjekët, inxhinjerët etj. u deklaruan të mobilizuar nga shteti; tre muaj më vonë, një ligjë tjatër përfshinte, si të mobilizuar nga shteti, edhe ata që shërbenin, përkohësisht ose definitivisht, në zyra publike ose shtetërore. Ligjë tjera u dekretuan edhe më vonë, për të detyruar punëtorët të qëndrojnë në punën që kanë; kështu p.sh. art. 202 i Kodit Penal të Shqipërisë, dekretuar më 1 shtator të vitit 1952, thotë se "mungesa e punëtorit ose e nëpunësit civil në punë pa arësye të justifikueshme dënohet me një minimum prej 6 muajsh me punë të detyruar".

Kodi i Punës garanton 8 orë punë në ditë, i ndalon fëmijët nën 14 vjeç të punojnë dhe i klasifikon punëtorët sipas

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

specialitetit që kanë, por mjerisht garancira të tilla mbeten të shkruara vetëm në letër. Të tëra ndërtimet e bëra nga shteti, duke përfshirë vijat hekurudhore, tharjen e kënetave, hapjen e kanaleve, rrugëve etj. janë kryer nga punëtorë të dënuar me punë të detyrueshme nga Kodi Penal, dhe nga disa brigada punëtorësh të ashtuquajtura "brigada vullnetare", përbërë nga djem dhe vajza nga 12 gjer 25 vjeç. Edhe 8 orët e punës në ditë nuk respektohen; dihet se norma është e detyrueshme pothuajse në të tëra ndërmarrjet industriale dhe norma është e atillë që punëtori, për ta plotësuar, duhet të punojë 10-12 orë në ditë. Por ka edhe më shumë: punëtori është i detyruar me urdhër ta tejkalojë normën dhe prandaj duhet të punojë "vullnetarisht" jashtë orarit, d.m.th. të djelën dhe në ditë feste.

Me shkrim ekzistojnë edhe kontrata kolektive, të cilat i sigurojnë punëtorit një pagesë sipas zotësisë dhe që e venë atë në gjendje të kontraktojë me punëdhënësin, por në realitet, këto kontrata janë të lidhura në mes qeverisë dhe sindikatave të kontrolluara po prej qeverisë, të cilat nuk i sigurojnë punëtorit veçse detyrime, në mënyrë që t'i garantojnë shtetit plotësimin e planit të tij ekonomik.

Arësimi. Një ndër kujdeset e para të qeverisë komuniste, që kur e mori fuqinë në dorë, ka qenë riorganizimi i arësimit. Ministri i atëhershëm i Arësimit, Bedri Spahiu, shkruante kështu

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

më 1950: "Na u desh të luftojmë mbeturinat e kulturës borgjeze dhe t'u jipnim masave mjetet për përhapjen dhe zhvillimin e kulturës dhe të ideologjisë së re socialiste".

Më 24 mars 1946, Enver Hoxha, si kryetar i qeverisë, i njoftoi Kuvendit Popullor (Parlamentit) programin e reformave në lëmin e arësimit; në fjalimin e tij tha se qëllimi kryesor ishte të luftonte analfabetizmin. Mirëpo "lufta kundër analfabetizmit" nuk kishte kuptimin e zakonshëm, d.m.th. të ndriçojë popullin; regjimi komunist ishte i interesuar të sillte në çdo familje të Shqipërisë ideologjinë dhe parimet e Partisë, dhe leximi ishte ndër të parat mjete për të kryer këto qëllime.

Në Kongresin e Parë të Partisë Komuniste, më 1948, Enver Hoxha e bëri të qartë edukatën e ardhshme të Shqipërisë; ai tha: "Shkolla duhet t'u mësojë masave punonjëse idetë dhe parimet e Partisë, synimet dhe pikëpamjet e saja; ajo duhet të rrënjosë në to parimet e edukatës së re socialiste; duhet të edukojë fëmijët e të tëra shtresave të popullit në bazë të këtyre parimeve; shkolla duhet të luftojë kundër çdo ideologjie të huaj dhe kundër çdo influence të huaj që në rini".

Për cilëndo filozofi totalitare "rini" do të thotë pronë e shtetit dhe aq më tepër për filozofinë komuniste. Pra, shkolla duhet të shërbejë për ta rritur fëmijën nën kontrollin e shtetit dhe çdo fazë e shkollës duhet të jetë nën kontrollin e qeverisë.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Tekstet shkollore në shkollat e Shqipërisë janë të pregatitura në bazë të mësimeve të Leninit dhe Stalinit. Vetë direktivat e komunizmit shprehen në ligjët e reformës arësimore të vitit 1946 se tekstet shkollore duhet të përfshijnë, si parim themelor, ideologjinë komuniste. Në klasë duhet të theksohet fort çështja ideologjike në çdo mësim. Kur mësuesi i një shkolle të mesme pregatit planin e punës së tij, natyrisht në bazë të modelit të Ministrisë së Arësimit, ai duhet të përfshijë në këtë plan edhe një kolonë të veten, në të cilën të flasë për çështjen ideologjike duke e lidhur me temën e zhvilluar në klasë.

Çdo gjë që flitet në klasë është e lidhur me lëvizjen botërore të komunizmit. Gjer më 1960 Bashkimi Sovjetik konsiderohej si realizuesi i kauzës komuniste; tani si i tillë konsiderohet Kina e Kuqe. Prandaj çdo gjë e saj lartësohet dhe çdo gjë e botës perëndimore përbuzet ose lihet pas dore. Mësuesve u jepen gjithënjë mësime doktrinale; herë pas here ata ndjekin seminarë politikë. Qëllimi i Ministrisë së Arësimit është që mësuesit të ndjekin jo vetëm parimet dhe metodat e pedagogjisë sovjetike, por t'i bëjnë të vetat pikëpamjet e komunizmit radikal Mao-ist.

Rusifikimi. Para se të prishej Tito-ja me Kominformin, më 1948, arësimi shqiptar ishte i influencuar më shumë nga arësimi jugosllav. Gjuha serbo-kroate u bë e detyrueshme ndër shkolla dhe po nga kjo gjuhë u përkthyen shqip tekste shkollore; në

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Shqipëri erdhën gjithashtu mësues jugosllavë dhe studentë shqiptarë u dërguan në Jugosllavi për studime të larta. Pas prishjes së këtyre dy vendeve, në Shqipëri u adoptua sistemi arësimor sovjetik dhe gjuha ruse zëvendësoi serbo-kroatishten në shkollat e mesme. Një ndër seksionet e Institutit Pedagogjik ish dhe ai i Gjuhës dhe Letërsisë Sovjetike. Më 16 tetor 1950 Agjensia Telegrafike Shqiptare deklaroi se në Shqipëri ekzistonin 60 kurse të gjuhës ruse, natyrisht përveç atyre të shkollave të mesme e fillore, me 1484 punëtorë. Një tjatër shkollë e lartë për studimin e gjuhës ruse u inaugurua në Tiranë më 1953. Sipas statistikave të planit të parë pesëvjeçar, 900 studentë shqiptarë studionin në Rusi. Kur pat folur Hrushovi më 1959 rusisht në Universitetin Shtetëror të Tiranës, ai s'pati nevojë për përkthyes. Tani që Shqipëria është prishur me Bashkimin sovietik, përdorimi i gjuhës ruse është më i pakët.

Rinia. Kujdesi kryesor i regjimit të kuq i është kushtuar rinisë. Që në fillim, komunistët e shfrytëzuan entuziazmin dhe shpirtin e sakrificës që të rinjtë treguan kundër okupatorëve nazi-fashistë; gjatë luftës i organizuan mirë dhe sot mijëra të rinj gjenden në radhët e ushtrisë, jashtëzakonisht e madhe për nevojat e Shqipërisë, ose në radhët e organizatave të ndryshme.

Organizata e rinisë komuniste quhet Rinija e Punës e Shqipërisë, ashtu siç quhet edhe partia komuniste Partia e Punës

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

e Shqipërisë. Anëtarët rekrutohen nga të rinjtë nga 15-26 vjeç. Më 1952, anëtarët e Rinisë së Punës së Shqipërisë (R.P.Sh.) ishin gjithësejt 106.700 veta. Në bazë të statutit, detyra kryesore e anëtarëve është që të punojnë për edukatën e tyre ideologjike, të mësojnë parimet e marksizëm-leninizmit dhe t'i përhapin këto në masat e rinisë.

Përveç detyrës që të pregatisë anëtarët e ardhshëm të partisë, Rinija e Punës e Shqipërisë drejton të tëra organizatat e pionierëve, që përfshijnë fëmijët e të tëra shkollave të Shqipërisë, nga 7 gjer 14 vjeç, mbikëqyr në se politika dhe direktivat e partisë janë të ndjekura siç duhet nga të rinjtë, drejton 2000 kurse për edukatën ideologjike të tyre dhe, së fundi, rekruton të rinj "vullnetarë" për organizimin e brigadave të punës, për ndërtimet e ndryshme shtetërore. Vijat hekurudhore, rrugët, hidrocentralet, kanalizimet etj. janë vepra të deklaruara "aksione të rinisë". Dhe ashtu është: me mijëra djem dhe çupa kanë punuar ditë e natë, në kondita të tmershme, të veshur dhe të ushqyer keq, dhe shumë prej tyre kanë vdekur në punë e sipër.

Një propagandë e madhe qe zhvilluar që të rekrutonin sa më shumë të rinj për tharjen e Liqenit të Maliqit (1947-49) të Kënetës së Tërbufit (1960-66), për ndërtimin e hidrocentralit mbi Lumin e Matit 1950-55, të rafinerisë së vajgurit në Cërrik 1957-62 etj. Komunistët i japin rëndësi të madhe rekrutimit të vajzave,

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

sepse ata mendojnë se, duke i larguar çupat nga gjiri i familjes, mund t'i largojnë gjithashtu edhe nga "influenca reaksionare" e familjeve të tyre. Në qoftë se ndonjë vajzë refuzon të vejë si "vullnetare" në ndërtime të ndryshme, propagandistët i akuzojnë prindët; në të tilla raste ata shprehen kështu: "Vajzat dëshirojnë me tërë shpirt të ndërtojnë socializmin, por ju prindët jeni fajtorë që nuk i lejoni!". Shumë prindër janë hedhur në fusha përqëndrimi dhe janë detyruar të deklarojnë publikisht se nuk kanë asnjë kundërshtim që çupat e tyre të venë "vullnetare" në brigadat e punës, për ndërtimin e socializmit; por shumë të tjerë kanë pranuar pasojat e vështira të arrestimit, për të shpëtuar vajzat nga punët e rënda, nga largimi prej shtëpisë dhe natyrisht, për të mos i ekspozuar çupat, si kundërshtare të regjimit komunist.

Besimi. Para luftës, Shqipëria nuk ka pasur një besim zyrtar; të tëra besimet fetare (Muslimanizmi me tërë sektet e veta, Ortodoksia dhe Katolicizmi) kanë qenë respektuar dhe ushtrimi i tyre siguruar me ligjë.

Pas luftës, regjimi komunist ka ushtruar kundër besimeve fetare një nga terroret më të egra që ka njohur historia. Më 1949 u dekretua një ligjë që detyronte komunitetet e ndryshme fetare të betoheshin për besnikëri ndaj "fuqisë së popullit" dhe ndaj Republikës Popullore të Shqipërisë; po në këtë ligjë thuhej

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

se zgjedhja e kryetarit të çdo komuniteti duhej të aprovohej nga Këshilli i Ministrave.

Më 28 gusht 1949, Radio Tirana lajmëroi se Kryepeshkopi Ortodoks i Shqipërisë, Kristofor Kisi, ishte shkarkuar nga detyra e tij për arësye të "aktivitetit të tij fashist" dhe në vend të tij ishte emëruar Peshkopi i Korçës, Paisi Vodica. Dy javë më vonë, Kryepeshkopi i ri lajmëroi nënshtrimin e Kishës Ortodokse Shqiptare ndaj Kishës Patriarkale të Moskës. Më 5 shkurt 1950 u mblodh kongresi i parë i Kishës Ortodokse. Në bazë të rregullores së re, Kisha Ortodokse Shqiptare merrte përsipër që t'u predikonte besimtarëve të saj besnikëri kundrejt regjimit komunist.

Por sulmin më të tmershëm, që filloi në ditët e para të vitit 1946, qeveria i a rezervoi Kishës Katolike, gjoja vegël e verbër e Vatikanit. Një shumicë e madhe priftërinjësh, ndër ta edhe ca ipeshkvij, u sollën para gjyqit dhe u dënuan me vdekje ose me burgim të rëndë. Një ndër akuzat e pathemelta ishte se organizonin çeta antikomuniste ndër male.

Më 26 qershor 1951, do të thotë pas pesë vjetësh terrori dhe vrasjesh në radhët e klerit katolik, u mblodh në Shkodër, qendër e katolicizmit shqiptar, një kongres i klerit katolik që kish mbetur pa u vrarë ose burgosur. Ky kongres themeloi "Kishën Katolike Shqiptare". Në bazë të rregullores së re deklarohej se

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

kjo kishë nuk kishte më asnjë lidhje organizative, politike ose ekonomike me Vatikanin. Edhe kryetari i kësaj kishe, prifti Ernest Çoba, emëruar me pëlqimin e qeverisë, i deklaroi Republikës Popullore të Shqipërisë besnikëri dhe nënshtrim.

Më 1967 të tëra kishat e xhamitë e Shqipërisë u mbyllën dhe u konfiskuan, kështu që asnjë funksionar fetar s'mund të ushtrojë besimin e tij. Shqipëria u deklarua shtet ateist, i pari në botën moderne.

Puna e detyruar. Puna e detyruar, do të thotë puna në fushat e përqëndrimit, është e ushtruar në Shqipëri në nji shkallë të gjerë, që në ditët e para të regjimit komunist, më 1944 (sipas një studimi të Organizatës së Kombeve të Bashkuara gjatë vjetëve 1945-1956, 80.000 veta u futën nga regjimi në fushat e përqëndrimit prej të cilëve 16.000 vdiqën). Puna e detyruar është legale në Shqipëri: Kodi Penal (1-IX-'51) përmban shumë artikuj mbi "punën korektive" (eufemizëm për punën e detyruar) në fushat e përqëndrimit dhe të punës. Sipas këtij kodi, edhe fëmijët 12 vjeç mund të dënohen me "punë korektive" për krime kundër shtetit.

Fushat e përqëndrimit u hapën për të internuar familjet e shumta të të aratisurve dhe të të burgosurve politikë, si edhe për t'u marrë shtëpitë e tyre, sidomos ato të funksionarëve të lartë të regjimit të mëparshëm, natyrisht për të vendosur në to funksionarët e regjimit të sotëm. Fushat më të përmendura për

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

famën e tyre të keqe janë ato të Tepelenës, të Fierit, të Beratit, të Burrelit, të Lushnjës etj.

Qeveria nuk bën ndonjë dallim ndërmjet atyre që janë dënuar me punë të rëndë rregullisht nga gjyqet dhe atyre që kanë futur ndër të njëjtat fusha pa vendim gjyqi. Në fushat e përqëndrimit ka zakonisht të burgosur politikë, ish tregëtarë dhe profesionistë të ndryshëm. Fëmijëve dhe pasardhësve të kësaj kategorie njerëzish u është mohuar kategorikisht edukimi mbi tetë vjet shkollë fillore.

Propaganda. Shtypi dhe tëra organet tjera të lajmeve dhe të propagandës janë nën kontrollin e rreptë të shtetit dhe kanë për qëllim të përhapurit e politikës komuniste dhe të programit të regjimit të sotëm.

Gazetat, revistat dhe librat janë të botuara nga partia komuniste, nga qeveria, nga ushtria dhe nga institucionet e shumta të partisë. Një propagandë e madhe bëhet me "gazetat e murit" që pregatiten ndër fshatra, fabrika, zyra, shkolla dhe kudo që ka një grup njerëzish që jetojnë ose punojnë së bashku. Të gjitha shtypshkronjat dhe shtëpitë botuese janë pronë e shtetit, që nga dita kur u shtetëzuan, më 1946.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Rruga e re - vazhdimi i së vjetrës.

Në Bashkimin Sovjetik pak kohë pas vdekjes së Stalinit (mars 1953) erdhi në fuqi N. Hrushovi. Ky, përveç ndryshimeve të mëdha që bëri në Bashkimin Sovjetik, solli ndryshime edhe në shtetet e Europës Lindore. Që në fillim u riabilituan udhëheqësit komunistë të burgosur ose të vrarë, u dënua "kulti i personalitetit", u hap një fushatë e gjerë për uljen e tensionit ndërkombëtar, u bënë hapa për normalizimin e marrëdhënieve me Jugosllavinë titiste, u trumbetua "bashkëjetesa paqësore", "destalinizimi", "udhëheqja kolektive" etj.

Në fillim udhëheqësit shqiptarë dhanë përshtypjen se edhe ata, ndonëse me ngadalë, po ndiqnin rrymën e re, por kur erdhi puna në rishqyrtimin dhe zbatimin e çështjeve konkrete siç ishin p.sh. riabilitimi i Koçi Xoxes, lidhja e marrëdhënieve me Jugosllavinë d.m.th. njohja e revizionizmit të Titos, udhëheqja kolektive (në këtë ndërkohë Enver Hoxha ish larguar nga detyra e kryeministrit duke i a lënë vendin Mehmet Shehut dhe duke mbajtur për vete detyrën e sekretarit të P.P.SH.), nuk bënë asnjë hap në këtë drejtim.

Në të njëjtën kohë edhe një aleat tjetër i Bashkimit Sovjetik nuk i shikonte me sy të mirë këto ndryshime qe po ngjanin në të ashtuquajturin kamp socialist dhe, që në ditët e para, R.P. e

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Kinës mbajti qëndrim të kundërt ndaj reformave nëpër të cilat po kalonin partitë dhe qeveritë e vendeve komuniste të Europës Lindore.

Për të detyruar udhëheqjen shqiptare të pranonte vijën e re, Bashkimi Sovjetik filloi të merrte ca hapa konkretë. Në fillim udhëheqës të vendeve satelite, me anë vizitash në Shqipëri, u munduan t'u mbushnin mendjen E. Hoxhës e M. Shehut që të bënin ca "lëshime". Pasi këto nuk dhanë ndonjë përfundim të kënaqshëm filluan t'u pakësojnë ndihmat ekonomike.

Si rrjedhim, i vetmi vend ku mund të drejtoheshin ishte Kina e kuqe. Dhe me të vërtetë me një sërë marrëveshjesh që filluan të lidhen që në tetor të 1954-ës, udhëheqja shqiptare filloi të afrohet me Kinën e Mao Ce Dunit.

Në maj 1955 shtetet komuniste të Europës Lindore, ndër to dhe Shqipëria, u mblodhën në Varshavë dhe themeluan Organizatën e Traktatit të Varshavës si kundërmasë ndaj NATO-s. Në këtë ndërkohë në Shqipëri u bënë ca spastrime në radhët e hierarkisë së lartë të partisë (Tuk Jakova e Bedri Spahiu).

Në maj-qershor 1956 u mblodh në Tiranë Kongresi i Tretë i P.P.SH. Në mbarim të kongresit, Komiteti Qendror i dha E. Hoxhës votbesimin. Kështu, duke konsoliduar edhe një herë pozitat e tyre, dy udhëheqësit u nisën për në Pekin për të marrë pjesë në Kongresin e Tetë të Partisë Komuniste Kineze.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Gjatë trazimeve në Poloni në tetor dhe kryengritjes në Hungari në tetor-nëntor 1956 qëndrimi i shtypit shqiptar qe më i ashpri nga të gjithë të tjerët të shteteve komuniste. Me zhvillimin e ngjarjeve të lartpërmendura udhëheqja shqiptare gjeti shkak të vërsulej kundër frymës së liberalizimit, kundër revizionizmit jugosllav e kundër anti-Stalinistëve të Kremlinit e të shteteve satelite duke i cilësuar këta si shkaktarët e vërtetë të gjakderdhjes. Ky qëndrim filloi të shqetësonte seriozisht udhëheqësit sovjetikë.

Në fillim të vitit 1957 Hrushovi dhe Çu En Lai u përpoqën të sillnin një farë bashkimi e bashkëveprimi në blokun komunist që kish filluar me kohë të përçahej, por më në fund kjo përpjekje dështoi.

Në mbledhjet e viti 1958 për planifikimin dhe integrimin e ekonomive të republikave popullore KOMEKON-i kish caktuar që ekonomia shqiptare duhet të zhvillohej në një mënyrë t'atillë që të furnizonte shtetet tjerë pjesëtarë me artikuj bujqësorë dhe me minerale të papunuara, dhe planifikuesit sovjetikë këshilluan që Shqipëria duhej të investonte më shumë kapital në sektorin bujqësor të ekonomisë, gjë që do t'ishte në dëm të zhvillimit industrial. Kjo qe një goditje e rëndë për zhvillimin e ekonomisë shqiptare. Të alarmuar nga ky vendim, udhëheqësit shqiptarë vazhduan të largohen edhe më shumë nga aleatët e tyre komunistë të Europës Lindore e të lidhen sa më ngushtë me aleaten e madhe, Kinën.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Me shpresë që të pengonte një gjë të tillë N. Hrushovi u nis për një vizitë në Shqipëri në maj të 1959-ës. Gjatë qëndrimit të tij në Tiranë, Hrushovi e bëri të qartë duke theksuar se Shqipëria do të jipte kontributin e saj më të madh blokut socialist po të shfrytëzonte dhe po të zhvillonte sistematikisht bujqësinë e vendit. Pas kësaj vizite udhëheqësit komunistë shqiptarë vazhduan të ndiqnin një politikë edhe më të pamvarur se përpara, një politikë krejtësisht në kundërshtim me vijën e Kremlinit, duke përkrahur haptazi, tani vijën ideologjike të Mao Ce Dunit.

Shkëputja--Prerja e marrëdhënieve. Prej ca kohësh marrëdhëniet në mes Bashkimit Sovjetik dhe R.P. të Kinës sa po vinin po keqësoheshin. Shkaku i prishjes së marrëdhënieve ishte ideologjik dhe kryesisht mbi qëndrimin e partive komuniste ndaj lëvizjes komuniste botërore, dhe në plan të dytë ishin një tok arësyesh tjera, të cilat nuk fshiheshin më dot nën rrogoz.

Veprimi i parë i qëndrimit anti-sovjetik i udhëheqjes shqiptare ngjau në Pekin në qershor 1960 gjatë Konferencës së Këshillit të Përgjithshëm të Federatës Ndërkombëtare të Sindikatave kur delegacioni shqiptar u bashkua me atë kinez për të kundërshtuar delegacionin sovjetik në punët e konferencës. Gjatë Kongresit të Tretë të Partisë Komuniste Rumune në Bukuresht, Hrushovi u përpoq që t'a kthente kongresin në një mbledhje të nivelit të lartë të partive komuniste për të dënuar qëndrimin

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

kinez. Kryetari i delegacionit shqiptar qe i vetmi delegat i një partie komuniste shtetërore europiane që, jo vetëm nuk pranoi të kritikonte vijën kineze, por sulmoi revizionizmin ndër radhët komuniste, nënvleftësoi "bashkëjetesën paqësore" etj. Në muajt që pasuan udha që morën komunistët shqiptarë u bë edhe më e qartë. Shtypi, fjalimet dhe komentet e radios lavdëronin qëndrimin kinez për ruajtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit, për rrugën e drejtë kineze në politikën e brendshme e të jashtme, duke sulmuar pa ndërprerje revizionistët modernë.

Pas këtyre dhe disa ngjarjeve tjera, Moska vendosi të marrë një qëndrim të prerë ndaj klikës sunduese Hoxha-Shehu: hapi një fushatë që t'i përmbyste ja me hir ja me pahir. Ambasada sovjetike në Tiranë inkurajoi haptazi rrymën pro-sovjetike në gjiun e partisë të kryesuar nga Liri Belishova e Koço Tashko që të punonin kundër qëndrimit kinez, kërcënoi të dëbonte Shqipërinë nga Traktati i Varshavës dhe preu pothuaj krejtësisht dërgimin e grurit (në një vit nevoje) në Shqipëri.

Në gusht-shtator 1960 Enver Hoxha urdhëroi arrestimin e një grupi oficerësh të lartë dhe të disa funksionarëve të partisë, ndër ta: Admirali Teme Sejko, gjeneral-major Halim Xhelo, Kryetari i Komitetit Ekzekutiv të Elbasanit përfaqësues i R.P. të Shqipërisë në Komekon, Tahir Demi etj.; urdhëroi gjithashtu dëbimin nga partia të L. Belishovës dhe të K. Tashkos, duke

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

akuzuar grupin e parë për aktivitet revolucionar në pregatitjen e një grusht shteti, dhe grupin e dytë për "gabime serioze".

Në shtator 1960 me rastin e hapjes së sesionit të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në New York të gjithë udhëheqësit e vendeve komuniste të Europës Lindore, me N. Hrushovin në krye, u nisën për N.Y. me anijen sovjetike "Baltika" që të merrnin pjesë në bisedimet e asaj asambleje. Delegacioni shqiptar i kryesuar nga Mehmet Shehu arriti në New York me aeroplan. Gjatë bisedimeve për çarmatim delegacioni shqiptar votoi kundër propozimit sovjetik. Shkëputja e R.P. të Shqipërisë nga "republikat popullore motra" ishte një fakt i kryer tani.

Dhe në këtë atmosferë përçarje u mblodh në Moskë më 10 nëntor 1960 konferenca e tetëdhjetë e një partive komuniste botërore. Të gjitha partitë përfaqësoheshin nga udhëheqësit e tyre. Partia komuniste shqiptare përfaqësohej nga E. Hoxha, M. Shehu, H. Kapo e R. Alia.

N. Hrushovi duke përfituar nga prania e udhëheqësve shqiptarë në Moskë i ftoi që të kishin një takim më 9 nëntor për të biseduar mbi divergjencat që ekzistonin në mes dy shteteve. Nga ana tjetër, pa ndonjë paralajmërim, u shpërndau pjesëtarëve të konferencës një dokument, në të cilin dënohej pala shqiptare për "aktivitetin dhe politikën e saj anti-sovjetike". Çasti i ballafaqimit në mes (Partisë Komuniste të) Bashkimit Sovjetik dhe (Partisë Komuniste të) Republikës Popullore të Shqipërisë erdhi

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

më 16 nëntor kur Enver Hoxha, kryetari i delegacionit shqiptar mori fjalën në konferencë. Ndër të tjera ai tha se kulti i personalitetit nuk i përshtatej vetëm Stalinit e se Hrushovi kishte shtrembëruar tezat e Leninit për qëllimet e tija personale. Nxori në shesh se si Kremlini kish dërguar atë verë një letër me të cilën kërkohej përkrahja e partisë komuniste shqiptare në fushatën anti-kineze. Pastaj përmendi metodat që kish përdorur Moska për të detyruar palën shqiptare të pranonte diktatin sovjetik. Viti 1959 qe një vit në të cilin Shqipëria pësoi tërmete, vërshime e thatësirë. "Kishim grurë për vetëm 15 dit" tha ai "dhe pas një vonese prej 45 ditësh Bashkimi Sovjetik premtoi se do të na dërgonte 10.000 tonë në vend të 50.000 tonëve, d.m.th. grurë për 15 dit dhe këto do të vinin në shtator ose tetor. Ky lloj presioni s'durohej dot. Minjtë sovjetikë kishin ç'të hanin ndërsa populli shqiptar po vdiste urie". Pastaj vazhdoi të tregonte se si Malinovski, Ministri i Mbrojtjes së Bashkimit Sovjetik, kish sulmuar qeverinë dhe partinë komuniste shqiptare gjatë mbledhjes së kryetarëve të Shtabit të Përgjithshëm të Traktatit të Varshavës dhe se si Mareshali sovjetik Greçko, Komandanti i Ushtrive të Traktatit të Varshavës kish bërë presion duke i kërcënuar me përjashtim nga kjo organizatë.

Kaq i ashpër e fyes duhet të ketë qenë fjalimi sa që në fund të tij Hrushovi thirri me inat "Shoku Hoxha, më ke hedhur

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

një kovë me pisllëqe; do të detyrohesh që t'i lash". Më 25 nëntor, gjashtë dit para mbylljes së konferencës, E. Hoxha e M. Shehu u nisën për Shqipëri.

Më 7 janar 1961 një komision i madh ekonomik shqiptar u nis për në Pekin dhe më 2 shkurt u nënshkrua marrëveshja ekonomike shqiptaro-kineze, me të cilën Kina gjatë pesëvjeçarit të tretë (1961-1965) do të ndërtonte dhe do të pajiste me maqineri rreth njëzet e pesë objekte industriale.

Po në shkurt 1961 u mblodh në Tiranë Kongresi i Katërt i P.P.SH. ku merrnin pjesë si të ftuar 24 parti komuniste të huaja. Në fjalimin e hapjes E. Hoxha theksoi edhe një herë vijën e partisë duke sulmuar revizionistët, por fjalimi i M. Shehut qe edhe më i rreptë. Ndërsa partitë komuniste të Lindjes së Largme përkrahën tezën e komunistëve shqiptarë, ato të shteteve europiane u çfaqën në kundërshtim të plotë me të.

Në maj 1961 u sollën para gjyqit pjesëtarët e grupit të akuzuar për pjesëmarrje në një grusht shteti në Shqipëri (shih më lart) dhe pesë prej tyre u dënuan me vdekje. Në mbarim të majit njësitë e marinës sovjetike filluan të smontojnë objektet e portit ushtarak e të bazës së nëndetësve të Vlorës e të Sazanit, dhe po pregatiteshin të tërhiqnin nëndetëset nga Shqipëria. Lindën kundërshtime (thuhet se ngjanë edhe përpjekje me armë) dhe nëndetëset sovjetike u lejuan të iknin vetëm pasi

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

pranuan që një numër prej tyre t'i liheshin Shqipërisë. Si kundërmasë Bashkimi Sovjetik konfiskoi disa luftanije shqiptare që ndodheshin në portet ruse.

Në këtë ndërkohë Bashkimi Sovjetik dhe shtetet satelite prenë përnjëherësh ndihmën ekonomike dhe kreditë financiare. Në maj 1961 të tërë specialistët sovjetikë që ndodheshin në Shqipëri u kthyen në vendin e tyre. Shtetet satelite caktuan datën 31 gusht ditën kur të gjithë teknikët e inxhinierët e tyre duhet të largoheshin nga Shqipëria. Gjatë verës marrëdhëniet me shtetet komuniste të Europës Lindore u keqësuan edhe më shumë: ato pakësuan personelin e ambasadave të tyre, tërhoqën teknikët që kishin mbetur ende në Shqipëri, u prenë bursat studentëve shqiptarë që studionin nëpër këto shtete, ndaluan udhëtimet turistike për në Shqipëri etj. Nga ana e saj qeveria shqiptare filloi t'ua bënte sa më të vështirë qëndrimin personelit të ambasadave satelite në Tiranë.

Më 17 tetor u hap në Moskë Kongresi i Njëzetedytë i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, në të cilin Shqipëria nuk u ftua. Në fjalimin e hapjes N. Hrushovi, dhe pas tij tërë pjesëtarët e hierarkisë komuniste sovjetike, sulmuan rëndë qëndrimin dhe veprimet e partisë komuniste shqiptare. Kulmi arriti me fjalimin që mbajti Hrushovi në mbylljen e Kongresit (27 tetor) kur i bëri thirrje popullit shqiptar të përmbyste klikën Hoxha-Shehu.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Gjatë këtij kongresi u vërtetua edhe çarja në mes Bashkimit Sovjetik dhe Republikës Popullore të Kinës.

Akuza e sharje të parreshtura nga të dyja palët pasuan pas këtyre ngjarjeve, të cilat përfunduan në prerjen e marrëdhënieve diplomatike. Më 3 dhjetor 1961, Bashkimi Sovjetik, pasi akuzoi Shqipërinë se "me qëllim vazhdon të keqësojë marrëdhëniet me B.S.", i dha urdhër ambasadorit të vet të largohej nga Tirana, dhe njëkohësisht urdhëroi ambasadorin shqiptar të largohej nga Moska në mes akuzash që të dy vendet kishin vënë aparate përgjimi në ambasadat e njera tjetrës. Kjo qe hera e parë në histori që dy shtete komuniste prisnin marrëdhëniet diplomatike në mes tyre.

Pas pak javësh edhe vendet tjera komuniste të Europës Lindore tërhoqën ambasadorët e tyre nga Tirana (duke lënë të ngarkuarit me punë), por nuk i prenë marrëdhëniet diplomatike.

Aleanca e re. Prerja e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik dhe blokada ekonomike e vunë R.P. të Shqipërisë në një pozitë të vështirë, por jo për shumë kohë, pasi lidhjet e saja me R.P. të Kinës filluan të bëhën dita ditës më të ngushta. Nga ana tjetër udhëheqja komuniste shqiptare filloi një fushatë propagandistike të pandërprerë kundër "revisionizmit modern", kundër aleancës "revizioniste-imperialiste" duke u bërë thirrje partive komuniste botërore që të përmbysnin Hrushovin, në të njejtën kohë duke paraqitur veten si ruajtësit e vërtetë të marksizëm-leninizmit.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Në fund të dhjetorit të 1963-së, kryeministri kinez Çu En Lai vajti për një vizitë dhjetë ditëshe në Shqipëri. Gjatë qëndrimit të tij ai lavdëroi popullin shqiptar për luftën e tij kundër revizionizmit etj.

Nga mbarimi i shkurtit 1964 armiqësia në mes Bashkimit Sovjetik dhe Shqipërisë u shtua edhe më me sekuestrimin e godinës së re të ambasadës sovjetike në Tiranë.

Në tetor 1964 Nikita Hrushovi ra nga fuqia dhe udhëheqja e re sovjetike (Brezhnev-Kosigin) nuk bëri ndonjë ndryshim të dukshëm në vijën e ndjekur nga Hrushovi. Me rastin e 28 nëntorit, E. Hoxha në fjalimin e tij sulmoi rëndë udhëheqësit e rinj sovjetikë.

Shqipëria u ftua në mbledhjen e Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës në janar 1965, por udhëheqësit komunistë shqiptarë, ndonëse pjesëtarë të këtij traktati, nuk e pranuan ftesën. Në mars po t'atij viti një delegacion kinez, i kryesuar nga kryeministri i Kinës Çu En Lai, vizitoi Shqipërinë. Në prill një delegacion shqiptar i kryesuar nga Spiro Koleka u nis për në R.P. të Kinës ku pas ca ditësh nënshkroi protokolin e ndihmës ekonomike dhe teknike që Kina do t'i jepte Shqipërisë gjatë planit të katërt pesëvjeçar (1966-1970).

Në janar 1966, si shtet pjesëtar, Shqipëria u ftua përsëri në mbledhjen e Traktatit të Varshavës, por përsëri e hodhi poshtë

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

ftesën; hodhi poshtë gjithashtu, në shkurt, ftesën e Bashkimit Sovjetik për të lidhur marrëdhënie tregëtare. Nga ana tjetër Shqipëria u bë qendra e lëvizjes anti-revizioniste. Herë pas here delegacione nga vende të ndryshme vizituan Tiranën dhe me kthimin në vendet e tyre themeluan të ashtuquajturat parti komuniste (M-L) (marksiste-leniniste). Në të njëjtën kohë Shqipëria u bë në OKB zëdhënësja për pranimin e Kinës së kuqe në këtë organizatë.

Për të përforcuar kontrollin e partisë mbi masat e gjera të popullit e mbi organet lokale të partisë, dhe për të konsoliduar influencën e partisë mbi çdo sektor të jetës, në shurt 1966 hyri në veprim Revolucioni Kultural. Si rrjedhim i kësaj lëvizje, në muajt që pasuan, u mbyllën të gjitha faltoret, u hoqën gradat në fuqitë e armatosura, u rivendosën komisarët politikë, u likuidua Ministria e Drejtësisë, u pakësuan nëpunësit e shtetit duke dërguar një numër prej tyre në prodhim, u theksua rëndësia për emancipimin e plotë të gruas, u zvogëluan kopshtet personale ndër kooperativat bujqësore, u vunë në përdorim "fletë rrufetë" etj.

Bashkimi Sovjetik, duke përfituar nga vështirësitë e brendshme në Shqipëri, kërkoi në fillim të 1967-ës që të përmirësoheshin marrëdhëniet në mes dy vendeve; në qershor kërkoi përsëri që të lidheshin marrëdhënie tregëtare, por Shqipëria nuk pranoi.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Gjatë 1967-ës dy delegacione shqiptare u nisën për në Kinë; i pari i kryesuar nga ministri i mbrojtjes dhe i dyti nga kryeministri i R.P. të Shqipërisë.

Në 1968, kur qeveria dhe partia komuniste çekosllovake, duke ndjekur një udhë krejt të pamvarur, filluan të bënin një sërë reformash ekonomike, shoqërore e politike, dhe duke mos pranuar të ndiqnin këshillat sovjetike, u gjetën përball trupave të aleatëve të tyre të Traktatit të Varshavës, të udhëhequra nga trupat sovjetike, të cilat në gusht 1968 hynë ushtarakisht në Çekosllovaki për të ndaluar vrullin e liberalizimit.

Mbas kësaj ngjarje dhe pikërisht në shtator 1968 Shqipëria "duke mos pranuar të bëjë pjesë në një koalicion agresioni...." dolli zyrtarisht nga Traktati i Varshavës.

Në nëntor 1968 një delegacion kinez i kryesuar nga shefi i shtabit të përgjithshëm të ushtrisë popullore çlirimtare kineze vajti për një vizitë në Shqipëri.

Kështu, në mbarim të 1968-ës, R.P. e Kinës dhe R.P. e Shqipërisë, bashkë dhe vetëm në mes të shteteve komuniste, qëndrojnë si pararojë e fuqive anti-sovjetike e anti-revizioniste të sferës komuniste.

Gjatë tërë këtyre grindjeve e akrobacive politike, kasnecat e P.K. të Shqipërisë nuk kanë pushuar asnjë ditë të hedhin vrerë me tërë forcën e aparatit të tyre propagandistik kundër Sh.B. të Amerikës, duke i cilësuar këto si burimin e çdo ngatërrese në botë. E njëjta gjendje vijon edhe sot.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.